



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 5 MAJ 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
5. MAJA 2011. GODINE**

**MAJ – MAJA
2011**

E enjte, m; 5. maj 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i çështjeve urgjente

Nuk kemi.

2. Koha për deklarimet jashtë rendit të ditës

Në pajtim me nenin 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupit parlamentar zgjatin deri në 5 minuta, ndërsa diskutimet e deputetëve deri në 3 minuta.

Paraprakisht ju njoftoj, 30 minuta janë për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Replika nuk ka në këtë pikë të rendit të ditës.

Nga mbledhja plenare e kaluar kanë mbetur pa diskutuar këta deputetë: Xhevahire Izmaqu, Xhevdet Neziraj, Ramiz Lladrovci, Afrim Hoti, Lutfi Haziri, Anton Quni, Rita Hajzeraj, Zenun Pajaziti dhe Halit Krasniqi.

Po fillojmë me deputeten e parë. Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaqu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje, për ju kolegë të nderuar deputetë!

Mendova që nuk do të jem e detyruar të flas për këtë shqetësim, mirëpo siç shihet, prapë po vazhdon një gjendje e njëjtë në komunën e Vushtrrisë. Pra ndjehem e detyruar që para këtij organi më të lartë përfaqësues të vendit të ngreh shqetësimin, por edhe revoltën e qytetarëve vushtrrias në lidhje me terrin që ka kapluar tash e sa kohë këtë komunë, e që vije si pasojë e një diskriminimi të paparë në Vushtrri. Reduktimet e rrymës 16 orë pa rrymë dhe 8 me rrymë janë bërë të zakonshme për qytetarët vushtrrias. Por, ditët e fundit kjo komunë thuhet se e tëra ishte në terr, si pasojë e shkyçjeve kolektive. Sado që zyrtarët e kësaj kompanie nuk e pranojnë të jetë e tillë, politika menaxheriale e KEK-ut ka irrituar në masë të madhe qytetarët e kësaj komune deri në atë shkallë sa edhe të protestojnë dhe bllokojnë rrugët e këtij qyteti, gjersa bizneset janë buzë kolapsit, sidomos ato prodhuese, pasi kostoja e tyre e afarizmit po rritet nga mungesa e tillë e rrymës. Politika menaxheriale e kësaj kompanie duke dënuar me shkyçje kolektive edhe ata qytetarë që paguajnë, është tërësisht e gabuar dhe jo produktive, pasi që paguesit e rregullt nga revolta mbi gjendjen i shtyjnë po ashtu të mos paguajnë. Për këtë gjendje hiq të mirë kanë reaguar edhe drejtuesit e pushtetit lokal, të cilët mendojnë që kjo kompani publike pa të

drejtë po dënon qytetarët e kësaj komuna, edhe pse ka rritje të pagesës dukshëm nga qytetarët, por që mungojnë të dhënat nga mos transparenca e kompanisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Kabinet qeveritar dhe kolegë deputetë,

Unë këtu do të ngrejë një çështje në lidhje me ndryshimet kushtetuese që do të ndodhin dhe besoj që edhe profesor Bajrami po na dëgjon. Besoj që ndryshimet kushtetuese duhet të lëshohen dhe të bisedohet edhe në parlament dhe jo vetëm në Komisionin kushtetues, dhe të bëhen ndryshimet jo vetëm në çështjen e kryetarit, por edhe disa çështje tjera. Unë do të ndalem në mekanizma mbrojtës të komuniteteve, të cilët parashihen me pakon e Ahtisarit dhe që janë në kushtetutë. Dua të them diçka se komunitetet jo serbe janë përfaqësuar në Kuvend po aq sa janë përfaqësuar edhe vetë komuniteti serb dhe komuniteti serb ka 3 ministri, komuniteti serb ka një zëvendëskryeministër, komuniteti serb ka 4 pjesëtarë në Komisionin për Komunitete, komuniteti serb udhëheq Këshillin konsultativ të komuniteteve që është në kuadër të presidentit, komuniteti serb udhëheq zyrën pranë kryeministrit, komuniteti serb me decentralizim ka fituar më së shumti komuna dhe komuniteti serb mbi 90% të buxhetit e harxhon për nevoja të veta, për komunitetin e vet. Do të thotë, komunitetet joserbe janë të diskriminuar vetë me pakon e Ahtisarit dhe vetë me kushtetutën. Prandaj, besoj që në ndryshimet kushtetuese duhet që të gjitha komunitetet të mbrohen me kushtetutë dhe jo vetëm të mbrohet një komunitet. Do të thotë, Ligji për promovimin e komuniteteve, ku gjatë mandatit të kaluar ka bërë monitorimin e këtij ligji, ku parashihet që ndërmarrjet publike të ketë punësuar anëtarë të secilit komunitet, dua ta njoftoj këtë Kuvend dhe e kam njoftuar edhe më herët se në ndërmarrjet publike me rëndësi, siç është KEK-u dhe PTK-ja s'është asnjë pjesëtar i komunitetit egjiptian i punësuar, gjithashtu janë në mënyrë shumë simbolike në institucione me rëndësi, siç është Policia e Kosovës, siç është Forca e Sigurisë, siç është dogana dhe asnjë i punësuar në administratën e Kuvendit. Prandaj, Ligji për promovimin e komunitetit, i cili duhet të përcillet nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, asnjëherë nuk e ka monitoruar këtë ligj, po e ka monitoruar decentralizimin, me qëllim që të përfitojë vetëm një komunitet. Prandaj, besoj që në ndryshimet e ardhshme kushtetuese duhet që mekanizmat mbrojtës me të vërtetë të mbrojnë ato komunitete që kanë nevojë për mbrojtje dhe jo ato komunitete që s'kanë nevojë për mbrojtje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Renditjen po e bëj duke ua dhënë fjalën të gjitha grupeve parlamentare, do të thotë nuk po e respektojmë rendin, siç e lexova në fillim.

Fjalën e ka kërkuar në emër të Afrim Hotit, Florin Krasniqi.

FLORIN KRASNIQI: Kjo është seanca e tretë që unë kërkoj fjalën, po më në fund në emër të Afrimit, në emër të dikujt po flasë.

Disa çështje që janë ngritur këtu në këtë parlament rreth asaj çka unë kam bërë, thënë ose punuar, e njëra prej atyre është iniciativa e Bekim Haxhiut - Kamishit për një hetuesi ndaj

meje. Unë e vlerësoj lartë këtë iniciativë për faktin se Bekim Haxhiu me shokët, për më shumë se 10 vjet e kanë bërë ligjin vet, e tash po i drejtohen organeve të drejtësisë. Është një e arritur shumë e madhe e Kosovës. Unë i sugjeroj Bekimit dhe shokëve të tij t'ju drejtohen gjithmonë organeve të drejtësisë, të mos e bëjnë ligjin vet.

Komenti tjetër që është ardhur në këtë sallë nga një tjetër deputet, Fadil Demaku, rreth vizitës tonë në Shqipëri. Ne kemi pasur dy takime zyrtare në Shqipëri. Në të dyja takimet zyrtare, unë kam qenë krejtësisht profesional edhe e kam bërë punën e kryetarit të Komisionit. Në takimet jozyrtare unë e kam thënë se Hashim Thaçi është një rrugaç. Këtë e kam thënë në Uashington, e kam thanë në Tiranë, po e them në Prishtinë, e më vjen keq që ai nuk është këtu, po unë ashtu mendoj, se ai është një rrugaç.

KRYETARI: Florin, mos e keqpërdor foltoren dhe pikën e rendit të ditës. Kjo është për të ngritur çështjet që janë në interes të qytetarëve, jo për të fyer asnjë deputet dhe asnjë figurë tjetër politike.

FLORIN KRASNIQI: I nderuar kryetar, mua më është thënë se nuk kam qenë profesional, andaj unë duhet të sqaroj çka kam bërë, edhe po e bëj një sqarim. Një gjë tjetër që është tepër me rëndësi për mua, është Ministria e Diasporës. Edhe ofendimi i radhës për diasporën është themelimi i ministrisë, jo se unë jam kundër, unë jam për, tash e më shumë se 10 vjet jam për, kam lobuar për Ministrinë e Diasporës, por Ministria e Diasporës nuk është dashur të vijë si rezultat i pazareve politike. Diaspora meriton më shumë, ajo që na mbajti gjallë para lufte, ajo që e bëri luftën, ata njerëz shumë të vuajtur që po vazhdojnë të na mbajnë gjallë meritojnë më shumë. Ne nuk po e bëjmë Ministrinë e Diasporës për diasporën, po e bëjmë për pazare politike. Kjo është një fyerje për diasporën, diaspora duhet të marrë pjesë aktive, aktive në themelimin e diasporës, e jo si pazar politik. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Po kërkoj nga deputetët që ta lexoni mirë këtë të drejtë të deputetëve që e jep Rregullorja. Kjo pikë e rendit të ditës është për të ngritur çështje që janë në interes të qytetarëve të Kosovës dhe jo për sharje dhe fyerje. Përndryshe, është më mirë ky Kuvend këtë pikë të rendit të ditës ta heq krejt nga rendi i ditës. Ne këtu jemi për t'i përfaqësuar qytetarët dhe nuk është në interesin e qytetarëve ne tash të përdorim fjalor jo parlamentar në Kuvend.

Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, kryetar!

Në mbledhjen e kaluar ka qenë tema aktuale, sot është pjesë e debatit, kështu që unë tërhiqem nga fjala. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, pasi u tërhoqe, po ia japë fjalën Anton Qunit, ka qenë i lajmëruar.

ANTON QUNI: I nderuar kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Më 9 prill te varrezat e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të rënë në Betejën e Koshares, është mbajtur manifestimi qendror në kujtim të kësaj ngjarjeje. Familjarët e dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët dhe shumë vizitorë, përkundër pikëllimit për të dashurit e tyre, iu gëzuan faktit se Beteja e Koshares dhe brigada 138 “Agim Ramadani” u nderua me pjesëmarrje nga të gjitha institucionet e Kosovës, nga Presidenca, Parlamenti, Qeveria, Pushteti Lokal e tjera. Edhe më shumë i gëzoj fakti se kjo ngjarje po ashtu u nderua nga thuajse të gjitha partitë politike, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, “Vetëvendosja”, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Lidhja Demokratike e Dardanisë, Partitë Demokristiane e tjera. Të gjithë të pranishmit patën mundësinë që nga afër të shohin bukuritë e Bjeshkëve të Junikut, nga ku shtrihet një pejsash i bukur në të dy anët e kufirit. Po, për të arritur në këtë pikë, duhet kaluar 7 kilometra rrugë, e cila është e papërfunduar dhe e paqëndrueshme, për të cilën Qeveria nuk ka paraparë mjete shtesë apo ndonjë alternativë tjetër. Me të arritur në Koshare, vërehen varrezat e dëshmorëve, të cilat e kanë ende të njëjtin pamje si në ditën e rivarrimit, më 23 gusht 1999, të cilat ende nuk janë nën përkujdesjen institucionale. Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj beteje, efektet e saja politike dhe ushtarake, në emër të ish stafit të brigadës 138, familjarëve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve kërkoj që të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, Presidenca, Kuvendi, Qeveria dhe pushtetet lokale të Gjakovës, Deçanit dhe Junikut, me urgjencën më të madhe në projektet e tyre si prioritet të kanë edhe ndërtimin e Qendrës Memoriale në Koshare, në tërë objektet dhe infrastrukturën e nevojshme.

Me këtë veprim ne do të nderojmë historinë, traditën, kulturën dhe vlerat tona, e nderojmë mundin dhe gjakun e të gjithë atyre që dhanë jetën për liri, do të nderojmë vetveten, si dëshmitarë të ngjarjeve para 12 viteve, dhe do t'i nderojmë brezat e ardhshëm për të cilët janë bërë të gjitha këto përpjekje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Si deputet i Republikës së Kosovës së lirë, të pavarur dhe demokratike, nuk mund të mos shpreh pakënaqësinë dhe kundërshtimin, indinjatën dhe revoltën time për fenomenin absurd të përndjekjes penale nga Serbia përmes Interpolit, të freskuar në janar të këtij viti. Për më tepër dhe ironinë e kohës dhe sovranitetit tonë shtetëror që po ndërtojmë, në listën valide të përndjekjes serbe përmes Interpolit figurojnë emrat e bartësve të institucioneve tona më të larta shtetërore, si kryeparlamentari, kryeministri, ministrat, deputetët, kryetarë komunash, drejtorë drejtorish e tjerë. Serbia diktatoriale dhe shoviniste si para, gjatë dhe pas luftës çlirimtare në Kosovë është e vetmja që ka terrorizuar, dhunuar, masakruar dhe asgjësuar qytetarët dhe pasuritë e Kosovës, nga të cilat kurrë nuk është distancuar. Kërkoj që në mënyrë institucionale apo përmes formimit të një komisioni parlamentar, në bashkëpunim edhe me EULEX-in, sektorin për komunikim me Interpolin të kërkojë dhe të sqarojë qëndrimin e institucioneve të Kosovës që çdo procedurë për ndjekje dhe ndalimi nga Interpoli mbi bazën e shpikjeve dhe dosjeve të Beogradit do të ketë për pasojë rivlerësimin e qëndrimeve të Qeverisë së Kosovës për bisedimet me Serbinë, kjo për faktin se përndjekjet e tilla janë në kundërshtim të plotë me legjitimitetin

dhe integritetin e bartësve të institucioneve të Kosovës. Këto dosje dhe procedura janë në kundërshtim me parimet bazë të sovranitetit institucional dhe vë në pikëpyetje kredibilitetin e institucioneve të Kosovës në totalin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Për më tepër, ato e pengojnë punën normale dhe qarkullimin e lirë të bartësve të institucioneve të Kosovës, të cilat janë të njohura nga shumica e shteteve anëtare të Interpolit. Në këtë kuadër, pra, një herë e përgjithmonë duhet të kërkohet që de jure të kërkohet qëndrimi i Interpolit në raport me këto dosje, të trashëguara nga MUP-i i regjimit të Millosheviqit dhe qoftë edhe ai edhe i Tadiqit. Kjo do të ndikonte në evitimin e ndalesave dhe procedurave formale, hetimore dhe nënçmuese ndaj bartësve të institucioneve tona, që jo rrallë jemi mësuar t'i shohim mbi bazën e këtyre të dosjeve serbe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kufjet ose vendosni në vesh, ose hiqni, se po pengojnë zërin në sallë.

Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kur unë kam kërkuar fjalën, do të thotë, ishte aktuale tema e të pagjeturve, do të thotë dita në të cilën përkujtohen të pagjeturit, mirëpo unë besoj që duhet të jetë aktuale edhe për Qeverinë, edhe për neve kjo ditë gjithmonë, sepse ende kemi mijëra trupa të pagjetur. Pra, para disa ditësh, më 27 prill, me një varg aktivitete në Prishtinë u shënuar Dita Kombëtare e të Pagjeturve. Edhe pas 12 viteve, numri i të pagjeturve në Kosovë është 1800, pak a shumë 1800 familje nuk dinë për fatin e më të dashurve, të cilët u morën nga kriminelët e luftës dhe nuk u kthyen as të vdekur. Me mijëra nëna e baballarë edhe sot, pas 12 viteve, i kanë të pamet të hapura në shtëpitë e tyre. Tanimë lotët e tyre mund edhe të jenë shterur, por dhimbja sa vjen e bëhet më e rëndë. Nënës që kanë harruar fytyrat e bijve të tyre, e as që nuk mund t'i vajtojnë, nuset tashmë në moshë që ende shpresojnë në mrekullitë se burrat edhe mund t'ju kthehen gjallë, e fëmijëve të cilëve është vështirë t'ju shpjegohet historia e fakti se baballarët e tyre janë të zhdukur. Shumë të vrarë e të zhdukur, të zhdukurit marrin emërtimin të pagjetur, të kidnapuar, të mbajtur peng nëpër burgje të Serbisë. Pra, në vitin 2003 u bënë përpjekje që kjo dilemë të dëshmohej me faktin se të zhdukurit janë të vrarë e të varrosur nëpër gropat e emërtuara varreza masive anë e këndë Serbisë. Edhe pse u kthyen më shumë se 800 trupa të shqiptarëve të masakruar nga Batajnica, Baina Bashta, Petrovo Selo e tjerë, të paidentifikuar mbetën edhe shumë të zhdukur, të pagjetur, të cilët sot e 12 vite kërkohen. Të gjitha këto familje kanë një brengë të përbashkët, ata donë të dinë për fatin e më të dashurve të tyre dhe të gjitha këto familje mendojnë se institucionet e Kosovës nuk po bëjnë sa duhet në zbardhjen e fatit të tyre. Fati i të pagjeturve nuk është diçka për të cilën duhet të flitet vetëm më datën 27 prill, eventualisht një ditë para dhe një ditë pas kësaj date.

Të nderuar, çështja e të pagjeturve duhet të jetë fillimi dhe fundi i çdo bisede me ndërkombëtarët dhe institucione të tjera të cilat po përkujdesen që Kosova të ketë një fqinjësi të mirë.

Ndërsa, sa iu përket bisedimeve me Beogradin, çështja e të pagjeturve është dashur që të jetë kusht për fillimin e bisedimeve, për çdo gjë që bisedohet, e jo të jetë temë e bisedimeve.

Unë nga këtu, në emër të të gjitha familjeve të pagjeturve, kërkoj një angazhim serioz të të gjitha institucioneve të vendit për zbardhjen e fatit të këtyre njerëzve. Këta njerëz janë plagë ende e hapur e luftës, që disave iu dhembë shumë, janë historia e dekadës së fundit të Kosovës, janë çmimi i lirisë që neve sot e gëzojmë.

Edhe një kërkesë dua t'ia bëj Qeverisë, sepse ju e dini shumë mirë që më datën 30 prill është dashur të vije Ligji për të pagjeturit në Parlamentin e Kosovës, andaj nuk është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Unë, në mbledhjen e kaluar e kërkoja fjalën për ta shtruar një çështje që po ashtu u theksua nga një koleg deputetë. Mendoj që duhet t'i shfrytëzoj disa minuta të kohës sime ta rishtroj këtë çështje, sepse është në interes të një pjese të qytetarëve të një regjioni.

Fjala është për ndryshimin e Ligjit për shtetësi. Ju e dini që ky ligj është ndër ligjet kryesore dhe të para të aprovuara nga ky Kuvend, si ligje të ardhura nga pakoja e Ahtisarit, është vlerësuar nga Kuvendi i Kosovës si një ndër ligjet më të mira, megjithatë kohëve të fundit, në përputhje edhe me kriteret për integritet evropian është kërkuar që të rishqyrtohet ky ligj. Fatmirësisht, Kuvendi e ka shti në agjendë në pjesën e dytë të vitit që ta ndryshojë ligjin. Po, ajo çka unë po shtroj, është me kërkesë të madhe të qytetarëve që vinë nga Lugina e Preshevës, Bujanovcit, Medvegjës, e që një pjesë e tyre jetojnë prej vitesh në Anamoravë, që ky ligj sa më shpejt të ndryshohet sepse ata kanë pengesa serioze në marrjen e dokumenteve legjitime në Republikën e Kosovës. Për pasojë, këta qytetarë nuk kanë mund t'i nënshtrohen edhe procesit të regjistrimit të popullsisë, që posa e kemi kaluar dhe mendoj që ka qenë dashur edhe më herët të shtrohet. Unë kërkoj me ngulm, nëse kjo nuk bëhet, atëherë ne do të kërkojmë mënyra të tjera që ta përshpejtojmë ndryshimin e këtij ligji në Parlament sa më parë që të jetë e mundur. Unë besoj që, zoti kryetar, Kryesia e Parlamentit t'i marrë për bazë këto kërkesa edhe me qenë se është në agjendë këtë vit, të shtyhet sa më herët, në mënyrë që t'i përmbushim kërkesat e këtyre qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, zoti kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Unë do ta ngrejë një çështje, e cila jo rrallë herë është ngritur edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe që ka të bëjë me organet e sigurisë dhe sigurinë në vend, vjedhjen në dhomën e dëshmitë, e cila edhe sot e kësaj dite ka mbetur vetëm deklaratë, më shumë retorikë e Policisë së Kosovës se hetimet vazhdojnë. Asnjëherë deri më tani nuk janë dhënë rezultate konkrete se kush do të vihet para përgjegjësisë dhe cili është dëmtimi që është vënë në këtë dhomë të sigurisë. Jo vetëm ato çka janë deklaruar, që aty kanë humbur apo janë vjedhur, por bëhet fjalë edhe për dosje të cilat janë shumë të rëndësishme, që kanë të bëjnë në lidhje me krimin e organizuar dhe sidomos me ato që njerëzit pretendojnë apo mundohen që përmes deklaratave politike të japin kahe politike apo të mbulojnë të kaluarën.

Unë i bëj thirrje nga këtu ministrit të Punëve të Brendshme dhe organeve kompetente, sepse deri më sot asnjë rezultat konkret në dhomën më të lartë, të sigurisë më të lartë nuk është dhënë ndonjë sqarim se çka ka ndodhur dhe deri ku kanë arritur këto rezultate, jo vetëm në aspektin e sigurisë, por edhe në aspektin e dëmtimit material dhe moral, sidomos të aspektit të institucionit dhe kredibilitetit të Policisë së Kosovës, sidomos të organeve që janë të thirrura, në këtë aspekt edhe EULEX-i, i cili trumbeton me të madhe që e lufton krimin e organizuar, sidomos në këtë aspekt. Andaj, kjo le të mbetet edhe një herë thirrje nga ky vend, nga organi më i lartë ligjvënës, edhe pse kjo temë po mundohet që të anashkalohet me spektakle të ndryshme që ndodhin gjëja për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Nuk ka krim më të madh se të vidhet policia dhe arsyeshmëria të jepet se hetimet vazhdojnë, nuk ka krim më të madh që organet e rendit nuk mund ta mbrojnë vetveten, ndërsa paraqiten se mund t'i mbrojnë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Dhe, e dyta, nuk ka gjë më dëmtuese se të vidhen dëshmitë apo dosjet e deponuara faktike dhe të gjinden apo të mundohen të tjetërsohen, edhe pse dikush mundon t'i qesë në pluhurin e harresës. Prandaj, edhe pse nuk është ministri i Punëve të Brendshme këtu, unë e thërras Kabinetin qeveritar, zëvendëskryeministrin i cili është i thirrur për mbrojtjen e shtyllës së drejtësisë që kjo çështje të zbardhet sa më shpejtë dhe njerëzit që e kanë bërë këtë akt, të vihen para drejtësisë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë i kam dy çështje për t'i ngritur këtu. Njëra ka të bëjë me Fakultetin e Edukimit dhe tjetra rreth regjistrimit të nxënësve në Universitet në vitin akademik 2011 – 2012.

Çështja e parë është rishqyrtimi i rekomandimeve të Agjencionit të Akreditimit në Kosovë për Fakultetin e Edukimit. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është përgjegjëse për të gjitha njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës, konkretisht për tërë sistemin edukativo- arsimor dhe shkencorë në Kosovë. Ish shkollat e larta janë

shndërruar në Fakultetin e Mësuesisë në fillim, e pastaj ky fakultet është kthyer në Fakultetin e Edukimit. Në këtë çështje ka ndihmuar edhe faktori ndërkombëtar, sidomos Finlanda dhe shtetet tjera evropiane. Agjencioni për Akreditim i Kosovës është agjencion që është formuar nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe ka për detyrë të akreditojë programet mësimore dhe shkencore për të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë. Agjencioni i Akreditimit është i detyruar që në marrëveshje me MASHT-in dhe mbështetur në cilësinë e programeve shkollore dhe akademike për të gjitha degët e fakultetit të Universitetit të Prishtinës, të bëjë akreditimin e tyre. MASHT-i në marrëveshje me Agjencionin e Akreditimit është dakorduar që edhe për një vit akademik të shtyhet ecuria e vazhdimit të situatës së tanishme, pra të vazhdohet me programet ekzistuese në Fakultetin e Edukimit, ndërsa pas kësaj kohe Agjencioni po ndërmerr masa për të cilat do të thotë ka në vete disa pyetje për të cilat tenton të mbyllë disa programe në Fakultetin e Edukimit. Mbyllja e këtyre programeve sipas gjasave ka një prapavijë e cila shkon në drejtim të faktorëve të mbushjes së numrit në fakultetet tjera, siç janë Fakulteti Filozofik, Filologjik, të Shkencave Matematiko-Natyrore, sepse sidomos në Fakultetin Shkencave Matematiko-Natyrore nuk ka studentë të mjaftueshëm. Kjo është një pyetje që kërkon një studim të thellë dhe këtë studim duhet ta bëjë pikërisht ministria dhe të gjejë faktorë se çka ka ndikuar që ky numër të bien në një numër shumë simbolik.

Transferi i programeve studimore të Fakultetit të Edukimit në fakultete tjera, i propozuar me vendimin e Agjencionit për Akreditim, është një ndryshim radikal në formën e sistemit arsimor në Kosovë, i cili mund të përcillet me vështirësi të pakalueshme. Fakulteti i Edukimit është i vetmi institucion i lartë që përgatit kuadër të aftësuar për mësimdhënie dhe mësimnxënie për nivelin e arsimit parauniversitar në përgjithësi, natyrisht duke mos i lënë anash drejtimet gjegjëse lëndore të fakulteteve tjera. Në arsimin parauniversitar nuk ka shkencë, por ka edukim dhe arsim, prandaj kuadrat e dala nga Fakulteti i Edukimit janë të përgatitura, kurse kuadrat që dalin nga fakultetet tjera janë më të predispozura për studime tjera shkencore, vazhdimi i studimit master dhe doktoratës.

Çështja tjetër është pranimi i parcializuar i studentëve në disa njësi akademike për vitin akademik ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Një minutë!

TEUTA HAXHIU: ...2011-2012 është shkelje flagrante e drejtimeve të nivelit, gjegjësisht të studentëve nga fakulteti, se kështu bëhet një ndasi, segregacion i tejskajshëm, është një ndasi e madhe në mes studentëve të fakulteteve tjera. Ndërkaq, nga ana tjetër, deklarimi publik i ish ministrit ka qenë që maturantët që kalojnë provimin e maturës, pranohen në fakultet sipas pikëve të fituara, ndërsa tani po del se po bëhet një pilot projektim. Nuk bëhet pilot projektim në Fakultetin e Universitetit të Prishtinës, kjo është vetëm një dështim i politikave zhvillimore të Universitetit të Prishtinës, më saktësisht të arsimit të lartë në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Deputeti i fundit, Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: I nderuar kryetar,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar mistria,
Të nderuar dhe të respektuar kolegë deputetë,
Një emërim i gabuar i cili duhet të rishikohet dhe të ndryshohet gjithsesi dhe patjetër. Prej se ekziston populli shqiptar dhe populli rumun, në historinë e tyre nuk njihet ndonjë periudhë armiqësie mes tyre dhe madje as edhe një konflikt i përgjakur apo ndonjë përplasje e interesave të tyre. Madje, madje në gjithë historinë e ekzistimit, nuk kanë qenë në konflikt as në shërbim të interesave të të tjerëve në asnjë periudhë të ekzistimit të tyre, populli rumunë dhe populli ynë. Në mbamendjen tonë populli rumunë dhe shteti i Rumanisë jo vetëm që nuk mbahen në mend për keq, por përkundrazi, vetëm për të mirë. Në mbamendjentonë deri tani Rumunia ka qenë e renditur në shtetet mike dhe të dashura e të respektuara. Kjo miqësi është krijuar sidomos nga koha e rilindësve, ku një numër i madh i korifenjve të rilindasve tanë kishin gjetur strehë e mikpritje në Rumani dhe nga atje kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në emancipimin e popullit tonë dhe në frymëzimin e kristalizimin e ideve çlirimtare dhe në përpjekje për liri e pavarësi.

Duke iu krijuar kushte për veprimtari botuese shumë të nevojshme për kohën, gjithashtu në këtë vend kanë gjetur kushte për mbajtje të kuvendeve dhe aktivitete tjera për përgatitjen e aktit të shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptarë. Dhe, prej atëherë, Rumunia në librat e historisë në kujtesën tonë historike është renditur në shtetet mike dhe në mbamendjen e popullit tonë është skeduar aureola e miqësisë sa herë përmendej apo vetëm kur kujtohej Rumania. Kështu ka ndodhur deri me rastin e vrasjeve të Mon Balajt dhe Arben Xheladinit dhe plagosjen e 81 qytetarëve tanë që protestonin në mënyrë paqësore nga policët Rumunë në radhët e UNMIK-ut.

Një tis tjetër mbi simpatinë e miqësisë tonë ndaj Rumanisë ka rënë edhe nga koha e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kur Rumunia hezitoi dhe heziton ende për ta njohur pavarësinë e Kosovës. Njohësit e mirë të realitetit i akceptojnë motivet e vërteta dhe reale që ekzistojnë përbrenda Rumanisë për të mos e njohur pavarësinë e Kosovës, por në asnjë mënyrë nuk e justifikojnë. Hezitimi për ta njohur realitetin tonë politik është i mjaftueshëm që lidërsipin aktual të shtetit Rumunë dhe çdo përfaqësues të Rumanisë në EULEX e shohin me të drejtë me rezerva dhe aspak me dashamirësi. Kështu ka ndodhur edhe me rastin e emërimit të rumunit në krye të Departamentit të Policisë Speciale të EULEX-it. Për të mos emëruar do të duhej të mjaftonte gjakosja e Prishtinës dhe e qytetarëve të Kosovës nga ana e policëve rumunë në misionin e UNMIK-ut. Ndërsa, edhe pa këtë gjakosje fare, të cilën nuk do ta harrojmë asnjëherë, do të duhej të mjaftonte që neve të kemi mosbesim dhe rezerva...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Hajde, 30 sekonda!

HALIT KRASNIQI:... edhe për faktin me mjaftë relevancë se ai vjen prej një shteti që nuk e ka njohur shtetin e Kosovës dhe shteti i tij vazhdon të udhëheqë politikë refuzuese për ekzistimin e shtetit të Kosovës. Rrjedhimisht, logjika e shëndosh na imponon të dyshojmë se ky do të veprojë si qytetar lojal i shtetit të tij. Nëse do të veprojë ndryshe nga qëndrimet e shtetit të tij, patjetër se do të kthehej në Rumani, pa ndonjë perspektivë në qëllimin i tij profesional dhe me qenë se është kështu, ky do të duhej të veprojë në dëm të funksionimit të shtetit të Kosovës. Duke qenë i bindur thellësisht në përshkrimin ...

KRYETARI: Faleminderit!

Kanë mbetur për seancën e ardhshme të radhës 3 deputetë: Gëzim Kelmendi, Fikrim Damka dhe Berat Buzhala.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45.1 të Rregullores së Kuvendi, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti 2 pyetje parlamentare.

Ne kësaj radhe kemi 5 pyetje dhe po fillojmë nga pyetja e parë. Deputeti Deputeti Salih Morina, pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë edhe sot është çështja e debatit rreth bisedimeve me Serbinë, unë kam një pyetje konkrete për zëvendëskryeministren zonja Edita Tahiri, që ka të bëjë kryesisht me çështjen e artefakteve. Koleksioni kryesor arkeologjik dhe etnologjik i Kosovës, i përbërë nga 676 eksponate arkeologjike dhe 571 eksponate etnologjike mbahet momentalisht peng edhe padrejtësisht në Beograd dhe pret kthimin në shtëpinë e tyre, në Muzeun e Kosovës. Vlera e tyre është jashtëzakonisht e madhe, meqë ky thesar arkeologjik dhe etnologjik i Kosovës janë kryevepra të trashëgimisë së luajtshme të Kosovës. Kjo çështje ka qenë e pranishme edhe gjatë procesit negociator për procesin e statusit përfundimtar të Kosovës dhe është e përfshirë në një nen të veçantë të pakos së Ahttisarit, Aneksi 5 mbi trashëgiminë fetare dhe kulturore, neni 6.1. Në këtë nen thuhet se Republika e Serbisë, brenda 120 ditëve, nga hyrja në fuqi e kësaj zgjidhjeje, do t'i kthejë artefaktet arkeologjike dhe etnologjike, të cilët janë marrë hua nga muzetë e Kosovës për ekspozim të përkohshëm në Beograd gjatë vitit 1998-1999. Edhe pse Lidhja Demokratike e Kosovës është kundër këtyre bisedimeve dhe njëkohësisht ka një agjendë të mirëfilltë se çka bisedohet në këto bisedime, lus zonjën zëvendëskryeministër që të na japë përgjigje se gjatë këtyre bisedimeve a do të kthehen artefaktet të cilat sot janë peng në Beograd. Faleminderit!

KRYETARI: Zëvendëskryeministër, e ke fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit!

I nderuar, kryetar i Kuvendit,

Të nderuar zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

I nderuar deputet Morina,

Trajtimi dhe zgjidhja e problemeve lidhur me trashëgiminë kulturore të Kosovës, të shkaktuara si pasojë e luftës në Kosovë, do të jetë në agjendën e dialogut teknik në rrethin e katërt të bisedimeve, që mbahet më 17 dhe 18 maj në Bruksel. Platforma e Qeverisë së Republikës së Kosovës për çështje të trashëgimisë kulturore mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në planin e Ahtisarit, si dhe në konventat ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore dhe kërkesat tona mes tjerash do të jenë:

1. Kthimi i ekspoziteve arkeologjike dhe etnologjike të muzeve të Kosovës, 2. Kthimi i dokumentacionit të monumenteve të trashëgimisë kulturore të Kosovës, të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.
3. Kthimi i koleksioneve arkivore të arkivave të Kosovës,
4. Sanimi dhe kompensimi i dëmeve në trashëgiminë ndërtimore të Kosovës, të shkaktuara nga forcat serbe gjatë luftës së viteve, sidomos 1998 -1999 në Kosovë dhe
5. Do të kërkojmë qasje që të normalizohet qasja publike dhe profesionale në vendet e trashëgimisë kulturore të Kosovës, të manastireve dhe kishave ortodokse në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

SALI MORINA: Po. A mendoni që kur bisedohet në përgjithësi për trashëgiminë kulturore, mos po marrin këto bisedime karakterin politik, jo teknik. Është fjala për trashëgiminë e përgjithshme, sepse ju përmendët manastiret, përmendët kishat, do të thotë mos po marrin një karakter tjetër politik, që ju keni thënë gjithmonë se është karakter teknik i këtyre bisedimeve.

KRYETARI: E ke fjalën, zëvendëskryeministre!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Ashtu siç kemi thanë, në fakt, jo veç që kemi thanë, por është platforma e Qeverisë së Republikës së Kosovës, që ka pranuar këto bisedime si obligim ndërkombëtar vetëm pse e kanë pasur karakterin teknik dhe këto bisedime do të mbeten me karakter teknik. Për sa i takon çështjes së trashëgimisë, qasja jonë është qasje profesionale dhe e depolitizuar, sepse trashëgimia është një vlerë universale. Madje ka pasur tendenca t'i vihet parashenja etnike, por ne gjithmonë si politikë qeveritare kemi insistuar që trashëgimia kulturore është universale dhe nuk mund të ketë parashenja të ndryshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Lutfi Haziri, pyetje për zëvendëskryeministrin Slobodan Petroviq.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zëvendëskryeministër,

Edhe javën e kaluar kryeministrit iu kam drejtuar me të njëjtën kërkesë. Meqë jemi në vitin e tretë të rishikimit funksional, si të drejtë të garantuar dhe nga i cili buron edhe Ligji për qeverisje lokale, atëherë ministria e juaj edhe ju jeni përgjegjës për konsultime shitesë me popullatë, me komunitete rreth themelimit të komunave dhe implementimit të ligjit. Në cilën fazë ju praktikisht gjendeni, në mënyrë që implementimi i ligjit në Kosovë dhe rishikimi i funksionalitetit të komunave, ndodhet pikërisht ministria e juaj?

KRYETARI: Zoti ministër e ke fjalën.

MINISTRI SLOBODAN PETROVIĆ: Poštovani predsedniče,

Zamenici premijera, ministri,

Uvaženi narodni poslanici,

Poštovani narodni poslaniciče Haziri,

U vezi sa ovim pitanjem, obaveštavam cenjenu narodnu Skupštinu, kao i vas lično. Ministarstvo za lokalnu samoupravu je primilo 7 zahteva za osnivanje novih opština iz različitih naselja i regiona na teritoriji Kosova. Ministarstvo za lokalnu samoupravu je u skladu sa zakonskim mandatom, nakon prihvatanja zahteva i razmatranja istih, preduzela sledeće aktivnosti: Formirana je unutrašnja komisija za izradu dokumenata, koju smo nazvali Principi i kriterijumi za osnivanje novih opština, a u sledu je i novi nacrt, draft kog dokumenta. Posle izrade prvog nacrta dokumenta – Principi i kriterijumi za osnivanje novih opština, isti je poslom u Međunarodnu civilnu kancelariju za eventualnu dopunu, kako se predviđa članom 14. opšteg pregleda za rešavanje statusa Kosova. Time smo želeli da osiguramo dodatni doprinos ovom dokumentu i u smislu sadržaja, a i naravno i zbog samog poštovanja procedura.

Nakon što se objave preliminarni rezultati nedavno održanih ili održanog popisa stanovništva i nakon odobrenja dokumenta u vladi, Principi i kriterijumi za osnivanje novih opština, preduzećemo sve mere za njihovu implementaciju, što će uključiti intenzivnije konsultacije, diskusije sa zajednicama, takođe i promenu i dopunu zakonodavne strategije vlasti za 2011. godinu i za eventualne promene i dopune Zakona za administrativne granice opština u skladu sa promenama koje se identifikuju tokom faze rasprava i intenziviranih konsultacija sa zajednicama, isto u skladu sa članom 12. Zakona za administrativne granice opština br. 03L/41. Ministarstvo za lokalnu samoupravu veoma polaže na transparentnosti, ujedno ulaže puno napora u uključivanje svih zajednica u davanje smernica opštinama u kojima žive. Od ključne je važnosti i za nas da doprinos daju oni čiji će životni standard zavisiti od rada tih opština. Ovim vas osiguravam i dajem značaj upravo javnim raspravama i procesu transparentnosti koji će svakako podrazumevati i uredno dostavljanje informacija i o ovom procesu Skupštini Kosova.

Cilj je svakako dostizanje visokog standarda demokratije. Koristim priliku da se i vama kao bivšem ministru ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetje shitesë?

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë me qëllim desha ta dëgjoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Pushtetit Lokal sa i përket kësaj çështjeje, sepse nuk mund të ndodhë asnjë zhvillim tjetër pa e parë funksionalitetin e komunave të reja të themeluara, sa kanë qenë efikase, sa janë realizuar, sa i kanë përmbushur kriteret. Meqë po lidhet gjithçka me regjistrimin e popullsisë, tash besojmë që në fazën e dytë, pyetja konkrete është për ju, ministër Petroviq. Meqë kryeministri ka thënë në fund të këtij viti dhe në fillim të viti të ardhshëm do të bëhet rishikimi i Aneksit 3 për pushtetin lokal dhe decentralizimin, a do të filloni tash me përgatitjet për rishikim të funksionalitetit, apo do të filloni me përgatitjet për themelimin e komunave të reja, në radhë të parë të shumicës shqiptare.

MINISTRI SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se narodni poslaniče na pitanju!

Ono što je jedan od prioriteta ovog ministarstva, jeste dalji proces decentralizacije i formiranje novih opština, u prvom redu formiranje nove opštine Severna Mitrovica, zašto očekujem i vaš veliki doprinos u tom delu. Proces za decentralizaciju je jedan od jako značajnih procesa i od strane naših prijatelja iz međunarodne zajednice ocenjen kao najbolji proces koji je do sada sproveden. Svakako da ima tu puno još rada i aktivnosti, očekujem da će i naši partneri koji su kako u Vladi, tako i sponzori na Kosovu dati svoj značajan doprinos. Očekujem da ćemo u periodu koji je ispred nas imati mnogo više prilika da radimo na konkretnim stvarima i prilika za konkretne rezultate. Svakako da proces decentralizacije je suštinski u interesu građana, bez razlike na opštine, bez razlike na ime i prezime. Ono što sam i mogao u ovih nešto više od 2 meseca da dam kao jasnu smernicu, jasnu poruku da kako ovo Ministarstvo, tako i ovoj Vladi na prvom mesto su njihovi ili naši građani i želimo da svaki građanin ima jednako priliku za bolji život. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Përmes kësaj pyetje dua të shpreh shqetësimin tim në lidhje me kushtet e të paraburgosurve në qendrat e paraburgimit dhe të atyre që vuajnë dënimin nëpër burgje të Kosovës.

Gjendja në këto burgje çdo ditë e më tepër është duke u përkeqësuar. Në njërën anë është në rritje numri i të paraburgosurve, një pjesë e të cilëve mbahen atje pa asnjë shkas, duke shërbyer vetëm për statistika. Krejt kjo si pasojë e mos funksionimit të drejtësisë dhe lidhjeve që ky sistem i ka me politikën dhe biznesin dhe, në anën tjetër, kjo lidhje mes politikës dhe drejtësisë u mundëson bredhjen në liri shumë kryesve të veprave penale.

Të burgosurit e kryejnë dënimin në kushte të këqija dhe shpesh mbi ta ushtrohet dhunë fizike e psikologjike. Disa nga qendrat korrektuese janë të mbipopulluara, janë evidente keqtrajtimet e të burgosurve, ndërkohë që cilësia e ushqimit që ofrohet është shumë e

dobët. Për më keq, pjesa dërmuese e produkteve ushqimore janë të prodhuara në Serbi e që janë të plasuara në treg përmes kontrabandës.

Të burgosurit ankohen edhe për kushte të rënda higjienike, ndërsa si pasojë e mungesës së ngrohjes, gjatë dimrit të fundit shumë të burgosur lëngojnë nga sëmundje të ndryshme. Mjafton të përmendet Pavijoni 2 i Burgut të Dubravës, ku të burgosurit kanë qëndruar në temperatura shumë të ulëta, ndërsa situata të ngjashme janë hasur edhe në qendra të tjera.

Për fund, më duhet të theksoj gjithashtu edhe çështjen e vizitave familjare, për organizimin e të cilave qendrat korrektuese në Kosovë janë larg standardeve ndërkombëtare. Këtu mjafton të përmendet Qendra e Paraburgimit në Prishtinë, ku në dhomën e vizitave familjare në të njëjtën kohë qëndrojnë 15 deri 20 familjarë në një hapësirë prej 8 metrave katrorë. Andaj, zoti ministër, si e shpjegoni gjendjen kaq të rëndë të të burgosurve dhe çfarë keni ndërmend të ndërmerrni për përmirësimin e këtyre kushteve? Ku po shkojnë mjetet e qytetarëve të Kosovës që janë të dedikuara për burgjet dhe po ashtu më intereson të dijë se çfarë masash keni ndërmarrë për tenderin e mishit? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti zëvendëskryeministër, e ke fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Haxhiu,

Ju falënderoj për pyetjen që ma keni shtruar, që është një prej problemeve që sfidohet edhe Ministria e Drejtësisë. Më lejoni që në fillim të koncentrohem në pyetjen tuaj që ka të bëjnë në veçanti për mjetet nga shkojnë. Nga buxheti total për 20.141.717 euro të Ministrisë së Drejtësisë, pjesa më e madhe, pra rreth 14.191.000 euro apo 70.44% shkon për Shërbimin Korrektues të Republikës së Kosovës. Prej kësaj shume, 4.200.000 euro shkojnë për ushqim dhe ngrohje për të burgosurit. Mesatarisht në Republikën e Kosovës shpenzohen 26 euro në ditë për një të burgosur. Kjo është ajo shuma që është paraparë me buxhetin e Republikës së Kosovës dhe unë i kam vizituar personalisht edhe Burgun e Dubravës, edhe atë të Lipjanit dhe unë nuk kam hasur te të burgosurit vërejtje tjera të cilat mund të ankohen për kushtet për trajtimin e tyre psikofizik apo tjetër. Po ashtu dua të them që nga data 22 shkurt, që jam emëruar si ministër i Drejtësisë, nuk ka asnjë letër i ndonjë të burgosuri i cili ka dërguar në Ministri të Drejtësisë dhe nuk ka marrë përgjigje dhe kjo do të ndodhë edhe tani edhe në të ardhmen.

E përmende çështjen e kushteve në burgje. Ju e dini po ashtu që ne kemi kushte të kufizuara, kemi paraparë që të ndërtojmë burgun e sigurisë së lartë, kemi paraparë në kornizën afatmesme të ndërtojmë Burgun e Prishtinës dhe Burgun e Gjilanit. Për këto është paraparë buxheti dhe unë besoj që në vitet e ardhshme do të ndodhë. Njëkohësisht më lejoni që të them që për çështjen që ka të bëjë me tenderim, Ministria e Drejtësisë dhe unë nuk merremi me ato çështje konkretisht, po përmes shërbimeve tona. Unë kam nënshkruar një vendim më 27 prill të këtij viti që, sipas ligjit, për sanksionet penale i barten të gjitha kompetencat administrative, financiare dhe prokurimit Shërbimit

korrektues të Kosovës dhe unë në ditët e para të emërimit si ministër kam dërguar një letër zotit Isa Mustafa, zotit Albin Kurti, zotit Blerim Shala dhe organizatave joqeveritare që të dërgojnë monitorues në procedurë të tenderimit në Ministrinë e Drejtësisë. Mund të them që organizatat joqeveritare kanë dërguar monitoruesit e tyre, por unë pres që partitë politike opozitare të bëjnë të njëjtën gjë.

Sa i përket tenderit që ka të bëjë me mish, unë e kam anuluar. Kam ardhur në një përfundim të tillë, është një procedurë që ka filluar pa qenë ministër, pasi që unë e kam marrë një qëndrim të kundërt të KRPP-së, një qëndrim të kundërt të OSHP-së dhe një qëndrim të kundërt të Agjencionit Antikorrupsion. I kam ftuar unë që të tre në zyrën time, OSHP-ja nuk ka ardhur për shkak të angazhimeve dhe kam konstatuar që ka dilema te ata. Për t'i hequr dilemat si ministër i Drejtësisë me qëllim të vënies së ligjshmërisë, e kam vënë pikën në pikën zero dhe do të rishpallet ai tender dhe në cilin do rast ju ftoj ju dhe qytetarët të ankimojnë për çështje të tilla. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë!
Deputete, ke pyetje shtesë?

ALBULENA HAXHIU: Zoti ministër, faleminderit për përgjigjen, edhe pse ishte e mangët në shumë pika. Megjithatë, unë për hir të opinionit më duhet të theksoj se çështjet e ngritura përmes kësaj pyetje parlamentare janë adresuar edhe në zyrën tuaj përmes një letre të dërguar nga të paraburgosurit dhe burgosurit, më datën 7 prill 2011. Unë e kam këtë përpara, besoj që edhe ti e ke marrë, me të cilët ata kërkojnë të drejtat e tyre, pra ato të drejta që janë në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Sa i përket tenderit të mishit, unë e di që është anuluar ai tender, mirëpo do të kishte qenë e udhës që të deklaroheni që të keni parasysh që ofertuesit që kanë prejardhje të mishit ose të produkteve tjera nga Serbia, të mos merren parasysh.

Unë shpresoj shumë që ju do të merreni seriozisht me këto çështje, në mënyrë që edhe të burgosurit, si kategori e qytetarëve, të gëzojnë të drejtat që u takojnë. Për më tepër, kjo duhet të jetë më prioritet për Qeverinë, sepse në të njëjtën kohë do të ishte investim në të ardhmen e së paku një pjese të zyrtarëve të lartë qeveritarë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, Albulena!

Kjo pjesa e fundit ishte paksa, nuk dihet aty, gjykata e di më mirë. Por, ajo çka mund të them, është se letrën që e përmendët ju, unë kam dhënë përgjigje, e them kam dhënë përgjigje, po se di a ju ka shkuar në dorë atyre njerëzve apo jo. Po e them prapë, përjashtimisht letrave anonime, nuk ka një letër në këtë vend që dërgon ose një email ose një SMS që unë nuk i jap përgjigje dhe unë po e them publikisht këtë.

Në anën tjetër, çka të them për prodhimet që e thatë nga Serbia. Unë po ju rikujtoj që jemi të obliguar ta respektojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në nenin 119 të Kushtetutës, ndër të tjera, thuhet: “Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të

barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme. Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes praktikave që kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara”. Ndërrojeni këtë nen, unë ju garantoj që e respektoj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Lutfi Haziri, pyetje për ministrin Memli Krasniqi.

Deputet, e ke fjalën!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,

Me Ligjin për buxhet, këtë vit është rregulluar statusi i punonjësve të Ministrisë së Kulturës, sepse aty ka qenë sindromi i kontratave në vepër, për vite të tëra është një veprim, por sipas ligjit, Ministria juaj dhe ju jeni të obliguar që ta definoni statusin e punonjësve dhe përformuesve kulturorë, ata nuk janë shërbyes civilë. Çfarë do të ndërmerrni në rregullimin e këtij statusit tash, si ministër?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, për pyetjen!

I nderuar deputet Haziri,

Siç je në dijeni, besoj edhe opinionimi i gjerë, që nga paslufta e deri më sot të gjithë krijuesit dhe përformuesit e kulturës, por edhe punonjësit në fushën e trashëgimisë kulturore nuk e kanë pasur të rregulluar statusin e tyre të punës. Janë mbi 300 punëtorë që punojnë në 16 institucione publike të kulturës dhe trashëgimisë kulturore, të cilët qe mbi 10 vite kanë kontrata mbi vepër dhe nuk kanë kontrata të rregullta të punës, si çdo kategori tjetër e punëtorëve të paraparë me ligjin në fuqi. Kjo qasje padyshim nuk ka qenë meritore për kontributin e madh që kanë dhënë këta njerëz, disa prej cilëve kanë punuar me dekada në krijimin dhe pasurimin e vlerave të kulturës sonë. Andaj, një ndër prioritetet kryesore të miat që nga dita e parë e punës ka qenë pikërisht zgjidhja e statusit të krijuesve dhe përformuesve të kulturës dhe të punonjëseve të trashëgimisë kulturore dhe qysh në fillim edhe me mbështetjen e gjithë Qeverisë së Republikës së Kosovës kemi arritur pajtueshmërinë që, siç e cekët, t’i legalizojmë mbi 300 vende të punës për këto kategori të cilat tashmë janë përfshirë edhe në Ligjin për buxhetin, që do të thotë në buxhetin e Kosovës për vitin 2011 janë miratuar edhe vende të punës, edhe pagat për këto kategori edhe këto paga do të kenë një ngritje të ndjeshme krahasuar me vlerën që e kanë marrë përmes kontratave mbi vepër. Pa dyshim, ky është një zhvillim jashtëzakonisht pozitiv, një ndryshim i madh në qasjen që ka qenë ndaj këtyre kategorive për më shumë se 10 vite.

Cili është hapi i ardhshëm? Si ministri, që besoj mund të jeni në dijeni, jemi duke punuar rreth finalizimit të një rregulloreje të re për gradim dhe kategorizim të gjithë punonjësve të institucioneve të kulturës, por edhe të trashëgimisë kulturore dhe besojmë se gjatë muajit maj kjo rregullore do të miratohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Menjëherë pas miratimit do të fillohet me procedura të përsheptuara për implementimin e plotë të kësaj rregulloreje me qëllim të zgjidhjes së statusit të të gjithë këtyre

punonjësve në kategoritë që i cekëm, pra krijues, përformues kulturorë dhe të trashëgimisë kulturore.

Pa dyshim, për të qenë më konkret në përgjigjen tuaj, neni 5 i Ligjit për shërbimin civil e parasheh një kategori të cilët nuk janë shërbyes civilë, por që paguhen nga buxheti publik, që janë publik dhe ky nen, ky ligj neve na mundëson që ta rregullojmë statusin e tyre konform kësaj dispozite ligjore. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, a ke pyetje shtesë?

LUTFI HAZIRI: Po, faleminderit!

Faleminderit, ministër!

Pikërisht neni 5 i Ligjit ka qenë i debatueshëm dhe është arritur që deputetët e Parlamentit ta pranojnë dhe ta votojnë kategorizimin e punonjësve dhe të performuesve e kulturës dhe t'i dallojnë nga shërbyesit civilë. Unë mirëpres që maji realisht të jetë muaji që definitivisht e rregullon statusin e tyre dhe përfundimisht sektori i fundit në Kosovë të rregullohet, sepse prapë edhe si shërbyes civilë u mbetet e padrejtë. Faleminderit, shumë! Nuk ke nevojë për përgjigje.

KRYETARI: Ndoshta ka nevojë për përgjigje?

Deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Do ta bësh pyetjen?

ALMA LAMA: Po, faleminderit!

Unë pyetjen do ta bëj, se kam përshtypjen që kryeministri për shkak të kësaj pyetje s'ka ardhur në seancë. Mirëpo, është mirë ta njoftoni që unë kam ndërmend ta bëjë në çdo seancë këtë pyetje, derisa të marrë përgjigje, kështu që më mirë të vijë, të mos fshihet.

Ndërtimi i autostradës Morinë – Merdarë është një projekt i cili vazhdon të mbetet enigmatik për sa i përket kostos. Deputetët e Kuvendit dhe qytetarët e Kosovës nuk janë informuar në lidhje me vlerën e kontratës, pavarësisht se është e drejtë e tyre të informohen dhe dihet që e paguajnë sigurisht taksapaguesit.

Duke e konsideruar me rëndësi të madhe transparencën në këtë çështje, shtroj pyetjen parlamentare, si më poshtë: Cila është vlera monetare, në shifër të saktë, e kontratës së nënshkruar mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konzorciumit amerikano-turk Bechtel & Enka, të datës 12 prill 2010? Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë miratimin e procesverbalit.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28 prill 2011

Të nderuar deputetë,

Pyes, nëse keni vërejtje në këtë procesverbal? Nëse nuk ka vërejtje, atëherë konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 28 prill 2011.

Në sallë janë prezentë 83 deputetë.

Nëse jeni dakord kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2010

A jeni dakord, nëse s'jeni dakord, një pauzë 15- minutëshe.

Vazhdimi i seancës pas pauze

Seancën drejton nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Po vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës.

4. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, në bazë të nenit 44.1 të Rregullores së Kuvendit i është drejtuar kryetarit të Kuvendit të Kuvendit me kërkesë për të ftuar në interpelancë kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi.

Ju njoftoj se në bazë të nenit 44.2 të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në 3 orë. Në bazë të nenit 44.7 të Rregullores së Kuvendit, përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në mbyllje të debatit deri në 5 minuta. Kjo kohë nuk i llogaritet Grupit Parlamentar për debat.

Në bazë të nenit 44.8 të Rregullores së Kuvendit, kryeministri paraqet dhe arsyeton qëndrimin e Qeverisë për çështjen e shtruar në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash. Koha e ndarë për diskutim sipas grupeve parlamentare dhe deputetëve pa grup parlamentar, është si vijon: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës për 34 deputetë ka 50 minuta të rezervuara, minus 8 minuta të rezervuara për kryeministrin të Grupit Parlamentar, që do të thotë ka 42 minuta hapësirë kohore për debat. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka 27 deputetë dhe ka 40 minuta kohë. Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” ka 14 deputetë dhe 20 minuta kohë, plus 10 dhe 5 minuta të rezervuar për kërkuesin e mocionit. Grupi Parlamentar i AAK-së, 12 deputetë, ka 18 minuta kohë, Koalicioni Kosova e Re, 9 deputetë, ka 13 minuta kohë, minus 2 minuta për kryeministrin, bëjnë 11 minuta krejtësisht. Grupi parlamentar SLS, 12 deputetë, ka 18 minuta, minus 3 minuta që janë të rezervuar për kryeministrin, do të thotë 15 minuta kohë ka. Grupi Parlamentar “6+”, 6 deputetë, 9 minuta, minus dy minuta për kryeministrin, i mbetin 7 minuta kohë. 6 deputetët pa grup parlamentar deri në 2 minuta, që do të thotë kanë 12 minuta ose, në përkthim ndryshe, pozita ka 90 minuta hapësirë kohore, minus 15 minuta të ndara për kryeministrin, do të thotë i mbetin 75 minuta. Opozita ka 78 minuta, deputetët pa grup parlamentar kanë 12 minuta.

Ftoj përfaqësuesin e parashtrimit të interpelancës të Grupit parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” që të marrë fjalën, 10 minuta kohë keni. Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Unë mendova që kryeministri Thaçi nuk erdhi këtu për shkak timin dhe temës së interpelancës, por ai njëmend nuk paska ardhur për shkak të Alma Lamës dhe pyetje së saj.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Këto bisedime as nuk janë inicuar dhe as nuk janë projektuar nga Kosova. Qëllimi i këtyre bisedimeve nuk po ndërtohet nga përputhja e qëllimeve të Kosovës dhe të Bashkimit Evropian apo qëllimeve të Kosovës dhe të Serbisë. Qëllimi i këtyre bisedimeve u ndërtua nga përputhja e qëllimeve të Bashkimit Evropian dhe të Serbisë, ku Kosova është veçse mjet. Prandaj, do të jetë Serbia dhe jo Kosova ajo që do të përfitojë nga këto bisedime. Serbia e fiton statusin e vendit kandidat dhe e forcon prezencën dhe ndikimin e saj në Kosovë, ndërsa Kosova pritet të marrë kopje të dokumentacioneve të plaçkitura.

Nëpërmjet Planit të Ahtisaarit territori dhe kultura në Kosovë u ndanë mbi baza etnike përmes komunave të reja me shumicë serbe dhe zonave të veçanta rreth kishave e manastireve ortodokse që u shpallën serbe. Në bisedimet në Bruksel po diskutohet që ndarja e këtillë të vazhdohet edhe me ndërmarrjet dhe shërbimet publike. Gjithçka në Kosovë do ta ketë anën e vet shqiptare dhe anën e vet serbe me këto bisedime. Ashtu sikurse në Bosnje, ku gjithçka e ka ose vulën boshnjako-kroate ose vulën serbe, ani pse thuhet që Bosnja është një shtet. Përdërisa shteti i Kosovës e ka pavarësinë më shumë në emër sesa në substancë, me këto bisedime po sajohet shteti i Serbisë brenda shtetit të Kosovës, që do të jetë i tillë më shumë në substancë sesa në emër.

Statusi i Kosovës nuk është një çështje abstrakte. Statusi i Kosovës reflektohet në secilën temë që po bisedohet në Bruksel, sepse statusi i energjisë, statusi i telekomunikacionit, statusi i lëvizjes së lirë, statusi i doganave e i vulave të tyre, statusi i transportit hekurudhor, rrugor e ajror, statusi i delegacionit tonë në CEFTA e tjera, nuk janë të njëjta sikur para shpalljes së pavarësisë, sikur pas shpalljes së pavarësisë. Pra, statusi i Kosovës përkufizon statusin e këtyre çështjeve. Shpallja e pavarësisë i ka bërë të gjitha këto çështje dhe shumë të tjera çështje të brendshme të Kosovës. Duke i diskutuar me Serbinë këto çështje, ato nuk janë më të brendshme dhe rrjedhimisht statusi i Kosovës praktikisht vihet në pikëpyetje. Pavarësia e definon një rregullim të caktuar të brendshëm të Kosovës dhe kontestimi i këtij rregullimi të brendshëm përmes diskutimit për të, me atë që nuk të njeh e kundërt të cilit e ke shpallur pavarësinë, gjithsesi përkthehet në kontestim të pavarësisë. Gjersa Serbia nuk na njeh, statusi mund të mos jetë nominalisht temë e bisedimeve, por praktikisht e realisht statusi është brenda secilës temë të bisedimeve. Pra, statusi nuk është njëra temë, por është në secilën prej temave.

Çfarëdo marrëveshje që të arrihet, çfarëdo kompromisi në Bruksel, do të jetë në kurriz të Kosovës sepse Kosova është temë e dialogut. Kontesti po zhvillohet për territorin tonë. Në bisedimet e deritanishme në Bruksel ende nuk është bërë asnjë marrëveshje me Serbinë dhe urojmë të mbetet kështu. Sigurisht që ka shumë arsye për të qenë të brengosur sepse zëvendëskryeministrja Edita Tahiri tashmë ka shprehur gatishmëri për kompromise në fushën e regjistrave civilë dhe të energjisë, për të cilat thotë se ka afrim pozicionesh.

Zëvendëskryeministrja Tahiri në raportimin e saj para Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme, më 8 prill të këtij viti, ma bëri të qartë se përgjegjësinë për këto bisedime të padrejta dhe fajin për dëmin e tyre e mban kryeministri Hashim Thaçi. Nisja e bisedimeve pa kushte, përpilimi i temave të bisedimeve dhe i renditjes së tyre, sipas zonjës Tahiri është rezultat i disa takimeve të ndara të këshilltarit të Baroneshës Ashton, Robert Cooper, njëherë me Hashim Thaçin e pastaj me Boris Tadiqin. Pra, për këtë dialog si të tillë, për temat që aty janë dhe për temat që aty s'janë, zonja Tahiri ma konfirmoi që përgjegjës kryesor është kryeministri Thaçi. Në pyetjen time, po citoj nga transkripti, faqe 23, "Kush i ka përcaktuar temat e këtij dialogu", zëvendëskryeministrja Tahiri përgjigjet: "Ju e dini, zoti kryetar, se që nga shtatori kur është miratuar kjo Rezolutë, kanë filluar vizitat e BE-së si në Kosovë, si në Serbi për të përgatitur këtë proces. Ka ndodhur një lloj brain storming që thuhet anglisht, pra një këmbim pikëpamjesh se çka mund të bisedohet dhe ajo për të hyrë në agjendë, secila palë e ka listën e vet, por kjo listë e çështjeve për t'u bërë çështje në agjendën e dialogut, duhet tre palët të japin pëlqimin: Kosova, Serbia dhe BE-ja." Më tutje, kur unë e pyes: "Kush nga pala kosovare ka marrë pjesë në këto parabisedime, në përcaktimin e temave dhe renditjes së tyre", zonja Edita Tahiri përgjigjet kështu, në faqen 37 të transkriptit: "Bisedat për përgatitje kanë ndodhur zakonisht midis ndërmjetësit Robert Cooper me kryeministrat e Kosovës dhe të Serbisë". Ndërkaq, në anën tjetër, në faqen 22, ajo deklaroi që "Mandati im buron", pra mandati i saj buron "nga autorizimet që kam marr nga Kryeministri" dhe se, po citoj: "Unë koordinoj me kryeministrin dhe kam kompetenca, deri në një instancë, por jo të plota. Në moment që vinë situata kur unë nuk mund të marr vendime, unë kthehem dhe bisedoj me kryeministrin".

Duke u bazuar në atë që thashë dhe raportimin e zonjës Edita Tahiri, kryeministri Thaçi duhet të përgjigjet në këto pyetje lidhur me bisedimet Kosovë-Serbi:

1. A njeh Qeveria e Republikës së Kosovës Republikën e Serbisë? Kjo pyetje është shumë e rëndësishme sepse kushtëzon shumëçka pastaj sa i përket këtyre bisedimeve dhe jo vetëm atyre. Ne natyrisht mendojmë se Republika e Kosovës nuk duhet ta njohë Republikën e Serbisë. Pikërisht duke mos e njohur Serbinë, ne mund ta iniciojmë reciprocitetin e shumëkërkuar.

2. Çka keni biseduar me këshilltarin e Ashtonit, Robert Cooper, në takimet që keni pasur në gjysmën e dytë të vitit 2010 dhe kur mund të na i sillni procesverbalet dhe transkriptet e atyre takimeve? Është e domosdoshme të na i sillni ato, meqenëse ju si kryeministër asnjëherë nuk keni raportuar në Kuvendin e Kosovës për këto takime me zotin Robert Cooper dhe nuk keni deponuar kurrfarë raporti për këto takime të cilat kanë përcaktuar agjendën dhe kontekstin e bisedimeve me Serbinë. Aq më tepër që rregullimi i temave është asisoj që Serbia do të duket konstruktive, se gjoja po lëshon pe në dialog, në mënyrë që të fitojë një opinion pozitiv nga Komisioni Evropian për marrjen e statusit të vendit kandidat.

3. Pse Qeveria e Kosovës nuk po imponon masa reciprociteti ndaj Serbisë, si përgjigje për bllokimin që Serbia ia bën Kosovës në çdo aspekt, në vend të lutjeve ndaj Serbisë për të na lënë të qetë?

4. A ekzistojnë apo jo transkriptet dhe procesverbalet nga bisedimet në Bruksel, e nëse ato ekzistojnë, atëherë a i ka kryeministri Thaçi ato, dhe nëse i ka, atëherë kur do të na i jep? Nëse raportimi i zonjës Tahiri në atë Komisionin Parlamentarë për Punë të Jashtme na e bëri të ditur që neve si deputetë nuk do të na i japin procesverbalet dhe as transkriptet, atëherë është e qartë që përgjithësisht po bëhet fjalë për shkallë shumë të lartë të konfidencialitetit në këto bisedime, ndërkohë që vazhdimisht thuhet se kemi të bëjmë veçse me dialog teknik. Merrni me mend, kemi konfidencialitet maksimal politik për tema të cilat janë minimale teknike.

5. A i ka kryeministri Thaçi pozicionet me shkrim të zonjës Tahiri dhe ekipit të saj në bisedimet në Bruksel, si dhe të konkluzioneve të arritura atje deri më tash dhe kur do të na i sjell ato? Ndonëse na i premtoi, zonja Tahiri nuk na i solli deri më sot ato në Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme.

6. A e keni pajisur zonjën Tahiri si Qeveri me Platformë të bisedimeve të cilën ajo na e premtoi se do të na e sjellë shumë shpejt, por as pas një muaji s'kemi asgjë prej saj? Zonja Tahiri po flet për zgjidhje të ofruara nga Kosova. Cilat janë ato zgjidhje? Qytetarët e Kosovës dhe Kuvendi si përfaqësues të qytetarëve duhet të jenë të informuar.

7. Zonja Tahiri po ashtu po thotë që edhe shtetet tjera kanë pranuar kopjet e regjistrave civil, domethënë qysh në start po shohim gatishmëri për kompromis. A do t'i pranoni ju këto kopje, pra a do të bëni kompromise në dëm të qytetarëve të këtij vendi?

Të gjitha këto pyetje, unë po ia lë një kopje këtu, në rast se nuk keni mbajtur shënime.

Në fund, kërkoj që të mos na përgjigjeni me kombinim të shprehjeve boshe të llojit “frymë evropiane”, “standarde evropiane”, “vlera evropiane”, “integrimi euroatlantik”, “bashkëpunimi rajonal”, “fqinjësia e mirë”, “ etj. etj. Këto janë pyetje konkrete që kërkojnë përgjigje konkrete. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas Rregullores, ftoj kryeministrin Hashim Thaçi që të paraqet qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me çështjen e shtruar për interpelancë. Hapësira kohore është 10 minuta.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryesues Haliti!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Fillimisht, më lejoni t'ju falënderoj për këtë mundësi që të kemi mundësi për të diskutuar në këtë interpelancë për procesin e deritanishëm të dialogut për çështje teknike mes

shtetit të Kosovës dhe Serbisë dhe një gjë të tillë jemi të gatshëm ta bëjmë edhe për çështje të dialogut, për çështje teknike, praktike që kemi diskutuar edhe me shtetet tjera fqinje, edhe me Maqedoninë, Shqipërinë dhe Malin e Zi.

Ndërsa sa i përket mungesës sime në pjesën e parë të seancës, unë kam pasur takime zyrtare, e di që ju mungoj shpesh dhe e ndieni atë mungesë timen, ndërsa për autostradë e di se edhe Alma është gëzuar shumë, sepse i krijohet një lehtësi shumë më e mirë dhe më e shpejtë e komunikimit me familje në Shqipëri. Ndërsa është e ftuar për të shtunën për të vizituar bashkërisht me mua një vizitë zyrtare, natyrisht krejt deputetët, punishtet e autostradës. Zyra ime është e hapur edhe si kryeministër për çdo deputetë, por edhe për çdo qytetarë të Republikës së Kosovës për këtë projekt dhe për çdo projekt që është plotësisht në transparencë dhe në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe me vullnetin e qytetarëve të vendit. Natyrisht, nëse dëshironi, edhe sa i përket pagave, mund t'ju informojmë përsëri.

Siç e dini, dialogu teknik mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, i filluar në mars të vitit 2011, paraqet një mundësi të mirë të zgjidhjes së problemeve të cilat janë si pasojë e qasjes destruktive, ndërhyrjeve ilegale dhe pengesat e krijuara nga ana e Serbisë për më shumë se një dekadë pas luftës, e në veçanti pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka hyrë në këtë dialog me një platformë të qartë parimesh mbi ruajtjen, avancimin e interesave shtetërore, të mbrojtjes së Kushtetutës së vendit dhe promovimit të politikës rajonale dhe asaj të jashtme të Republikës së Kosovës.

Natyrisht se ne nuk kemi iluzion se Serbia ka ndryshuar në qasje dhe mentalitet në raport me Kosovën nga e kaluara. Por, kemi besim se duke qenë partner serioz dhe konstruktiv i Bashkësisë Ndërkombëtare, i Bashkimit Evropian dhe i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke marrë pjesë aktive në dialog për të paraqitur argumentet tona të drejta, duke ekspozuar ndërhyrjet ilegale dhe manipulimet, por edhe pengesat nga ana e Qeverisë së Serbisë në raport me Kosovën, e sidomos me një pjesë të komunitetit serb në Kosovë, do t'ia dalim ta largojmë ndikimin e mbetur negativ të Beogradit, që ta shtrijmë pushtetin legal të institucioneve të Kosovës në tërë territorin tonë dhe do ta përshpejtojmë integrimin e brendshëm dhe atë euroatlantik të Republikës së Kosovës.

U tha këtu më herët se nuk duhet përmendur Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian, integrimet evropiane, NATO-n, por diçka e tillë është shumë e rrezikshme për popullin e Kosovës.

Prandaj, vullneti i qytetarëve të Kosovës, është vullnet për Kosovën evropiane, për miqësi të përhershme dhe speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për integrim të shpejt në NATO dhe Bashkim Evropian dhe mendoj se kjo është vija e kuqe e vizionit tim politik me qasjen që dëgjuam më herët dhe është edhe vullneti i popullit të Kosovës.

Ne nuk kemi të ardhme pa mbështetjen e partnerëve tanë euroatlantik dhe ne po e ndërtojmë shtetin tonë brenda Bashkimit Evropian, pra si pjesë e familjes euroatlantike.

Çdo qasje tjetër është qasje për të kthyer Kosovën mbrapa, që nuk mund të ndodh kurrë. Është qasje jo në përputhshmëri me vullnetin e qytetarëve të vendit dhe është plotësisht në kundërshtim me vizionin e politikës shtetërore dhe shumicës opozitare në Republikën e Kosovës, është qasje e izoluar dhe e minorancës, por nuk është plotësisht në përputhshmëri me vullnetin e fituar nga elektorati i njerëzve që u paraqitën më herët në binë.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që para jush të paraqes arsyet shtesë pse Qeveria e Republikës së Kosovës ka pranuar të jetë pjesë e këtij dialogu për çështje praktike me shtetin fqinj, Serbinë.

Refuzimi ndaj Serbisë nuk bëhet me ngritjen e zërit në Parlamentin e Kosovës, por me punët konkrete që janë bërë më herët për të larguar Serbinë nga Kosova.

U dëgjuan zëra këtu edhe më herët, të njëjtë që ishin dëgjuar edhe për Konferencën në Rambuje, kundër asaj Konference, por historike për Kosovën me komunitetin ndërkombëtar, gjë që rezultoi me lirinë e plotë të Kosovës.

U dëgjua zë i ngritur këtu kundër Serbisë, të atyre që ishin edhe kundër dialogut apo takimet tona me komunitetin ndërkombëtar në Vjenë, proces ky i cili solli shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës.

U dëgjua edhe zëri i lartë këtu kundër të gjithë partnerëve tanë dhe proceseve euroatlantike tash në këtë moment, kur Kosova është në rrugë të sigurt për t'u integruar edhe në NATO dhe në Bashkimin Evropian dhe kjo do të ndodhë.

Prandaj, është një kontinuitet i refuzimit të proceseve që e sollën lirinë, pavarësinë e Kosovës dhe procesit euroatlantik.

Pikë së pari, të nderuar deputetë, qytetarë të Kosovës, ne e shohim dialogun si obligim ndërkombëtar. Pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për legjitimitimin e pavarësisë së Kosovës, u bë e qartë në spektrin ndërkombëtar se pavarësia e Kosovës është një pakt dhe si i tillë nuk bie ndesh me të drejtën ndërkombëtare, përkundrazi, u legjitimua edhe ndërkombëtarisht. E di që edhe në atë kohë kishte zëra se Kosova është e papërgatitur për GJND, por Kosova fitoi dhe atë bindshëm, botërisht.

Me këtë sfond u iniciua edhe Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të datës 9 shtator 2010, e cila e njohu mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Kjo rezolutë e sponsorizuar nga Bashkimi Evropian dhe e mbështetur edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shumica dërmuese e shteteve anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, e fton Kosovën dhe Serbinë që të fillojë një dialog për normalizimin e marrëdhënieve të ndërsjella.

Rezoluta ndër të tjera paraqet edhe synimet e dialogut për vendosjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon, si dhe përmes këtij dialogu synohet promovimi i mëtejshmë i bashkëpunimit, arritja e progresit në procesin e integrimeve evropiane dhe përmirësimi i jetës së qytetarëve.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,
Kabinet qeveritar,

Serbia dhe Kosova nuk janë vendet e para dhe të fundit që kanë pasur konflikt të armatosur, por që kanë diskutuar pas konfliktit.

Serbia ka qenë në konflikt edhe me Kroacinë, Slloveninë, Bosnje e Hercegovinën dhe janë normalizuar marrëdhëniet si shtete.

Prandaj, ne kemi qenë në luftë, kemi fituar atë dhe duam të vëmë paqe, stabilitet dhe bashkëpunim rajonal në kuadër të vlerave euroatlantike, por gjithmonë si dy shtete të pavarura dhe, ky dialog për herë të parë në historinë e Kosovës është dialog i barabartë mes përfaqësuesve legjitim të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, gjë që më herët ka munguar.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “6+”, 7 minuta ia ka dhënë kryeministrit. Faleminderit!
Edhe 7 minuta i keni.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Duke marrë parasysh Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe mbështetjen e fuqishme të Grupit Drejtues Ndërkombëtar për Kosovën, për një dialog teknik mes dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, të shprehur me deklaratën e datës 8 shkurt 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës e sheh dialogun, pra, si një obligim ndërkombëtar, në përputhshmërinë me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës për fuqizimin dhe konsolidimin e shtetit të Kosovës.

Dialogu teknik ndërshtetëror paraqet mundësi të mirë për progresin e mëtejshmë të Kosovës drejt arritjes së këtij synimi, procesit të integrimit në kuadër të dialogut, siç e sheh Qeveria e Kosovës, i cili zbatohet në tri nivele:

Në nivelin e parë, janë problemet praktike me të cilat përballen qytetarët, qytetarëve të Kosovës që nga paslufta u rendojnë natyrisht pengesa e manipulime që janë bërë dhe vazhdojnë t’ju bëhen nga shteti i Serbisë.

Në nivelin e dytë, është zbatimi i një nga parakushtet më të rëndësishme të procesit të integrimeve evropiane, ai i bashkëpunimit rajonal, i nderuari kryesues, tjetër herë kur të ftoni interpelancë, është mirë të krijoni hapësirë për të diskutuar dhe paraqitur atë që kemi për të paraqitur, megjithëse nuk është në përgjegjësinë tuaj, por ta gjejmë një hapësirë për të diskutuar dhe jo vetëm për të lexuar shpejtë e shpejtë atë që kemi për të

prezantuar, qoftë Qeveria, qoftë deputetët nëse është e mundur në kuptimin e Rregullores së Punës së Kuvendit.

Ndërsa, niveli i tretë është faktori Bashkim Evropian, që është pjesë substanciale e procesit të dialogut.

Të nderuar deputetë,

E theksova që Qeveria e Kosovës dëshiron fqinjësinë e mirë, normalizimin dhe avancimin e marrëdhënieve me të gjitha shtetet e rajonit dhe respektimin e obligimeve ndërkombëtare. Por, ne si institucione të Kosovës kemi vendosur edhe vijat e kuqe për çështje të cilat në asnjë mënyrë nuk do të jenë pjesë e asnjë dialogu të mundshëm.

Këto parime të panegociueshme apo vija të kuqe janë:

Statusi i Kosovës është zgjidhur njëherë e përgjithmonë; Kosova është shtet i pavarur dhe sovran; pavarësia e Kosovës është e panegociueshme; Kosova është shtet i pavarur me integritet territorial të paprekshëm, të njohur ndërkombëtarisht.

Shteti i Kosovës është i njohur nga pjesa më e fuqishme e Bashkësisë ndërkombëtare, nga 75 shtete, në mesin e të cilave janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shumica e vendeve të Bashkimit Evropian, shtet e rajonit e më gjerë. Kosova është anëtare e Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe procesi i njohjeve do të vazhdojë.

Dy nga vijat e kuqe, sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Rregullimi i brendshëm i vendit është kompetencë sovrane e institucioneve shtetërore të rregulluara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pastaj plani i presidentit Ahtisari, është platforma për rregullimin e të drejtave dhe garancive të komuniteteve dhe i njëjti është për t'u integruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Plani i Ahtisaarit ofron kompetenca të veçanta për komunitetin serb dhe komunitetet tjera, për çfarë jemi pajtuar krejt.

Pra, Qeveria e Kosovës është duke zbatuar Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për dialog ndërshtetëror mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë, ndërsa do të informojmë rregullisht Parlamentin e Kosovës, ndërsa për çështjet madhore, çështjet që janë të rëndësishme së veçantë, natyrisht të marrëdhënieve ndërshtetërore, do të kërkohet ratifikimi nga Parlamenti i Kosovës. Ndërsa theksoj se edhe Presidenca është e informuar për takimet në Bruksel.

Ndërsa, sa i përket leximit të transkripteve nga takimet që janë zhvilluar në Komisionin për Politikë të Jashtme, nuk do të komentoja ato pyetje dhe përgjigje.

Por, theksoj, Kosova ka vënë vijat e kuqe dhe dialogu është ndërshtetëror mes Kosovës dhe Serbisë.

Se a e njeh Kosova Serbinë apo jo, Kosova është e gatshme për njohje reciproke, pra që Kosova ta njeh Serbinë dhe Serbia Kosovën si shtet.

Se çka kanë biseduar në Uashington dhe Bruksel me përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian, natyrisht kjo çështje e interesit ndërshtetëror dhe mund të bisedojmë çdo herë në Parlament, në Qeveri dhe të gjitha bisedimet apo takimet edhe në Uashington edhe në Bruksel janë transparente dhe të respektimit të shtetit të Kosovës.

Sa i përket transkripteve të takimeve në Bruksel, tash ne do ta prezantojmë në rast të arritjes së ndonjë avancimi të këtyre proceseve të dialogut për ratifikim në marrëveshje ndërshtetërore në Parlament dhe se a ka zëvendëskryeministrja Tahiri platformë, e theksoj, nga rezoluta e nxjerrë e Parlamentit të Kosovës, Qeveria e ka platformën e shtetit të Kosovës për dialog teknik edhe me Serbinë, por edhe me vendet tjera të rajonit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Unë jam plotësisht dakord me vërejtjen tuaj. Me rregullore thuhet që kryeministri ka të drejtë ta marrë fjalën sa herë ka nevojë dhe e ka kohën e pakufizuar, po rregullorja që e kemi miratuar, e ka kohën e kufizuar për interpelancë, prandaj shpresoj që duhet të rregullohet kjo çështje me amendament ose me rregullore të re. Nuk mundet një vend ta ketë të ndaluar që ta thotë fjalën e tij në mënyrë të pakufizuar dhe në një vend tjetër të mos e ketë të ndaluar.

Sipas radhës, kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Deputet, kryeministër, ministra,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike t'ju përshëndes dhe njëherësh të falënderojmë kryeministrin Hashim Thaçi dhe Kabinetin e Qeverisë për gatishmërinë e treguar për këtë interpelancë të kërkuar nga Lëvizja "Vetëvendosja" lidhur me bisedimet Kosovë – Serbi.

Kjo gatishmëri e juaja paraqet një formë të transparencës dhe komunikimit qytetar e institucional për çështje të mëdha që ka para veti Kosova gjatë kohës që është duke bërë drejtë plotësimin të standardeve që kërkon Bashkimi Evropian. Si parakusht për arritjen e aspiratave që Kosova si shtet demokratik e paqësor po tregon interes të vazhdueshëm dhe gatishmëri e konstruktivitet që me formë shumë atraktive po iu qaset çështjeve të hapura që politika dhe lufta e lënë tani më mbrapa nesh, ka gjeneruar edhe çështje e probleme teknike, të cilat duan dhe kërkojnë angazhim e përgjegjësi institucionale që përmes dialogut, bisedimeve të zgjidhen në dobi të qytetarëve të Republikës dhe në dobi të fqinjësisë së mirë në rajon e më gjerë.

Këto bisedime i kemi kuptuar si angazhim që Qeveria e Republikës së Kosovës ka pranuar obligimin ndërkombëtar për të hyrë në dialogun teknik ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë konform rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të datës 9 shtator 2010, dhe në përputhje me kompetencat kushtetuese të Qeverisë për të ushtruar sovranitetin shtetëror me politikën e jashtme të vendit, sipas nenit 93.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe duke u mbështetur në respektimin e plotë të Rezolutës së Kuvendit të Kosovës, të datës 10 mars 2011.

Po ashtu, duke rikujtuar edhe një herë parimet e panegociueshme që janë të Partisë Demokratike edhe shumicë së deputetëve të Parlamentit të Kosovës, po ju rikujtojmë edhe një herë Rezolutën e miratuar në Kuvend.

1. Statusi i Kosovës është i zgjidhur tanimë. Kosova është shtet i pavarur, sovran, me integritet territorial të paprekshëm dhe Kushtetutë moderne të njohur ndërkombëtarisht. Gjykata Ndërkombëtare për Drejtësi ka konfirmuar ligjshmërinë e Deklaratës së pavarësisë së Kosovës, më 22 korrik 2010. Shteti i Kosovës është njohur nga pjesa më e fuqishme e Bashkësisë Ndërkombëtare, nga 75 shtete, në mesin e të cilave edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shumica e shteteve të Bashkimit Evropian, shtetet e rajonit e më gjerë. Kosova është anëtare tanimë e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe procesi i njohjeve është në rritje e sipër.

2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

3. Rregullimi i brendshëm i vendit është kompetencë sovrane e institucioneve shtetërore, e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Plani i Ahttisarit është platforma për rregullimin e të drejtave dhe garancive për komunitetet dhe i njëjti është integruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Plani i Ahttisarit ofron kompetenca të veçanta për komunitetin serb dhe, si i tillë, madje është më shumë se që ofron e drejta ndërkombëtare për minoritetet.

Duke dashur që ta komentoj pikën 7 të interpelancës së shtruar nga “Vetëvendosja”, që kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, është përgjegjës për këto bisedime, them me një “po” të madhe, sepse Hashim Thaçi ishte përgjegjës që me analizën e vuajtjeve shekullore të Kosovës arriti të drejtojë delegacionin e Kosovës në Rambuje dhe e fituam paqen dhe simpatinë ndërkombëtare. Hashim Thaçi mori pjesë aktive në Marrëveshjen e Ahttisarit dhe vlerësoi vullnetin e popullit të Kosovës, ku shpalli mëvetësinë e vendit. Hashim Thaçi, në cilësinë e kryeministrit është duke e respektuar vullnetin qytetar dhe duke përmbushur obligimet kushtetuese të Republikës së Kosovës që çështjet e hapura me Serbinë do t’i mbyllë në këtë mandat dhe Kosova do i lehtësojë Bashkimit Evropian vendimmarrje që vendit tonë t’i hapë rrugë për në Bashkimin Evropian.

Po ashtu, më lejoni që të përgëzoj edhe drejtuesen e bisedimeve, zonjën Edita Tahiri, e cila vlerësohet nga Grupi ynë për angazhimin, konstruktivitetin dhe atraktivitetin në

drejtimin e këtyre bisedimeve. Edhe pse në korniza të përafrimit, pa asnjë kompromis dhe ratifikim ligjor, besojmë thellë që dy shtetet dikur në armiqësi dhe sot në tavolinën e Bashkimit Evropian dhe përkujdesjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, së shpejti arsyetja do të triumfojë që Ballkani të jenë pjesë e paqes dhe e zhvillimit.

Në fund fare, ne e vlerësojmë shqetësimet e pabaza të “Vetëvendosjes”, sepse janë edhe qëndrime programore të saja, e që koha i ka demontuar dhe lenë historisë që nga Ramgujeja e deri te mëvetësia e vendit, që është kundërshtuar vazhdimisht, por vlerësojmë lartë edhe angazhimin e të gjithë deputetëve të opozitës dhe nacionaliteteve tjera që bisedimet teknike dhe çështje të hapura me shtete që na rrethojnë, t’i zgjidhim sa më shpejt.

Duke shfrytëzuar hapësirën kohore për interpretim të procesverbalit, të cilin e komenton zoti Kurti në mënyrë segmentare, duke humbur pjesën e përmbajtjes dhe konceptit të plotë, dua të komentoj disa pika në të cilat thirret nga cilësia e anëtarit të Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë.

Në disa pika, zoti Kurti devijon konceptet përmbajtjesore dhe thirret vetëm në ato segmentare për të krijuar në opinion bindje se në Kosovë delegacioni ynë është i padenjë dhe Serbia është duke fituar në territor. Për shembull, tek pyetja në faqen 22, ku thuhet se Edita Tahiri, pyetet: Cili është mandati juaj dhe cili është dokumenti formal, ku bazohet mandati i juaj, nuk e përfundon komplet fjalinë kur thotë se kthehem dhe e pyes kryeministrin, sepse thotë - unë i kam vijat e kuqe deri ku unë mund të bisedoj dhe përtej vijave të kuqe nuk mund të dal, kështu që humbet përmbajtja e kuptimit çka do të thotë përfaqësuesja në këtë takim. Në faqen 23, Kurti ka përcaktuar tema të këtij dialogu, në fakt, temat edhe më tutje, deklarohet zonja Edita Tahiri, mund të shtohen vetëm në suazat e karakterit teknik, për dy palët, dy palët janë duke biseduar. Ju e dini, zoti kryetar, se që nga shtatori, kur është miratuar kjo rezolutë, kanë filluar vizitat e Bashkësisë Evropiane, si në Kosovë, si në Serbi, për të përgatitur këtë proces. Dhe, nëse nuk kishte pasur Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, me kënd të bisedojnë, përveç me kryeministrin, unë nuk e di me të cilët jashtëtokësor duhet të bisedohet për çështjen e Kosovës, prandaj nuk duhet të krijohet huti para opinionit.

Në faqen 37, kush nga pala kosovare ka marrë pjesë në këto parabisedime në përcaktimin e temave dhe renditjes së tyre? Ka marrë Kushtetuta e Republikës së Kosovës, që ia jap të drejtën kryeministrit ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe implementimin e politikave dhe obligimeve për dialog. Ju faleminderit shumë! Duke ju garantuar që nëse keni propozime konkrete, përveç konkludimeve në pyetje edhe gjatë bisedimeve ju kemi treguar, nëse ka nevojë për përfundimin e dialogut verbal dhe miqësor, ekzistojnë edhe format tjera të dialogut. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: I nderuar zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ajo që Lidhja Demokratike e Kosovës e ka thënë si qëndrim para fillimit të këtij, të ashtuquajtur dialog, skepticizmi i saj u vërtetua plotësisht gjatë javëve që i lamë pas.

Fillimi i dialogut pa platformë të qartë, po e përsërisim edhe një herë, pa një qëllim të qartë se çka dëshirohet me këtë dialog, çka fiton Kosova me këto bisedime, me marginalizim të rolit të Kuvendit, me bisedime pa transparencë, me agjendë thuaja se ad-hoc, janë disa nga çështjet që vazhdojnë të na shqetësojnë dhe të na bëjnë të besojmë se rezultate pozitive për Kosovën nga bisedimet e tilla nuk ka dhe nuk do të ketë.

E kemi thënë edhe më herët, po e përsërisim edhe sot se pabarazia në një mënyrë në bisedime, është që nga vetë niveli i përfaqësimit të delegacioneve. Sjellja e zyrtarëve serbë, gjegjësisht qatipëve serbë gjatë bisedimeve me tentim të krijimit të një përshtypje, gjëja dëshirës së tyre për të qenë konstruktiv, e paraqitjet e tyre mediale dhe urdhërdhënësve të tyre krejtësisht në kundërshtim me këtë, deri te paraqitja edhe e ideve edhe për ndarje dhe për pashmangshmërinë, gjëja të asaj se statusi i Kosovës nuk është i përfunduar, e që ne e shohim edhe si dëshirë të tyre, por edhe si rrezik që edhe kjo mund të ndodhë, të prekët si çështje e rëndësishme së veçantë, pra statusi politik në këto, po e përsëris, të ashtuquajtura bisedime, çka për ne sigurisht është e papranueshme. Konsiderojmë dhe besojmë thellë se bisedimet e gjertanishme janë sa për t'u quajtur bisedime, janë shterpe. Po e përmend vetëm një çështje që u përmend edhe më herët, ajo e librit kadastral ose e librave kadastral edhe regjistrave civilë. Ato janë libra tonë kadastral dhe Serbia "ka zbutur zemrën" dhe ka shprehur gjëja gatishmërinë të na i jap kopjet e tyre. Me çfarë të drejte dikush prej nesh do të pranonte diçka të tillë, t'ua lëmë atyre atë që është e jona.

Bisedimet dhe qasja e Serbisë, është e njëjta, arrogante, për konsum të brendshëm dhe, sigurisht, vetëm për interesa të ngushta të shtetit serb. Krijimi dhe prezantimi i një platforme të qartë për këto bisedime, synimet se çka dëshirohet me to dhe krijimi i një ambienti të nevojshëm për këto bisedime, janë parakushte për sukses eventual të tyre. E para, si parakusht dhe ambient do të ishte vetë tërheqja e strukturave jo paralele, por strukturave ilegale serbe, sepse atje ne nuk kemi institucione, që sot veprojnë në shumë pjesë të territorit të Kosovës dhe jo vetëm në veri të Kosovës, ndërmarrja e veprimeve praktike për ndalimin e veprimtarisë së këtyre strukturave ilegale. Derisa propagohen bisedat dhe bëhen disa takime në njërin anë, në anën tjetër Serbia vazhdon të cenojë integritetin e vendit tonë, vazhdon t'i intensifikojë veprimet e saja ilegale të natyrave dhe në mënyra të ndryshme, prej ushtrimit faktik të pushtetit lokal në disa komuna të Kosovës, shtypja e tabelave dhe qarkullimi i lirshëm i automjeteve me targa serbe nëpër pothuaj se tërë territorin e Republikës së Kosovës, pa asnjë pengesë. Veprimtaria e mëtejme ilegale e rrjetit të telekomunikacionit, sistemet ilegale shëndetësore, arsimore, cenimi i vazhdueshëm i sigurisë së qytetarëve shqiptarë nga ekstremistët serbë, veçmas në komunat me shumicë serbe.

LDK-ja edhe një herë përsërit qëndrimin e saj se bisedimet me platformë të qartë, ambient të përshtatshëm, definim të saktë se çka mund të dhe çka nuk mund të

bisedohet, çka dëshirohet të arrihet me këto bisedime, me përfaqësim të njëjtë nivelesh, me rolin e pazëvendësueshëm të Kuvendit në këto bisedime, me kycjen e drejtpërdrejtë dhe me rolin edhe më të madh që duhet ta luajnë SHBA-të në këtë proces, së bashku me vendet e BE-së, si të tilla mund të ketë optimizëm për ndonjë rol pozitiv.

Më lejoni të shpreh kënaqësinë se më në fund zoti Thaçi, ka disa vite ka evoluar pozitivisht në të kuptuarit e doktrinës së LDK-së, që e ka pasur edhe të presidentit historik, dr. Ibrahim Rugova, në atë se miqësia e përhershme dhe marrëdhënie speciale ose të veçanta me SHBA-të, është e rëndësishë së veçantë. Vërtet, është mirë që këtë e ka marrë vesh së paku prej se është në krye të ekzekutivit, gjë që më herët nuk ka qenë thënie e tij bile as përkrahje edhe në veprime. Fatkeqësisht, rrjedha e gjertanishme e bisedimeve lë pak hapësirë për të qenë optimist, sepse në mes tjerash Serbia është ajo që ka qenë e njëjta, shtet jodemokratik, hegjemonist, shtet i viteve të errëta të një shovinizmi, veçmas në raport me ne, në raport me Kosovën.

LDK-ja ka qenë dhe është për të dialoguar me fqinjët për atë që mund të dialogohet, që janë çështje të interesit reciprok, për ne si shtet i pavarur dhe për shtetet tjera, duke përfshirë edhe Serbinë dhe vendet tjera, por assesi nuk përkrahim asnjë lloj bisede apo vendimi që në çfarëdo mënyre rrezikon pavarësinë, integritetin dhe sovranitetin e shtetit të Kosovës. Ne do të përcjellim me vëmendje, si Lidhje Demokratike e Kosovës, si grup parlamentar ecurinë e këtyre bisedimeve dhe fuqishëm do të reagojmë dhe do t'i kundërvihemi çdo veprimi apo vendimi që bie ndesh me interesat e shtetit tonë, Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për replikë, kryeministri. Nuk llogaritet koha e replikës.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë dua vetëm të sqaroj para juve, deputetë të nderuar, por edhe para qytetarëve të Republikës së Kosovës, se nga ajo që kisha unë për të prezantuar, deri me tani vetëm 10% e kam prezantuar në mungesë të kohës. Prandaj, çështja është e ndjeshme, e rëndësishme për qytetarët, për vendin dhe pyetjet natyrisht janë të tilla që kërkojnë sqarim, kërkojnë transparencë të plotë, siç e kemi bërë gjithmonë dhe kjo është një diçka që sot po na mungon për ta prezantuar gjithë atë që e kishim ne si Qeveri për të prezantuar. Por, në anën tjetër, dëshiroj të theksoj se ne duhet ta respektojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe unë do ta respektoj në përpikëri. Ata që s'e kanë lexuar drejt apo që mendojnë vetëm politikisht, më lejoni që t'i lexoj vetëm kompetencat e Qeverisë.

Qeveria ka këto kompetenca, neni 93: "proponon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit. Qeveria, për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Kosovës". Diçka të tillë jemi duke bërë dhe do të vazhdojmë të bëjmë dhe kjo përgjegjësi jona bëhet edhe nga Rezoluta që ju e keni aprovuar dhe na keni dhënë këtë mandat të dialogojmë. Ndërsa, tek marrëveshjet ndërkombëtare, e theksoj edhe një herë, jo vetëm të menduarit politik, por të respektimit të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës, thotë:

Neni 17: “Republika e Kosovës lidh marrëveshje ndërkombëtare dhe anëtarësohet në organizata ndërkombëtare, Republika e Kosovës merr pjesë në bashkëpunim ndërkombëtar për promovimin dhe mbrojtjen e paqes, sigurisë dhe të drejtore të njeriut”.

Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, neni 18. “Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e 2/3 të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshje ndërkombëtare për këto çështje: territorin; paqen; çështjet politike dhe ushtarake, të drejtat dhe liri themelore, anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare, marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës. Marrëveshjet ndërkombëtare, me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga presidenti i Republikës së Kosovës” Kështu që, unë si kryeministër dhe Qeveria e Kosovës, i njohim kompetencat tona, autoritetin tonë, obligimet tona kushtetuese dhe gjithçka kur të arrijnë në përmbyllje për ratifikimin e marrëveshjes ndërshtetërore mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, do të kalojë përmes Parlamentit të Kosovës. Por, e ritheksoj edhe një herë se Qeveria propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme dhe do të respektojë në përpikëri Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Sa i përket autostradës, dëshiroj të theksoj edhe një herë përsëri, se e pash që ju mbeti merak, dje ka filluar autostrada energjetike me Shqipërinë dhe integrimet bëhen me vepra dhe jo me fjalë. Sa i përket presidentit Rugova, unë kam qenë gjithmonë kundër atyre që kanë bërë shumë të këqija dhe kanë shkuar dhe janë përlulur me lot krokodili para varrit të presidentit Rugova apo komandantit legjendar, Adem Jashari. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Pas asaj çka dëgjuam në dy fjalimet e deritashme të kryeministrit Thaçi, s’po po kam se si të mos ua jap një sugjerim të gjithë deputetëve që kurrë mos i bëni kryeministrit pyetje, se pse është vjedhur droga në Polici, se menjëherë del te integrimet evropiane, as mos e pyetni kurrë qysh është vjedhur Dhoma e Dëshmive dhe Provave, sepse del te integrimi në NATO.

Sot kur ishte koha për t’u përgjigjur për pyetjet e autostradës, nuk ishte këtu, kurse kur ju bë pyetja a i keni transkriptet e negociatave, doli te autostrada. Kjo flet për seriozitetin e kryeministrit tonë. Kur e patëm pyetur kryeministrin Thaçi për bisedimet me Serbinë menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, ai pati thënë se negociatat me Serbinë kanë përfunduar. Tash tri vjet pas pavarësisë, tash kur Kosova do të duhej të ishte më e fortë, sepse jemi shtet i pavarur, apo jo, kemi një Qeveri e cila sërish përfundoi me negociata me Serbinë. Kjo do të thotë që kryeministri na ka mashtruar. Shtrohet pyetja - Pse tash duhet t’i besojmë atij për përmbajtjen dhe qëllimin e vërtetë të këtyre negociatave?

Qeveria ka qenë krejtësisht e mbyllur për qytetarët e Kosovës deri tash lidhur me këto negociata. Në emër të besueshmërisë, është shkelur transparenca. Por, për aq sa dimë e

kemi informata, këto janë negociata që kanë filluar tash e dy muaj, e kanë dëmtuar Republikën e Kosovës në disa aspekte. Edhe pse Qeveria negociatat po i quajnë teknike, ato po i prekin drejtpërdrejt shtetësinë e Republikës së Kosovës. Së pari, është cenuar seriozisht sovraniteti i Republikës sonë, sepse përmes negociatave, Beogradi që po e lufton pavarësinë e Kosovës, është legjitimuar si palë e çështjeve që i takojnë shtetit të Kosovës.

Serbia nuk duhet të vendosë për qytetarët dhe territorin tonë. Serbia ka vendosur një shekull për Kosovën dhe pasojat i dimë të gjithë. Qeveria e Kosovës, me strategjinë e saj të gabuar, ka lejuar që Beogradi t'i kontrollojë territoret e banuara me serbë, të vendosë për dokumentet e tyre të shtetësisë, t'i financojë strukturat paralele që e minojnë sovranitetin tonë, ta furnizojnë ilegalisht veriun me energji elektrike dhe operatorë ilegal të telefonisë. Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës me mosveprimin e saj për zbatimin e obligimeve kushtetuese që e detyrojnë atë për mbrojtjen e integritetit territorial, ka pasur shumë mirëkuptim, madje mirëkuptim absolut, për agresionin e Serbisë mbi kufijtë e Kosovës, respektivisht e kam fjalën për pikat 1 dhe 31, që mbeten edhe sot e kësaj dite të depërtueshme nga krimi i organizuar dhe kontrabanda. Në anën tjetër, po ashtu, mallrat e Serbisë pa kontroll e kanë vërshuar Kosovën, kurse Serbia nga ana tjetër nuk po e zbaton marrëveshjen e CEFT-ës dhe Qeveria e Kosovës nuk po ndërmarr asnjë hap.

Problemi kryesor në mes Kosovës dhe Serbisë, se u përmend prej kryeministrit, raporti në mes Kroacisë dhe Serbisë, nuk është mungesa e komunikimit e as e negociatave, siç po arsyeton edhe EULEX-i dhe Qeveria. Problemi kryesor në mes Kosovës dhe Serbisë është hegjemonia e Serbisë dhe dorëzimi i Qeverisë të Kosovës përpara këtij agresionit të Serbisë. Ky është problemi. Shtrohet pyetja - pse dy armiq aq të përbetuar vetëm para pak vitesh, siç ishin Kroacia e Serbia, sot jetojnë si fqinjë të mirë? Shumë është e thjeshtë përgjigja, për shkak se fqinjësia, paqja dhe respekti vjen nga sovraniteti e jo nga mungesa e komunikimit dhe e negociatave. Komunikimi i mirë vjen nga reciprociteti i sovraniteteve, e jo e kundërta.

Qeveria e Kosovë është përgjegjëse pse funksionojnë strukturat paralele të Serbisë në Kosovë dhe pse Serbia nuk po na njeh, për shkak se deri sot Qeveria nuk ka bërë asnjë hap që ta detyrojë Serbinë, në ndonjë farë mënyre ta ndryshojë qëndrimin e saj ndaj Kosovës, e Serbia nuk do ta ndryshojë mendimin dhe qëndrimin ndaj Kosovës vetvetiu e as për qejf, aq më pak për shkak të negociatave. Ajo do ta ndryshojë qëndrimin vetëm nga veprimet tona që i bëjmë ne si shtet.

Kompromisi i parë në negociatat tashmë kanë ndodhur. Qeveria i ka pranuar kopjet e regjistrave civilë, duke u pajtuar që origjinalin ta mbajë Serbia. Kjo është sikur të pajtohesh që dokumentet origjinale të shtëpisë tënde t'i ketë dikush tjetër që ka pretendime mbi shtëpinë, e vetë të gëzohesh që e ke kopjen. Por, ky veprim i Qeverisë tregon se si ajo në të vërtetë i trajton qytetarët e Kosovës, si persona joreal, si kopje, për interesat dhe nevojat e të cilëve nuk e qan as kokën. Ata i duken si qenie virtuale, pa personalitet e pa individualitet dhe kështu po trajtohen edhe të pagjeturit e rrëmbyer nga Serbia, pra vetëm si numra. Kur një pushtet politik arrin në këtë fazë, pra kur ai

zhvishet nga çfarëdo ndjeshmërie minimale për qytetarin dhe për bashkësinë, për shtetin dhe për kombin, atëherë populli ka arsye të shqetësohet, por edhe të organizohet më shumë për t'u liruar njëherë e mirë nga një pushtet i tillë.

Për fund, duhet të thuhet se Qeveria e Kosovës, me veprimet saja të papërgjegjshme, po e dëmton edhe procesin e njohjeve të shtetit të Kosovës. Ftesa që i bëhet Borko Stefanoviqit, nga Qeveria e Kosovës, çon sinjale negative te ato shtete që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, sepse inkurajohen pretendimet e këtyre shteteve se paska ende papajtueshmëri të mëdha në mes Kosovës dhe Serbisë dhe si rrjedhim se ende po u dashka të pritët. Ardhja e Stefanoviqit në Kosovë, pra e këtij njeriu që sa herë t'i jepet mundësia e nxit kundërshtimin e pavarësisë të vendit tonë, do të jetë sponzorizim i Qeverisë së Kosovës për propagandë antishqiptare brenda Kosovës dhe kundër shtetësisë së Kosovës. Qeveria e Kosovës, jo vetëm që nuk po punon për sovranitet, por me organizimin e vizitave të tilla, si kjo e Stefanoviqit, veç sa po e lufton aktivisht interesin tonë shtetëror të Republikës së Kosovës.

Në fund, edhe një gjë për kryeministrin, një deklaratë të tij, tha që: "Kosova është plotësisht e lirë". Kjo do të thotë se kryeministri ose nuk e konsideron veriun e Kosovës si pjesë të Republikës sonë, ose i konsideron strukturat paralele te Serbisë si pjesë të lirisë sonë, të lirisë së Kosovës. Cilën do që do ta ketë menduar, prej këtyre dyjave, e rrjedhime logjike tjera s'ka, kjo i bie që, së pari, ai duhet të skuqet, së dyti, që duhet të na kërkoj falje, e së treti, që duhet të japë dorëheqje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Replikë, ka kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Intervenimet e mia janë sqarime, jo replika në raport me transparencën me qytetarët e Republikës së Kosovës dhe Kuvendin e Kosovës. E para, askush nga ne nuk është pronar i patriotizmit. Unë ju kisha ftuar që sinqerisht të mendohet për vizionin për të ardhmen se askush më nuk do të ketë tema të merret në emër te Serbisë të zhvillojë politikë në Republikën e Kosovës, se dialogu me Serbinë ka përfunduar një herë e përgjithmonë dhe vendi është i pavarur, sovran për herë të parë në historinë e Kosovës, ka dialog teknik në nivel të barabartë me Serbinë, jo siç ka ndodhur më herët për dialog për çështje çfarë kanë qenë, flas para '98-ës. Ndërsa, tani ndodh ky dialog për çështje praktike ndërshtetërore në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Keni përcjell me siguri edhe debatin në Kuvendin e Serbisë për dialogun mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, ku Qeveria e Serbisë mori kritika shumë të rënda për uljen me përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Kosovës në një tavolinë, për herë të parë si shtete të pavarura, me përfaqësuesit legjitim të Republikës së Kosovës, pra nga Serbia. Në anën tjetër, e ritheksoj, i gjithë procesi është në kuadër të agjendës euroatlantike dhe do të përmbyllet me njohjet reciproke në mes Serbisë dhe Republikës së Kosovës. Por, e ritheksoj edhe një herë, mendoj që të gjithë duhet të fokusohemi në vizionin për të ardhmen zhvillimore të Republikës së Kosovës, rritjes së mirëqenies sociale të tyre, integritit kombëtar, regjional, paqes, stabilitetit, integritimeve në NATO dhe në Bashkim Evropian, por mos vizionin e askujt në politikë nuk do të mund ta mbush të përmendurit e Serbisë në Parlamentin e Kosovës. Natyrisht, është e drejtë se secilit që të mendoj në këtë drejtim shumë, por e

ritheksoj edhe njëherë, ne mbi të gjitha respektojmë vullnetin e qytetarëve të vendit, Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, se kush është sovrani të flas në emër të popullit, ka vendosur vota dhe jo aspiratat. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Një minutë e ka kërkuar Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Unë shumë shkurt, nga koha e grupit, vetëm siç thotë populli: “është bërë zor të gëzohesh që dikush avancohet politikisht”, atë që e thashë më herët, edhe ta shpreh tani atë gëzim, ashtu siç e thashë për atë thënien famoze dhe doktrinën politike të presidentit Rugova, e se kush “derdh lot krokodili”, qytetarët tanë e dinë shumë mirë këtë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Kryeministri e ka të drejtën e replikës, prapë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë, Ismet, po ta përmend emrin me qëllim, se mund edhe të reagosh, por dëshiroj të theksoj se këtu ka njerëz që kanë sakrifikuar krejt jetën për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës dhe atë kontribut mos ua mohoni, askush nuk ka të drejtë. Prandaj, pronar i patriotizmit s’ jemi askush, të gjithë kemi dhënë kontributet tona modeste, dikush më shumë, dikush më pak. Dikujt i ka mbetur, natyrisht, mund të them, shumë zhig të jetë aty ku nuk ka qenë, ku s’e ka merituar të jetë kurrë, jo pse kanë qenë kundër atyre gjërave që kanë ndodhur, por pse kanë munguar që të jenë aty. Nuk i kanë besuar kurrë lirisë së Kosovës dhe pavarësisë së Kosovës, ndërsa tek ish- presidenti Rugova, dëshiroj të theksoj diçka, se së paku, presidenti Rugova nuk ka qenë kundër dialogut, siç po prezantoheni ju sot, edhe më herët, edhe në vitin ’90, ’98 e më tutje. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Për replikë e ka kërkuar fjalën Alma Lama. Më s’ ka replika, ju lutem, se deri në mëngjes shkojmë.

ALMA LAMA: Ju faleminderit!
Unë e kërkoja replikën, sepse meqë ju po jepni replika në interpelancë, zoti kryeministër ma përmendi emrin në fillim, kështu që duhet ta shfrytëzoj këtë drejtë timen. Zoti kryeministri bëri shumë mirë që e citoj Kushtetutën e Kosovës, ku thuhet shprehimisht se Qeveria i përgjigjet Kuvendit. Dhe, pyetja ime parlamentare, duke i respektuar të gjitha procedurat, ishte në këtë kuadër dhe do të duhej që përgjigja të vinte pikërisht për këtë arsye dhe jo kryeministri të na i tregonte zyrat, që ne duhet të shkojmë atje dhe të marrim përgjigje. Pra, zoti kryeministër, ju jeni këtu për të dhënë llogari, ashtu sikurse është parashikuar në Kushtetutën e Kosovës. Madje, unë ju kërkoja një përgjigje shumë të shkurtër, bëhet fjalë vetëm për një shifër, por ju dhatë një përgjigje shumë të gjatë, madje u kujdesët që të më bëni ftesë që të marr pjesë edhe në punimet e autostradës. Mund t’ju them që do ta konsideroj këtë ftesë në rast se ju do ta bëni publike shifrën e kostos së autostradës dhe do të më bindni mua, deputetët e këtij

Kuvendi dhe qytetarët e Kosovës, që kontrata e kësaj autostrade, pra kostoja, vlera e kësaj autostrade, nuk është produkt i dallavereve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Zoti Beqiri po e kërkon fjalën dhe ky një minutë, replikë.

ISMET BEQIRI: Zoti kryeministër, vërtet nuk është mirë ta ndërroni atë për çka u paraqita para kësaj here. Vetëm i çmenduri e konteston kontributin e dëshmorëve, të familjeve të tyre, të luftëtarëve edhe të njerëzve që janë këtu, vetëm ai që është i çmendur dhe të tillë unë nuk e besoj që gjeni, që konteston diçka të tillë. Sikur që e thashë edhe më herët, asnjëherë nuk janë kundërshtuar bisedimet tona, bisedimet flas, edhe që e përmendet presidentin Rugova. Nuk po sillemi këtu si padron, as pronar të kësaj pavarësie, sikur që nuk mund të silleni as ju, sigurisht, sepse nuk jeni si i tillë dhe nuk ka individ që mund të jetë pronar i saj. Prandaj, nuk është mirë, sepse kontributin secili e ka dhënë, padyshim, gjatë këtij rrugëtimi historik për këtë shtet dhe nuk është vetëm kontributi i individëve dhe në këtë nuk ka pikë kontestuese, fare. Prandaj, kjo nuk duhet, sepse kjo keqkuptohet nga të tjerët. Është e vërtetë ai që ka pasur mundësi edhe zhit, por edhe vullnet për të punuar, ka punuar për pavarësinë e Kosovës dhe dihen këto, janë meritat. Edhe po të doni t'i fshihni ju, edhe unë po të doja t'i fsheh, ato nuk fshihen dhe këto janë gjëra botërisht të njohura, prandaj këto mos e merrni, po e merrni shumë personale dhe po reagoni.

Unë e kam pasur këtu një thënie famoze, që është doktrinë si e tillë dhe nuk dëshiroj ta zgjas rreth kësaj, ndërkaq ato të tjerat rreth kontributit, luftës angazhimit, të gjithë kemi kontribuar dhe të gjithë e dinë këtë. Ky është vend i vogël, nuk jemi në Kinë ...

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kryeministri ka replikën me Almën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAQI: Projekti i autostradës është një nga projektet më transparente të mundshme. Është vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa unë do të kërkoja që ju, thjesht do të dëshiroja që ju të kërkonit një interpelancë vetëm për autostradë. Nëse doni për autostradën që po ndërtohet nga Vermica në drejtim të Merdarit, nëse doni edhe për autostradën energjetike që ka filluar dhe e do të vazhdojë, pra integrimet kombëtare dhe regjionale euroatlantike bëhen vetëm me vepra dhe jo me fjalë. Për mua është shqetësuese reagimi kundërshtues ndaj autostradës dhe pyetjet që i kemi dëgjuar edhe më herët në kuvende të tjera, por jeni të ftuar për ta vizituar. Besoni, ajo autostradë do t'ju jap dinjitet dhe krenari kombëtare dhe vlera të qytetarisë, civilizimit dhe euroatlantike.

Zoti Beqiri, tek çështja e filozofive politike, është diçka krejt tjetër që mund të diskutojmë. Për mua, çdo qytetar i Republikës së Kosovës është luftëtar i lirisë, është çlirimtar i Kosovës, ndërsa për mua është shqetësim vetëm reagimi i juaj kundërshtues për dialog me Serbinë, gjë që nuk ka qenë në filozofinë e presidentit Rugova se, tek e fundi, unë kam kaluar më shumë kohë me Rugovën, në takime me ndërkombëtarë, se sa ju personalisht. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Gjini.

Dua t'ia tërheq vërejtjen Grupit Parlamentar të PDK-së, që sipas Rregullores, minutat e kryeministrit janë minutat e Grupit Parlamentar të PDK-së.

ARDIAN GJINI: Zoti kryesues, mendoj se është mirë të keni kujdes në udhëheqje të seancës, Rregulloren e keni përpara dhe Rregullorja e tregon qartë se si duhet, a ju pëlqen juve a jo, është diçka tjetër? Për të mos humbur kohë, dua të kthehem menjëherë në temë.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është parti politike, e cila besoj se në kohën e sotme zgjidhja e kontesteve në mes shteteve, qoftë në rajon, qoftë jashtë, më larg rajonit, mund të bëhet me negociata dhe bisedime e jo me dhunë. Do të thotë, bisedat dhe negociatat në esencë janë mjet legjitim i punës të qeverive të cilat nuk synojnë dhunë. Sidoqoftë, problemet tona nuk rrjedhin si pjesë e konceptit të bisedimeve ose negociatave. Problemet e Kosovës rrjedhin fillimisht nga paaftësia e Qeverisë së Kosovës për t' i shërbyer vendit. Do të thotë, Qeveria e Kosovës është e paaftë të qeverisë në vend, korrupsionin e kemi në rritje, lirinë e mediave e kemi në rënie, të mos i përmend të gjitha ato që ne të gjithë i dimë, do të thotë është një katastrofë qeverisje në vend. Mirëpo, në anën tjetër e kemi një problem tepër të madh me Qeverinë e Kosovës, për shkak se është tepër e paaftë për ta përfaqësuar sovranitetin e Kosovës në arenën ndërkombëtare edhe kësaj teme do t' i kthehem edhe një herë. Do të thotë, Qeveria e Kosovës nuk po arrin ta përfaqësojë sovranitetin tonë në mënyrë të dinjitetshme, nuk po arrin të na përfaqësojë neve në mënyrë të dinjitetshme në arenën ndërkombëtare.

Çështje tjetër është se sot filluan të përmenden, prej shtatorit e kanë mbyllur gojën të gjithë kur ne kemi folur, ndërsa sot filluan të përmenden parabisedimet dhe paranegociatat, për të cilat shumë njerëz e kanë futur kokën në rrërë kur Aleanca ka folur për to.

Qeveria e Kosovës duhet ta përfaqësojë shtetin në mënyrë të dinjitetshme. Do t' iu kthehem disa paradokseve që po ndodhin, në fjalë që dëgjojmë nga Qeveria e Kosovës. Kemi dëgjuar se bisedimet nuk patën ndonjë sukses ose ndonjë përfundim. Bisedimet nuk kanë nevojë të kenë përfundim, bisedimet janë bisedime dhe bisedohet. Përfundim ose jo, kanë negociatat. Do të thotë, bisedimet janë një mjet pune për të arritur deri te një rezultat kur negociohet, kur kërkohet diçka prej Serbisë, e ne ende nuk po dimë se çka po kërkon Serbia prej nesh në këto të ashtuquajtura bisedime.

Në të njëjtën kokë, paradoksi tjetër është se Serbia, me të cilën ne bisedojmë, ka lëshuar fletë arrest për kryeministrin. Ajo Serbi na ka bërë bllokadë ekonomike, ajo Serbi nuk po na lejon të udhëtojmë me tabela të Kosovës atje. Kudo që po shkon në botë, po thotë që na jemi kriminel, që trafikojmë organe, që ne kemi krimin e organizuar më të madhin në botë e tjera e tjera, thotë Serbia, kjo e vetmja. Ndërsa, zonja Edita Tahiri, me syza të diellit piktoreske, kur kthehet prej Brukseli, thotë: "Kemi pasur një bisedim shumë substancial " edhe thotë: "fryma konstruktive po mbizotëron në bisedime". Ky është

paradoks, ky është paradoks dhe duhet ta vesim - a keni thënë, hiqni ato fletë-arreste për zyrtarët, për parlamentarët, a i ka thënë dikush dikujt, apo duhet të shkohet edhe të kemi bisedime konstruktive e në frymë miqësore kur ata kanë lëshuar fletë-arreste prej kryeministrit e teposhtë. Gjysmën e Kuvendit e kanë në fletë-arrest, ndoshta edhe mua, ku ta di.

Çështja të cilës desha t'i kthehem, është përfaqësimi dinjitoz i sovranitetit të popullit. Populli është sovran, jo kryeministri, kryeministri e përfaqëson atë sovranitet.

Po dua t'ua përkujtoj çka ka ndodhur dje, në fakt pardje, dy ditë radhazi. Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, me qëllim po i them i parë, zoti Kuçi, zoti Kuçi është kryesori, zoti Pacolli është zëvendëskryeministri i parë, mirëpo zoti Thaçi i ka thënë zotit Kuçi, ky po lyp, ti je hala i pari, por ky po e lyp e po e bëjmë. Ai zëvendëskryeministër ka dal në konferencë për shtyp edhe ka thënë, kështu: "Unë jam i gatshëm me u takue me këtë kryenegociatorin serb, qe vjen në Kosovë". Kur dikush, kur zyrtari i dytë më i larti në Qeveri, thotë jam i gatshëm, në vendin tim, si përfaqësues i sovranitetit, jam i gatshëm të takohem me përfaqësuesin e Serbisë, i mungon fjalia e vetëkuptueshme, që do të thotë, nëse ai lyp për t'u takuar me mua. Kjo është e vetëkuptueshme, nuk mundet të thotë dikush, unë jam i gatshëm të takohem me dikë, e mos të mendohet në ndërdyje, nëse ai lyp të takohet me mua.

Kjo është fyerje, këta njerëz janë duke e fyer sovranitetin e popullit të Kosovës dhe nuk do kurr gjë tjetër mend këtu, as negociata, as përfaqësim, as syza të diellit për ta parë që ne si popull i Kosovës, që Kuvendi i Kosovës, që lufta e Kosovës, liria e Kosovës po fyhet, po fyhet për shkak se njeriu i dytë në Qeverinë e Kosovës, thotë: "Nëse ai lyp me u takue me mu, unë jam i gatshëm me u takue me të në vendin tim". Çështja e dytë e fyerjes është që, ne si shtet sovran kemi nivele. Përderisa ata e çojnë një drejtor në bisedime, ne e çojmë një zëvendëskryeministre. Tani dikush në Qeverinë e Kosovës mund të mendojë që zëvendëskryeministrja nuk është aq e rëndësishme, por në përfaqësim të sovranitetit të popullit është zëvendëskryeministre edhe në të njëjtën kohë zëvendëskryeministri më kryesori në Republikën e Kosovës pranon për ta pritur një drejtor i një ministrie të Serbisë edhe thotë që jam i gatshëm të takohem me të në vendin tim, në vendin ku duhet përfaqësuar sovranitetin tonë. Këta nuk po përfaqësojnë sovranitetin tonë dhe përderisa nuk e përfaqësojnë sovranitetin tonë, nuk kanë qysh të kenë sukses në përfaqësimin tonë në negociata.

Fundi i fundit, po ju them të drejtën, unë nuk mërzhitem fortë a shkron zoti Kuçi a jo, unë mërzhitem çka po i ndodh vendit dhe Aleanca nuk mërzhitet çka po thotë zoti Kuçi, Aleanca mërzhitet se çfarë fytyre po i del Kosovës në botë me këto sjellje.

Çështje tjetër, përpos domethënë fyerjes që i bëhet sovranit, popullit të Kosovës nga përfaqësuesit e atij sovraniteti, është gjendja e Kosovës në këto negociata. Nuk e kemi në plan t'ju përmendim raportet, mirëpo po ju tregojmë se të paktën, të paktën, të paktën ka qenë dashur të keni synim për ta ndërtuar një minimum të konsensusit të brendshëm për një platformë për vijat e kuqe, që këtu vetëm po thuhet që janë vija të kuqe, por ne nuk i dimë cilat janë ato vija të kuqe.

Çështje e tretë është koncepti. Koncepti i bisedimeve i cili është diçka që çdo shtet në negociata duhet ta ketë të qartë para se të shkojë. Çka dëshiron Kosova në ato negociata, çka dëshiron të arrijë. Nëse Kosova nuk e ka të qartë çka dëshiron të arrijë në ato negociata, nuk duhet të shkojë në negociata për shkak se nuk i shërbejnë Kosovës. Edhe ne e kemi në interes paqen ndërkombëtare, është e vërtetë, por ajo paqe ndërkombëtare është interes i joni nëse na shërben neve, e jo nëse ju shërben të gjithë të tjerëve, përpos neve.

Kosova thotë që e do njohjen reciproke, njohje për të cilën Serbia thotë - ne nuk jemi të gatshëm kurrë t'ju njohim. Domethënë, Kosova po shkon në negociata me Serbinë për të na njohur ata, ata paraprakisht po na tregojnë se nuk e kanë në plan të na njohin, përderisa Serbia për vete e ka tepër të qartë se çka do. Serbia do statusin kandidat në Unionin Evropian, edhe po ia arrin, edhe do minimumin t' i shkaktojë Kosovës goxha kokëdhembje në veri të Kosovës, në mos të bëjë ndarje të brendshme, fundi i fundit ndoshta e edhe ndarje të jashtme. Thotë, Kosova nuk e di për çka po shkon, Serbia e di për çka po shkon në negociata.

Në fund të fundit, mendoj se Kosova në këto negociata nuk po fiton jo për shkak se negociatat dhe bisedimet janë të këqija, po e përsëris fjalën e parë, por për shkak se Qeveria jonë nuk është përgatitur, edhe pse e ka ditur që tri vjet se do të vijë në këtë ditë. Edhe pse e ka ditur një kokë të gjatë, se gjashtë pikëshi vjen, edhe pse e di që e ka aktual gjashtë pikëshin, Qeveria e Kosovës sillet me komoditet të jashtëzakonshëm dhe mendon se vetëm pse ekziston si e tillë, punët kanë për t'u kryer. Qeveria jonë, përkundër Serbisë, nuk di as çka të kërkojë prej Unionit Evropian, nuk di as çka të kërkojë prej Serbisë drejtpërdrejt edhe vjen dhe na thotë: ne po i marrim disa artefakte që, fundi i fundit, nuk po dua t' i nënçmoj si të tilla, mirëpo paramendoni cila është pesha e asaj që fitohet kur ne i marrim disa artefakte, ndërsa Serbia merr statusin e kandidatit dhe, po ju them, aq i mjafton Serbisë.

Një çështje tjetër e fundit që duhet të thuhet, është një shprehje që thotë: “mashtrimi më i madh ndodhë kur të tregohet e vërteta shpejt e shpejt.” Është e vërtetë ndoshta që Unioni Evropian, që na do shumë, nuk e ka në plan t'ia japë Serbisë, ta pranojë në Unionin Evropian, përderisa nuk zgjidhet çështja me Kosovën. Mirëpo, Serbia po lyp statusin e kandidatit, jo anëtarësim në Unionin Evropian tani, statusin e kandidatit në mënyrë që të ketë qasje në sfone strukturale, në mënyrë që të zhvillohet vetë edhe në mënyrë që ta lë Kosovën vendin absolutisht të fundit, pa asnjë perspektivë as ekonomike, as ndërkombëtare.

Qeveria e Kosovës duhet ta dijë që Serbia po di çka të lypë prej Unionit Evropian edhe çka të lypë prej Kosovës. Qeveria e Kosovës duhet të ketë kujdes të fillojë të paktën, të fillojë tani, të mos na fyej deri në skaj, të tregojë çka po lyp, çka po do prej negociatave me Serbinë dhe çka po do prej Unionit Evropian, i cili po insiston që ne të marrim pjesë në këto negociata. Fundi i fundit, duhet të rekapitulojmë, të themi që Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës mendon se i vetmi mjet pune në marrëdhëniet ndërkombëtare janë negociatat dhe bisedimet, por jo me një Qeveri e cila ka dështuar të

përgatitet, jo një Qeveri e cila ka dështuar të jetë transparente me popullin e vet, jo një Qeveri e cila ka dështuar të ketë konsensus në Kosovë. Mos harroni se popullata shumicë e Kosovës janë shqiptarë dhe nëse abstrahohet ky fakt në Kosovë, asnjë negociatë, asnjë formë e bisedimeve nuk kanë për të sjellë kurrfarë suksesi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! 10 Minuta grupi i juaj i ka shpenzuar. Tani është radha e Grupit Parlamentar SLS, deputeti Petar Miletiq. Miletiću, izvinite, imamo jednu drugu parlamentarnu grupu pre vas!

Grupi Parlamentar “Kosova e Re” deputeti Amir Ahmeti. Më fal, të lutem!

AMIR AHMETI: I nderuari kryesues,

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, t’i shprehim qëndrimet tona rreth bisedimeve në mes Kosovës dhe Serbisë, të cilat i konsiderojmë bisedime midis dy shteteve të pavarura dhe sovrane dhe vetëm ashtu edhe duhet të jetë.

Vetëm para një muaji më parë kemi biseduar gjatë për këtë temë, dhe për këto bisedime kemi dhënë opinione duke qartësuar pozicionet tona në lidhje me këto bisedime. Po ashtu, kemi bërë me dije se specifika e këtyre bisedimeve qëndron në faktin se po ndodhin pas një lufte, pas një shtypje dhe dhune që iu bë popullit të Kosovës. Por, këto bisedime duhet të kenë për qëllim dhe duke filluar nga ky realitet, mos ta harrojmë të kaluarën dhe të kthehemi kah e ardhmja, të vazhdojmë rrugën për përpjekjet tona për integrimin e vendit tonë, duke treguar bashkësisë ndërkombëtare se Kosova është një partner konstruktiv në rrugën e shtet ndërtimit.

Qëllimi i mirë i Kosovës për bisedime, për çështje jetike të qytetarëve nuk mund të keqpërdoret nga pala serbe dhe nuk duhet të lejojmë të ndodhë ajo. Duhet qartë të vihet në dijeni sa herë që palët të ulën në tavolinën e bisedimeve se Kosova është viktimë e një lufte agresive ndaj saj dhe se bisedon me palën serbe si trashëguese e një agresori që ka lindur dhe ka vepruar në emër të shtetit serb dhe se pala serbe duhet qartas të distancohet nga ajo politikë, pasojat e së cilës i ka bartë populli i Kosovës.

Respektimi i reciprocitetit në të gjitha fushat, ka qenë një prej kërkesave tona për bisedime dhe ajo duhet të jetë e tillë në vazhdimësi. Nëse dëshirojmë që bisedimet të mos i sjellim favore vetëm Serbisë, por edhe Kosovës e po ashtu edhe bashkëkombësve tanë në Luginën e Preshevës. Mendimi se mos bisedimet me Serbinë e bllokoi atë në integrimin e saj drejtë BE-së, është i gabuar sepse BE-e do t’i sigurojë asaj një rrugë tjetër, ndërsa interesat e Kosovës si të pagjeturit, të zhdukurit, kompensimi i dëmeve të luftës do të mbesin pa u zgjidhur sikur tash e 11 vjet. E po ashtu shqiptarët e Luginës së Preshevës do të mbesin të viktimizuar dhe politikat tona jo aktive në raport me ta, do të nënkuptojë pasivitet ndaj tyre.

Për çështje që historikisht kanë marrë përgjigje definitive, siç janë sovraniteti dhe integriteti i vendit, rregullimi dhe organizimi i brendshëm politik dhe shoqëror i vendit tonë, nuk duhet humbur kohë për të biseduar për to, ngase janë çështje ekskluzive të brendshme që na përkasin neve, dhe mu për këtë, nuk mund të jenë çështje negociimi me palën tjetër. E këtë e sqaroj edhe kryeministri.

Ne, si deputetë të Kuvendit të Kosovës, si përfaqësues të interesave të qytetarëve të Kosovës, do të japim kontributin tonë duke mbikëqyrur punën e Qeverisë dhe të delegacionit tonë, duke dhënë vërejtje dhe sugjerime dhe me këtë rast, tërheqim vërejtjen për pikat kryesore të bisedimeve dhe në ndërkohë ky delegacioni ynë duhet të ketë parasysh dhe t'i jap kahe bisedimeve sipas prioriteteve tona, siç i kemi propozuar edhe në debatin e kaluar të zhdukurit dhe të pagjeturit, kompensimi i dëmeve të luftës në bazë të reciprocitetit të drejtat që i gëzojnë serbët e Kosovës, duhet t'i gëzojnë edhe shqiptarët e Luginës së Preshevës. Kthimi i tërë arkivit të vjedhur, librave kadastral, si dhe pasurive tjera arkeologjike, por të jemi të qartë, jo kopjeve siç është përfolur por origjinalin, sepse ato janë të vjedhura.

Lëvizja e lirë dhe njohja reciproke e dokumenteve personale dhe të udhëtimit, tregtia e lirë dhe qarkullimi i lirë i mallrave –automjeteve dhe respektimi i reciprocitetit të plotë, si në mallra ashtu edhe në automjete, duke njohur dhe targat në mënyrë të ndërsjellë, targat e Republikës së Kosovës, në Serbi dhe të atyre të Serbisë në Kosovë, por jo targave të Serbisë për qytetet e Kosovës. Edhe për këtë ka dal me një qëndrim ministri i brendshëm të cilin e mbështesim dhe ashtu duhet të mbetet edhe si qëndrim i delegacionit tonë në bisedime, e me Serbinë rreth këtyre çështjeve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, Miletiq e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar SLS.

PETAR MILETIĆ: Poštovani predsjedavajući,

Predsjedniče Vlade,

Članovi Vlade,

Koleginice i kolege poslanici,

Kao politička partija i kao Poslanički klub, podržali smo proces dijaloga Beograda i Prištine i glasali smo za Rezoluciju kojom su dati okviri delegacije Prištine za ovaj proces.

Podršku smo dali ovom procesu, isključivo očekujući rezultate dijaloga i zbog olakšavanja života građana bez obzira na etničku pripadnost. Iako oba glavna pregovarača kažu da ima napretka u dijalogu, konkretnih rešenja još uvek nema, ali smo mi strpljivi i svesni osjetljivosti svih pitanja i spremni smo da čekamo na rešenja.

Možda ni mi kao Poslanička grupa i kao politička partija nismo najzadovoljniji transparentnošću dijaloga, ali ako će to doprineti bržem rešavanju problema, nemamo ništa protiv, ali su nam konkretni rezultati neophodni što pre kako bi ovaj nedostatak transparentnosti bio opravdan. U ovoj inicijativi koju je podnela Poslanička grupa

„Vetevendosje“ termin kompromis ima negativan kontekst i to ne samo u dokumentu koji smo dobili, već i u javnoj komunikaciji. Ne slažem se s tim da su kompromisi negativni, niti štetni i opasni kako stoji u ovom obrazloženju. Ukoliko želimo uspešno rešenje problema, kompromisi su neophodni i to sa obe strane i ohrabrujemo pregovarače da postignu što je više moguće kompromisa, kako bi građani što pre mogli slobodno da se kreću, koriste lična dokumenta, imaju struju, koriste katastarske knjige u mestima u kojima žive.

Čini mi se da insistiranje na formulacijama samo opterećuje pregovore ili pregovarače, pardon, i proces i da to nije od suštinske važnosti. Termin tehnički dijalog jeste zvaničan, ali svako pitanje ima političku konotaciju. Da nije tako, ovog dijaloga ne bi ni bilo, niti bi ovaj proces vodile političke ličnosti, ali teme jesu tehničke i treba se usredsrediti na njih. Istine radi, u tački 6. ovog obrazloženja, gospođa Edita Tahiri je optužena da nije dostavila spisak učesnika u delegaciji Prištine, što nije tačno, jer obzirom da sam član Komisije za spoljne poslove, dobio sam ovaj spisak u e-majlu, i u tom istom e-majlu koji sam dobio, video sam da je spisak dostavljen svim članovima ove komisije.

Sa žaljenjem mogu da konstatujem da na tom spisku nema nijednog pripadnika srpske zajednice, što mislim da je šteta, jer smatram da bi mogli da doprinesemo kvalitetu dijaloga. Mislim da je potpuno pogrešno shvatanje da se dijalog vodi o teritoriji, već napokon dijalog se vodi o praktičnim problemima ljudi i te teme treba osloboditi teških reči i teških formulacija što je više moguće.

Siguran sam da ovaj dijalog ima šanse za uspeh, bez obzira na sve izazove sa kojima se timovi Prištine i Beograda susreću i mi i dalje podržavamo ovaj proces.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupet parlamentare e kanë kryer të gjitha fjalën. Nga Grupi Parlamentar “6+” nuk e ka kërkuar askush fjalën.

Tani, sipas radhës, fjalën e ka deputeti, përkatësisht nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti drejtues i seancës, zoti Haliti!

Përshëndes anëtarët e Qeverisë, udhëheqësen e dialogut!

Deputetë të nderuar,

Tema që po bisedojmë sot për herë të dytë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, është tepër e rëndësishme, është e një peshe të jashtëzakonshme dhe për këtë shkak unë e përgëzoj “Vetëvendosjen” që e ka thirrur kryeministrin në interpelancë.

U tha edhe këtu që për temat e tilla, u përmend faktikisht, por unë po e nënvizoj në mënyrë të veçantë, kaq fundamentale për çështjet nacionale të vendit, e mira e së mirës është gjithmonë të përpiqemi të krijojmë konsensus sa më të madh. Për fat jo të mirë, ndoshta për shkak të ngutisë se si u hy në këtë dialog me Serbinë, në nivel të institucioneve të Kosovës, unë po flas kryesisht për Kuvendin, nuk kemi arritur që të krijojmë një konsensus të madh. Madje, kjo nuk u arrit dhe në Rezolutën që e nxori për

këtë qëllim ky Kuvend dhe ju e dini që atë rezolutë opozita shumë e fuqishme parlamentare këtu në numër, edhe më e fuqishme në përfaqësimin e elektoratit, nuk e ka votuar, pak edhe për shkak se në atë nguti kishin filluar faktikisht bisedimet kur ne bisedonim për rezolutën dhe, e dyta, për shkak të një ngurtësie të paarsyeshme të pozitës që të votohet një tekst që mund të bëhej më koncesual dhe më i mirë. Po insistoј në këtë për shkak se dokumentet kur citohen, mbasandaj bëhen dokumente, por sot dëgjova edhe shtesë edhe nga ana e kryeministrit. Duke cituar Kushtetutën, ai e pranoi që për vendime të mëdha, ratifikimi ndodh në këtë Kuvend dhe bëhet me 2/3 e votave. Varianti i LDK-së ka qenë pikërisht ky i propozuar në Rezolutë, i cili nuk është marrë parasysh, që ka qenë gabim, për hesap timin, por sido që të jetë, Kushtetuta është më e madhe edhe se një rezolutë dhe ne, meqë po betohemi kushtimisht në Kushtetutë, ne do ta bëjmë atë.

Problemi i këtij konsensusi është problem fundamental, po them unë, sepse në demokraci vendos shumica. Te ne, jo njëherë ka ndodhur dhe në këtë legjislaturë, po do të ndodhin gjëra të tjera, që kjo shumicë nuk është duke u marrë parasysh. Po merremi me pakicat, jo në kuptimin etnik, se këtu shpeshherë kur thuhet pakicë, konfondohet me etnicitete, pakicë përfaqësuese. Në Kuvend, te ne, ka pakicë përfaqësuese si Qeveri, nëse llogaritet vota qytetare, ka pakicë përfaqësuese dhe dominuese edhe në Qeveri të tillë për shkak të sistemit zgjedhor. Ju do të thoni, ç'po nxjerr ky tash këtu? Po, sepse kur po bëhen vendimet, ajo mënyrë e përfaqësimit të pakicës po krijon shumicën vendosësh, që prish balanca dhe për tema të mëdha është e rrezikshme.

Unë tash po kthehem edhe një herë këtu ku jemi. U tha që po bisedojmë për një temë që i ka provat e veta të punës, po i quaj prova, se ndryshe asnjëri këtu nuk mund t'i quaj sepse kurrkush nuk di çfarë rezultati ka të atij dialogu, pos përpjekjeve që janë përafërsisht dymujore. Gjatë kësaj kohe, unë jam përpjekur si deputet dhe si përfaqësues të marr vesh çka ka prej gjithë kësaj dhe unë të gjitha këto i shtroj më së pari në dy pyetje: E folura politike ndërkombëtare, dialog në mes Prishtinës dhe Beogradit, e cila si formulim është kontestuar, herë është thënë Kosova dhe Serbia, mbasandaj jo Beogradi dhe Prishtina e tjera. Ky formulimi Beogradi e Prishtina, mua me njoftimet dhe dituritë dhe analizat e mia që i kam tash, më duket që pak eksplikohet dhe unë tash e bëj një pyetje, le të përgjigjet ose kryeministri, që është në interpelancë, ose zonja zëvendëskryeministre, që e drejton këtë dialog në emër të Kosovës, po them, jo të Prishtinës, a ka oferta institucionale që ky dialog të zhvendoset nga Brukseli, si kërkesë në këtë rast e Serbisë, që të zhvendoset alternativisht në Prishtinë dhe në Beograd dhe e ka të bëjë me këtë ide të Serbisë, bisedime ose të folurit e djeshëm, që kryenegociatori serb ka kërkuar ose se ka qejf që të vijë në Kosovë ta takojë dike?

Pyetja e dytë është: Në bisedimet, unë tash po i quaj vetë, Kosovë – Serbi ose në dialogun, është elementi i tretë i fuqishëm, BE-ja, a është BE-ja garant i ndonjë rezultati, në këtë rast, të këtyre bisedimeve, kjo është pyetja ime e dytë, apo është pala e tretë e fuqishme në këto bisedime? Kjo është tepër e rëndësishme që të dihet para se të shkojmë tutje. Këto të dyja pyetjet janë, pra, ose për kryeministrin, ose për zëvendëskryeministrin, që është drejtuese e ekipit të dialogut të Kosovës.

Dhe, pyetja e tretë, që është prapë pak si kërkesë, meqë Rezoluta thashë çfarë e kemi, të Kuvendit për këtë dialog, nuk është konsesuale në formën që është dhe ju mund ta merrni, t'i merrni votimet në Parlament. Nëse Parlamenti përfaqëson konsensualitet ose jo, merrni votimet. Dhe, meqë edhe sot e kësaj dite nuk kemi platformën për këtë dialog të Qeverisë së Kosovës, të cilën e implementon në bisedimet direkte zonja Tahiri, kur do të vijë kjo platformë, nëse kjo nuk mund të jetë platformë në fazat e zhvillimit të dialogut për çështje të ndjeshme, të jetë kaq popullore, po e quaj unë, që i thonë me këtë të renë, jo transparente. Mirë, po pranoj që ka edhe pika që në kohën e zhvillimit nuk bëhen në agora, në shesh siç thoshin grekët e vjetër, atëherë ka metoda pune që në mbledhje që nuk janë për publik, ky institucion i ndal përfaqësuesit ta kenë pikë e për pikë në dorë at platformë dhe ai është një detyrim i Qeverisë për këtë Parlament. Pra, kjo është edhe si pyetje, a është dhe, si kërkesë, kur do të vijë?

Dhe, në fund t'i kthehem, të bëhem krejt konkret si gjithmonë edhe në thelb, në fund përfaqësuesi i ka tri kërkesa. Unë, mendoj që dy kërkesa, dyshi dhe treshi, mund të votohen pa asnjë hezitim, domethënë përfaqësuesi i interpelancës. Për pikën e parë, duhet të shihet çka po prodhon krejt kjo bisedë sot. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Kryeministri e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë do të përgjigjem në pyetjet që u parashtruan këtu. Përpara përsëri e ritheksoj shumë fuqishëm zbatimin e plotë të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe autoritetin që e ka Qeveria e Republikës së Kosovës për planifikimin dhe zbatimin e politikës së brendshme dhe të jashtme. Se a mund të zhvendoset dialogu në mes të shtetit të Kosovës dhe Serbisë në Prishtinë dhe Beograd, është një çështje që nuk vendos vetëm Prishtina apo Beogradi, por është një obligim ndërkombëtar, e theksova. Ndërsa, garant për këtë dialog janë Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Unë e theksova edhe më herët në pamundësi apo në pamjaftueshmërinë e kohës për Qeverinë e Kosovës dhe mua për të prezantuar atë që do të thosha plotësisht, unë sot jam i cenuar në kuptimin e mungesës së kohës për t'i prezantuar pikat, platformën dhe prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në dialogun ndërshtetëror, pra në mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Sipas radhës, deputeti Blerim Shala e ka fjalën!

BLERIM SHALA: I nderuar kryesues,
Kabinet i Qeverisë,
Të nderuar deputetë,
Një deputet i Kuvendit të Kosovës nuk di asgjë me shumë se sa një qytetar i rëndomtë i Kosovës për bisedimet që në Bruksel po zhvillohen tash e dy muaj në mes të delegacionit të Kosovës dhe të Serbisë. E krejt çfarë deputetët e qytetarët kanë marrë vesh për këto bisedime, ka dal prej mediave vendore dhe ndërkombëtare. Megjithëse mund të supozohet që ky është një dialog i ndjeshëm, Qeveria e Kosovës është e obliguar që të

jetë e hapur ndaj Kuvendit të Kosovës dhe qytetarëve të vendit për rrjedhën e këtyre bisedimeve, për pozicionet që Prishtina i ka në trajtimin e temave të veçanta për ofertat që dalin në shesh gjatë këtyre takimeve, më në fund edhe për gjasa që të ketë marrëveshje për çështjet e adresuara në Bruksel.

Qasja e derisotshme e Qeverisë së Kosovës ndaj këtij procesi, kur bëhet fjala për informimin e obliguar të Kuvendit të qytetarëve të Kosovës, shquhet me shumë të meta, para së gjithash me mungesën e vullnetit për të dërguar hapur se çfarë po ndodhë në këto bisedime? Qasja e këtillë nuk ka si të mos ketë si pasojë shtimin e shqetësimit tek të gjithë ne për natyrën e këtij dialogu, për rrjedhën e tij, për epilogun e tij dhe konsekuencat politike për vendin.

Në pamundësi për të marrë vesh se çka po ndodhë në takimet e delegacionit të Kosovës dhe atij të Serbisë dhe në mungesë të një qartësie të autoriteteve më të larta të Kosovës në përballje me këtë sprovë të madhe për Kosovën, është e pamundur të kapet filli i pozicionit të Prishtinës zyrtare në këtë proces gjithsesi problematik.

Në Kuvend të Kosovës kur është debatuar për këtë temë, kemi dëgjuar njëkohësisht prej Qeverisë së Kosovës, që përballja Kosovë – Serbi, ka ekskluzivisht karakter teknik, por edhe që me këto bisedime përfundon konflikti i gjatë Kosovë – Serbi dhe që prej fatit ty tyre varet perspektiva evropiane e Kosovës. Këto dy qasje janë përjashtuese, synimet për t'i dhënë fund konfliktit të gjatë një shekull apo për të përshpejtuar procesin e integrimit të Kosovës në Bashkimin Evropian, janë politike dhe jo teknike. Kjo do të thotë që kemi të bëjmë dialog fund e krye politik.

Po shihet që derisa ne si deputetë dhe qytetarë të Kosovës nuk dimë çka po ndodh në bisedimet e Brukselit, Qeveria e Kosovës nuk po e di çka po do me këto bisedime. Duket që improvizimi, ngathtësia, mbyllja para nesh, mungesa e strategjisë politike dhe platformës së detajizuar për bisedime, janë karakteristikat kryesore të punës që Qeveria e Kosovës po e bën në këtë proces. Mbrapsht ia nisi e tëra, mbrapsht e keq po vazhdon.

Megjithatë, me pak vullnet politik ende mund të kthehet mbarë ky proces i cili, pos tjerash, pos afrimit të Kosovës kah BE-ja, duhet ta afrojë dhe ta kthejë veriun e vendit në qeverisjen e Prishtinës dhe t'i ofrojë faktorët kryesor politik në Kosovë për të mirën e vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti, të shoh si me radhë, Florin Krasniqi. Edhe 12 minuta i ka “Vetëvendosja”, po ju paralajmëroj. I ka 24 PDK-ja, 23 minuta i ka LDK-ja, 8 minuta i pat, pa Blerimin, AAK-ja, “Vetëvendosja” i ka 12, Kosova e Re i ka + 7 minuta, SLS-ja i ka + 11 minuta. Ju faleminderit! Mund ta vazhdoni.

FLORIN KRASNIQI: U tha këtu se është një obligim ndërkombëtar për këto negociata. Është një kërkesë shumë e madhe e miqve tanë ndërkombëtar qysh prej përfundimit të luftës që na të sillemi si fitimtarë. Në qoftë se ne e kemi fituar luftën, e unë mendoj se e kemi fituar luftën, atëherë ne duhet të sillemi si fitimtarë, jo si humbës. Gjithçka që ka

ndodhur në këto 12 vjet në Kosovë, prej gjithë qeveritarëve është këqyr prej prizmës së humbësit. Ne nuk jemi humbës, ne jemi fitimtarë, kuptohet ndihma ndërkombëtare, punë e madhe, por ne e kemi fituar luftën, ne duhet t'ia diktojmë kushtet Serbisë për negociatë, se jemi fitimtarë. Në asnjë fjalim të kryeministrit unë nuk e kam dëgjuar fjalën kërkim-falje. Asnjëherë ai nuk thotë se serbët duhet kërkuar falje për atë çka kanë bërë në Kosovë. A mendoni se nuk duhet të kërkojnë falje, a mendoni se ky pajtim historik bëhet pa kërkim falje, vetëm për faktin se serbët e përfunduan gjenocidin në Kosovë në fund të shekullit të kaluar. Ata gjenocidin e kanë filluar shumë më herët në zonën e Nishit, e ata asnjëherë nuk kanë shprehur keqardhje për këtë gjenocid ndaj shqiptarëve, por ne gjithmonë jemi përkulur para tyre. Prapë edhe si fitimtarë po përkulemi para tyre. Pse e gjithë kjo përkulje? Apo mos po duam për të fituar politikisht secili për veti e të bëhemi të afërt me ata gjysmë miqtë ndërkombëtarë që na kanë mbetur. Miqtë tanë ndërkombëtar kërkojnë që ne të veprojmë si fitimtarë, se jemi fitimtarë.

Ne nuk e kemi primatin, ne nuk jemi të fortë ta caktojmë të ardhmen e pajtimit historik midis Kosovës – shqiptarëve dhe serbëve. Ne këtu prezantojmë më pak se 20% të popullit shqiptar, më pak. Kur i heqësh edhe votat e vjedhura, manipulimet e të gjitha, ne prezantojmë 10%. A i ka pyetur dikush, a donë të pajtohen me Serbinë? A i ka pyetur dikush? Kush jemi ne, kush është ky e kjo të bëjë pajtimin historik? Nuk mund të bëhet.

Edhe, në fund, sa i përket kërcënimit të Shaip Mujës. Shaip, mos kërcëno, mos kërcëno, s'ka forma tjera! E, porosia ime për Hashimin, ëshë: "Hashim, lidhi qentë, se ka lindur dielli". Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit! Po ma humbni kohën, i nderuar kryesues!

KRYESUESI: Një minutë e ke, jo më shumë. I shpenzoni minutat, për mua jepjani 10.

Replikë, Shaip Muja, 1 minutë!

SHAIP MUJA: Unë nuk kam baraspeshë intelektuale për ata që nuk më kuptojmë. Unë nuk iu kërcënova askujt, por thashë - kur përfundojnë mjetet e bisedës, bisedë me mjetet demokratike, fillojnë mjetet tjera, për tjetërkënd, jo për ty, se me ty nuk merrem.

Tjetra, që desha të bisedoj për çështjen e konsensusit. Gjatë mbledhjes së Grupit Parlamentar, të Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë, zonja Edita Tahiri, thotë: "Në pyetje të cilat parashtrohen nga kryesuesi, ne jemi në kërkim të shtrirjes së strukturës me ekspertë dhe nga shoqëria civile, ekspertë ndërkombëtarë dhe po ashtu ne po punojmë për të ndërtuar dhe një lloj legjitimiteti thuaj politik, edhe pse nuk ka delegacione politike, por brenda nesh të krijojmë legjitimitet dhe konsensus të madh. Në kuadër të gjetjes së një konsensusi, unë i jam drejtuar me letër zotit Albin Kurti ...

KRYESUESI: Ia shtoni minutazhin!

SHAIP MUJA: ... për të shprehur pra konceptin tim se si e shoh legjitimitetin. Me fjalë të tjera, kam dëshirë që gjithë spektri politik të jetë involvuar dhe deri më tani askush nuk iu ka përgjigjur kësaj ftese, prandaj në konsensus, nëse ju ka mbetur hatri që nuk jeni mazhoranca për ta menaxhuar Qeverinë, ju keni të drejtë të merrni pjesë aktive në kontribut për çështje të mëdha dhe jo të refuzoheni vetvetiu. Prandaj, në ato letra edhe qoftë gabimisht, negativisht të përgjigjeni, mund të thoni, kjo nuk na pëlqen, por jo para kamerave këtu të krijojmë manekenizëm politik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj!

DAUT HARADINAJ: Ju faleminderit, kryesues!

Po shihet që, Florini tha: “Lidhi qentë”, por po më duket që duhet me i lidhë arushat”, se duhet ta dij përgjegjësinë e vet gjithkush, por megjithatë ne po ndalemi te negociatat, meqenëse po flasim për atë punë dhe është fakt që këto po ndodhin dhe jo tash, por tash e një kohë dhe këto negociata detyrimisht që i shkojnë vetëm Serbisë në favor. Unë nuk do të harxhoj kohën e grupit parlamentar, por shihet qartë që shumica shqiptarë në Parlamentin e Kosovës, është kundër negociatave dhe shumica e shqiptarëve në Kosovë, jam i bindur edhe qytetarët e Kosovës, janë kundër këtyre negociatave për shkak se këto nuk prodhojnë asnjë send për shqiptarët e Kosovës, për Kosovën, duke pasur parasysh se Serbia do të marrë shumë privilegje, ka shumë përgjegjësi para vetit, para Kosovës dhe ne duam të shkojmë në negociata vetëm e vetëm për ta shpëtuar kështjellën qeveritare, ku aty janë fshehur shumë prej njerëzve të cilët kanë përgjegjësi historike para Kosovës.

Unë nuk po e zgjas më shumë, po u pa edhe këtu që shqiptarët në Parlament të Kosovës, shumica janë kundër negociatave. Kaq pata.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,

Ne këtu patëm shansin edhe në seancën e kaluar, edhe në këtë seancë që të dëgjojmë deklarime dhe diskutime të rëndësishme, të cilat i referohen etapave historike të Kosovës, duke filluar nga lufta, duke privatizuar procesin e luftës dhe duke marrë përgjegjësi se, disa nga njerëzit këtu janë edhe çlirimtarë dhe kanë marrë përgjegjësinë edhe për ta bërë luftën. Mirëpo, lufta ka qenë një moment historik mbi bazën e të cilit është mbyllur me një humbje historike për Serbinë, mirëpo Serbia nuk është dorëzuar. Çka ndodhë? Ndodh një proces gjyqësor në Tribunalin Ndërkombëtar të Drejtësisë, ku vendoset që Kosova ka pasur të drejtë ta shpallë pavarësinë. Mirëpo, Serbia prapë nuk dorëzohet dhe Serbia inicion një rezolutë për negociata me Kosovën dhe pas ndërhyrjes të Bashkimit Evropian, kjo rezolutë ridraftohet dhe zbutet pak gjuha e saj dhe thuhet që do të ketë një rund të ri bisedimesh apo diskutimesh në mes Kosovës dhe Serbisë, dhe tash kthehemi se çka ndodhë në shtëpinë tonë? Në shtëpinë tonë, në Kosovën tonë, ndodhin disa fenomene, fenomeni i parë ndodh që Qeveria e Kosovës

nuk ka një koncept të qasjes çka do të bëjë me këto negociata apo diskutime dhe fillon në proces pa marrë lejen dhe përkrahjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës, i vetmi autoritet përfaqësues direkt i vullnetit qytetarëve të Kosovës.

Këtu, gjatë diskutimeve herën e kaluar dhe kësaj here u kërkuan disa elemente substanciale. Elementi i parë substancial apo thelbësor është, u kërkua që të ketë një platformë, u kërkua që të ketë reciprocitet, u kërkua që të ketë një cak final se ku do të mbërrihet dhe një kohë se sa do të diskutohet. Këto elemente, kjo Qeveri nuk ishte në gjendje që t'i realizonte. Nuk i realizoi, sepse nuk ka një platformë mbi bazën e të cilës do të diskutohet dhe cili do të jetë qëndrimi dhe interesi i qytetarëve të Kosovës dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

Nuk ka një reciprocitet, sepse u caktua një zëvendëskryeministër, një nga gjashtë të tillë, u caktua që të takohet dhe të diskutojë me një shërbyes civil në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Serbisë, një nivel drejtori. Çka ndodhë tjetër? Nuk ka reciprocitet, as në mënyrën e sjelljes, as në mënyrën e komunikimit as në mënyrën e deklarimit. Dhe, nuk ka reciprocitet që është më e keqja, kthehemi në fillim te platforma, nuk ka reciprocitet në kërkesa çka kërkojmë ne, çka kërkon Serbia dhe del në një pikë ku roli i Parlamentit me Rezolutën që u aprovua këtu, u zvogëlua, u zvogëlua, sepse një kërkesë thelbësore kishte Lidhja Demokratike e Kosovës, kërkesa që çdo marrëveshje, çdo rezultat që del nga këto diskutime të aprovohet me 2/3 nga ky Kuvend dhe përfaqësuesit e pushtetit nuk e patën guximin që ta marrin këtë përgjegjësi se çdo rezultat i këtyre diskutimeve, të aprovohet me 2/3. Ky ishte problemi që këta e panë. Çka na ndodhë këtu? Ndodh që amortizohet roli i Parlamentit të Kosovës, ndodh që njëri nga 6 zëvendësit e kryeministrit shkon dhe vazhdon me mungesë të reciprocitetit, të përfaqësimit direkt dhe me mungesë të reciprocitetit të ofrimit apo të kërkesave, prandaj ndodhemi në këtë formë, ku formati është i ndryshëm. Por, tash po na del edhe një problem tjetër, kërkohet që të ndryshohet edhe formati, kërkohet që diskutimet në bëhen në Beograd dhe në Prishtinë. Ky është një problem tjetër edhe konceptual, është një problem tjetër edhe politik, është një problem që rrezikon edhe të ardhmen.

Mirëpo, t'i kthehemi edhe për pak thelbit të problematikës. Cili është, realisht çka po diskutohet? Këtu na është thënë që ka diskutime teknike. Diskutimet teknike për prerjen ilegale të pyjeve, diskutimet teknike për vijën kufitare, dhe çka na ndodhur neve këtu? Këto diskutime teknike, kryeministri i këtij vendi, në deklarata jo më pak se 10 herë ka thënë: "Ky është një shans i madh, deklaratat që janë në të njëjtën vijë, edhe me deklaratat e presidentit dhe kryeministrit të Serbisë, ky është një shans i madh për pajtimin historik në mes serbëve dhe shqiptarëve". Si mund të jetë shans i madh për pajtimin historik në mes shqiptarëve dhe serbëve e pyes kryeministrin? Si mund të jenë shans i madh për pajtimin historik në mes serbëve dhe shqiptarëve, diskutimet teknike për prerjen e ilegale të pyjeve apo për përcaktimin e vijës kufitare apo për kthimin e regjistrimit civil, apo për kthimi e artefakteve? Nuk është një shancë ky për pajtimin historik mes shqiptarëve dhe serbëve apo realisht unë dyshoj dhe dyshimi im është i bazuar se mbrapa këtyre diskutimeve dhe mbrapa sidomos të këtyre deklarimeve, fshihet hilja e madhe, sherri i madh i kësaj Qeverie dhe i kësaj mazhorance. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë nuk dëshiroj në asnjë rrethanë të replikoj me asnjë deputet, por e ndiej obligim kushtetues, ligjor, edhe qytetar, edhe politik, edhe kombëtar të sqaroj para juve, deputetë të nderuar, dhe para të gjithë qytetarëve të Kosovës për problematikat që janë ngritur edhe më herët dhe po ngritën edhe sot.

Takimet në mes..., se po shoh që krejt janë drejtuar kah unë personalisht, takimet në mes të shqiptarëve dhe serbëve nuk i kam filluar unë me Beogradin. Historikisht, unë i kam filluar në Rambuje e tutje, është e vërtetë, jam nënshkruar i çdo dokumenti për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Më herët s'i kam filluar unë, dihen ato rrethana.

Tjetër, u tha këtu se Qeveria nuk di çka do. Unë ju kërkoj juve si Kuvend, nëse ka mundësi dhe hapësirë legale, i nderuari kryesues, t'i jepet kohë Qeverisë, sepse Qeveria e di çka do dhe e ka platformën shtetërore që prezanton në takime. Nëse ju e jepni këtë mundësi, me një deklaram tuajin shumë të thjeshtë, gjë që unë kërkoj të deklarohet Kuvendi, unë do ta prezantoj pikë për pikë Platformën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, platformën e Qeverisë. Kjo platformë rrjedh nga Rezoluta e Kuvendit që ju e keni mbështetur dhe i keni dhënë mandat Qeverisë për ta bërë këtë platformë. Platforma e Qeverisë është bërë dhe punohet në këtë Platforme, por nuk mund të thuhet se Kosova nuk di çka do. Kosova e di shumë mirë se çka kërkon në këto takime.

Deklarimet e deputetëve të veçantë apo të grupeve parlamentare, tani unë e kuptoj se ne jemi njerëz të politikës dhe natyrisht që pretendojmë të fitojmë ndonjë votë më tepër diku, por qytetari i Kosovës nuk është aq naiv sa dikush të pretendojë sot të fitojë votë, duke folur veç kundër të Serbisë, në mungesë të vizionit për të ardhmen. Unë nuk po ju them të mos flisni keq, as të flisni mirë, është punë e juaja si të doni, por mendoj se secili nga ne është dëshmuar në përkushtimet tona për liri dhe pavarësi, ndërsa se a do të fitojë Kosova apo do të fitojë Serbia, një gjë është e sigurt, edhe Kosova edhe Serbia do të jenë pjesë e NATO-së edhe e Bashkimit Evropian. Të them të drejtën jam paksa i befasuar me qëndrimin e LDK-së, kur edhe vetë kryetarin e LDK-së, zotin Isa Mustafa e kam dëgjuar që e përkrah dialogun, ndërsa tash dilet me qëndrime tjera. Në anën tjetër, disa deklarime këtu apo pozicionime që thirren në emër të shqiptarizmes, nuk janë të drejta, nuk e përcakton të qenit zëdhënës apo pronar i shqiptarizmes, kulla e gjatë apo e gjerë, por thjeshtë puna për integritet kombëtar dhe vizioni për integritet kombëtar dhe euro-atlantike, prandaj unë kërkoj, i nderuari zoti Haliti, si kryesues nëse ka hapësirë legale të na jepni kohën neve si Qeveri dhe mua si kryeministër, të prezantoj platformën e Qeverisë së Kosovës dhe prioritetet e Qeverisë së Kosovës. Mund të bëjmë edhe ndonjë pauzë, të kthehemi, nuk është asnjë problem, por ne jemi në dispozicion të informimit të plotë dhe transparencës maksimale për këtë proces. Kuvendi ka vendim, ka rezolutë për dialog, le të deklarohet Kuvendi, Qeveria merr vendim, por mos të shfrytëzohet për folklor politik kjo çështje që ndërlidhet me raportet ndërshtetërore në mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Ju faleminderit! Kështu që unë do të kisha kërkuar që të deklarohemi ...

KRYESUESI: Ju faleminderit, kryeministër!

Personalisht jam plotësisht dakord që ta trajtojmë kërkesën tuaj si Parlament. Është, po ju them që me rregullore është e përshkruar ashtu siç është dhe unë nuk kam të drejtë, megjithatë është një kërkesë e cila duhet të votohet dhe e cila do të ketë pasoja pozitive ose negative për Kosovën, siç është kërkesa e parë të ndërpriten bisedimet me Serbinë. Dhe, unë për vete jam i bindur që më pastaj dikush do të na ulë prapë për ta miratuar një rezolutë tjetër dhe për t'i hëngër fjalët tona se nuk është në rregull, mendimi im është, dhe t'i kërkoj falje në qoftë se po i bie se po e keqpërdori këtë dhe janë dy kërkesa tjera. Megjithatë, unë mendoj që koha dhe hapësira kohore për çështjet të cilat janë ngritur, për Qeverinë janë tepër të kufizuara dhe po kërkoj vërtet deklarin pak më vonë e në doni tani mbi bazën e kërkesës që e ka bërë kryeministri në emër të Qeverisë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Pra, kërkesa ime është kjo: Le të krijohet hapësirë kohore për informimin e Parlamentit të Kosovës, për prioritetet e Qeverisë së Kosovës, Platformën e Qeverisë së Kosovës, pra të informohet Parlamenti.

KRYESUESI: Zoti Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë duhet të saktësoj diçka, sepse edhe herën tjetër ju thashë, më takon për kah natyra dhe përgjegjësitë që i kam në grupin tim parlamentar dhe në LDK, që kur flitet në mënyrë kolektive në diskutim për partinë, duhet t'i jap dy fjalë. Nuk ka të bëjë kjo a je për a kundër dialogut, se LDK-ja nuk ka qenë kudër dialogut në asnjë fazë për Kosovën. Çështja është, ka nuancë kjo, që për çështje fundamentale-nacionale, kjo është çështje fundamentale, le të quhen biseda teknike, si të doni quani, e dimë edhe ne dhe ju që janë çështje fundamentale, duhet të provohet të krijohet konsensus i institucioneve. Në këtë rast, ne si opozitë nuk kemi ku e krijojmë atë, pos në Kuvend. Kjo është nën një.

Nën dy, insistimi në temporalitetin, në dinamikën e këtyre bisedimeve edhe LDK-ja, po e përsëris edhe unë sot, mendon që nuk ka kurrfarë urgjence që të nguten dhe të shkohet në hundë e buzë për të mbërri diçka para kohe, por çdo gjë duhet të mbërrihet me kohë. Dhe, këtu nuk ka një lëvizje, as një pikë, asnjë presë e asaj që kemi thënë para dy muajsh në këtë... dhe mund të merren fjalët që i kam thënë edhe unë vet dhe që jam përpjekur sot t'i rinënvizoj. Kjo është esenca. Pra, nuk ka nevojë të shtyhem me fjalë, që thuhet, sepse tema është e madhe, tema është me shumë peshë dhe përgjegjësia e fjalës së dhënë këtu, është përgjegjësia e fjalës, se këtu po thuhet me fjalë, por ky Parlament emrin e ka parlare, me kuvend, shqip i thonë me fol, se këtu me qyskia nuk ka ardhur kurrkush, por ka ardhur të bisedojë për problemet që i ka ky vend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Unë, kërkesën e kryeministrit.... Po, regjia, zotit Hamiti fjalën!

SABRI HAMITI: Sa i përket kësaj që ofroi kryeministri, unë e mirëpres shumë. Nuk ka nevojë sot të ngutemi as me këtë problem. Le të kryhet me rregullat e Parlamentit interpelanca. Nëse kryeministri është i gatshëm dhe e ka, fundi i fundit, detyrim, sepse është Qeveri që merr përgjegjësi para vendit për politikën, e tha vetë, të jashtme dhe të brendshme të këtij vendi, atëherë të vjen në një mbledhje tjetër të Kuvendit dhe e paraqet platformën e bisedimeve. Unë edhe një herë po e them variantin se jam i përgjegjshëm çka po them, mund të bëhet edhe në mbledhje jo publike. Këto ndodhin, nëse ka nevojë, nëse ka gjëra që edhe nuk duhet të bëhen publike para kohe. Kaq.

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Kryeministri, zoti Thaçi e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti Hamiti, unë nuk e theksova që nga fillimi, në asnjë rrethanë nuk dëshiroj që të replikoj me asnjë deputetë, por të sqaroj secilin deputetë në pyetjet që janë parashtruar shumë të drejta dhe shumë legjitime, pavarësisht nga ndonjë motivacion politik, gjë që e kuptoj.

Në asnjë rrethanë nuk do të lejoja që ky Parlament të mbajë takime të mbyllura para qytetarëve të vendit, por çdo gjë që kam për të thënë, unë do ta them para gjithë qytetarëve të vendit, me transparencë të plotë, sepse nuk kemi asgjë për të fshehur. Por, edhe diçka tjetër. Pushtetet janë të ndara. Qeveria ka pushtetin ekzekutiv, gjë e cila nuk mund të bartet tek Parlamenti. Prandaj, në bazë të Rezolutës së Parlamentit që ju e keni votuar, ia keni dhënë mandatin, Qeverisë, Qeveria e ka Platformën, e zbaton dhe natyrisht do të punojmë në përputhshmëri me mandatet e pushteteve të cilat janë të ndara, edhe legjislativi, edhe ekzekutivi. Unë do ta respektoj mandatin tim të plotë, të qytetarit të Kuvendit, pra mandatin tim ekzekutiv.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Mirë, zoti Hamiti, si drejtues i grupit.

SABRI HAMITI: Unë edhe një herë i dhashë peshë më të madhe kësaj, unë e kam mënyrën time të mendimit. Nuk është puna a duhet të jeni transparent ju apo ne, është krejt çështje tjetër. Është pak më shumë, është interes nacional. Vende shumë më të zonjat se ne, kanë çështje që i trajtojnë në mënyra më specifike. Nëse ne nuk kemi, e kjo nuk qenka e tillë, atëherë vini ju në një mbledhje dhe krejt në mënyrë transparente e paraqitni, domethënë, kërkesa ime është për të lejuar mundësi, jo për të marrë mundësi. Kaq.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Kërkesa ime ishte: Informimi i Parlamentit, pra ishte vullneti i imi dhe jo detyrim kushtetues, këto janë prioritetet e ekzekutivit. Ndërsa, theksoj edhe një herë, unë dhe Qeveria e Kosovës nuk kemi asgjë për të fshehur në raportet ndërshtetërore në mes Kosovës dhe Serbisë dhe gjithçka që do të ndodhë e që po ndodh edhe me shtetet tjera fqinje, duhet të jetë transparente dhe duhet të jetë i informuar çdo qytetar i Republikës së Kosovës, qysh është informuar. Ky ka qenë

përcaktim imi jetësor gjithmonë, para se gjithash me Serbinë dhe qytetarët e dinë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Unë e kam një kërkesë të kryeministrit...

(Reagim në sallë)

Ju lutem, qetësi, kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Dialogu nuk ka filluar me këtë Qeveri, nuk ka filluar me mua. Unë jam në interpelancë dhe jam në dispozicionin tuaj për sqarimet e çdo detaji, të gjitha zhvillimeve. Ky dialog ka pasur procesin e vet parapërgatitor, të cilin e kemi përgatitur Qeveria e kaluar, së bashku me presidentin e kaluar, pra koalicioni PDK dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, kështu që dialogun e kemi filluar bashkë, pavarësisht nga pozicionet politike që janë aktuale sot. Unë pajtohem me ju plotësisht në qasjen për transparencë të plotë, edhe ju po pajtoheni me mua, prandaj e kemi një qëllim të përbashkët si ta forcojmë këtë proces dhe si ta përmbyllim sa më suksesshëm për Kosovën, gjë për çka jam i sigurt që do të ndodhë, prandaj edhe këto diskutime që kanë ndodhur sot, janë në shërbim dhe mbështetje të suksesit të ri të Kosovës në marrëdhëniet ndërshtetërore Kosovë – Serbi dhe procesin integruar evropatlantik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti kryeministër!

Sipas radhës po vazhdojmë, por unë dua t'ju them që, nëse doni, votojmë tani, nëse doni, më vonë. Ne, shikoni, ju lutem, ju lutem, unë po e udhëheq mbledhjen edhe ju nuk keni nevojë të bërtitni. Nuk është debat ky, ky është mocion, mocion-interpelancë. Është kërkuar...

Të lutem, të lutem, rri në vend!

(Reagim nga salla, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYESUESI: Patjetër kemi për ta përfunduar, unë po e udhëheq mbledhjen. Kemi një problem shumë, ta them të përgjegjshëm për ne të gjithë. Po them prapë, kemi votimin e tri pikave të mocionit. Unë, në ndërdijen time jam plotësisht i bindur që ne, me Rregulloren tonë ia kemi kufizuar Qeverisë me 15 minuta dhe pozitës t'ia marrim votat për ta bindë njëri-tjetrin se a duhet votuar apo jo? Ia kemi kufizuar të drejtën që të sqarohet. Ky është vendimi ynë i të gjithëve dhe ne bashkë e kemi votuar dhe kështu po e vazhdojmë seancën, por mendoj që kërkesa është plotësisht e drejtë dhe unë, në fund të debatit, kur të kryhen këto diskutimet e grupeve parlamentare, para se ta marrë fjalën i fundit, kryeministri dhe propozuesi i interpelancës, kam për obligim që ta qes në votim kërkesën e kryeministrit që të sqarohet, me qëllim që të binden për të votuar për mocionin ose kundër mocionit dhe është, mendoj, e drejtë e jona të vendosim, edhe pse në Rregullore nuk shkruan kështu, po e pranoj këtë. Nëse doni, nëse jo, atëherë vazhdojmë sipas rregullave.

Sipas renditjes këtu, Lutfi Haziri e ka fjalën!

LDK-ja i ka edhe 14 minuta.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Unë edhe kur është debatuar për Rezolutë, e kam thënë që Kosova po hynë në një agjendë teknike me përfaqësuesit më të lartë politik, ndërsa Serbia një agjendë politike me një shërbyes civil, dhe këto bisedime që ne po i quajmë, a që kryeministri vazhdimisht po thotë është një dialogim, zëvendëskryeministri e ka përfshirë në negociatë. Ne do ta kemi të qartë a po bisedojmë, a po dialogojmë, a po bëjmë me negociatë? Nëse janë negociatë dhe përfundon me diçka, me atë që u paralajmëruar e që Kosovës ju kanë ofruar në vitin 2006, kopjet e dokumenteve civil, librave kadastral dhe shumë çka tjetër, atëherë tregon qartë që po degjeneron dialogu në negociatë e cila nuk ka konsensus, dhe e cila shkel vijat e kuqe deshi apo nuk deshi ta pranoj kryeministri apo Parlamenti në këtë rast.

Shumica e politikës shqiptare ka pasur qëndrim të qartë për kohën e keqe të dialogut, kohën e papërshtatshme të dialogut dhe mënyrën se si ka hyrë në këtë dialog sepse, nëse ne kemi pasur kushtëzime deri dje, duhet t'i kthehemi problemit thelbësor të cilin e ka Kosova. Unë mendoj që ne nuk duhet të frikohemi, të themi hapur që problemi i Kosovës janë njerëzit e Kosovës dhe këtu e kam fjalën për Lindjen e Kosovës, sepse Veriu është problem një kuptimin e zbatimit të ligjit. Atje Kushtetuta nuk zbatohet, plor Lindja e Kosovës e ka problem prej njerëzve të saj. Në Lindje të Kosovës kanë mbetur qytetarë shqiptarë jashtë kufijve të Kosovës, pa të drejta, të harruar politikisht dhe pa përfaqësuar. Konventa Ndërkombëtare për Pakicat Nacionale, i obligon shumicën, në këtë rast shqiptarët, Republikën e Kosovës që me u kujdes për kërkesat politike të qytetarëve të saj, në këtë rast edhe, nëse kanë mbetur jashtë kufijve.

Lugina si term gjeografik është shumë ngushtë, sepse Lugina e Preshevës ka quar në një marrëveshje të Konçulit... e cila nuk e ka realizuar këtë të drejtë, atëherë është tepër absurde të flasim për çështje që Kosova domosdoshmërisht do t'i zgjidhë, por t'i harrojmë njerëzit dhe banorët e vet që kanë mbetur pa kurrfarë të drejta. Aspirata e tyre është e shprehur me referendum, mos frikohemi dhe mos të themi se ata nuk kanë pasur të drejtë ta bëjnë, sepse aspiratën tonë si Kosovë, e kemi filluar me referendumin për pavarësinë e Kosovës, e kemi realizuar, ndërsa pjesa tjetër ka mbetur e hapur për mua si deputet dhe e cila duhet të realizohet.

Edhe zoti kryeministër, edhe presidentja e Republikës nuk duhet të frikohen nga e drejta e përfaqësimit dhe realizimit të kërkesave politike për njerëzit, për shqiptarët që jetojnë në Preshevë, në Bujanovc dhe Medvegjë, së fundi ata janë Lindje e Kosovës dhe ne nuk kemi ndërtuar mekanizma problematik sikur që ka ndërtuar Serbia mekanizma problematik në Kosovë, me struktura paralele.

Nën dy, përfitimi nga këto bisedime për Kosovën, është thënë në fillim janë zero, por mbetet zero, sepse marrja e kopjeve, pranimi që të marrim kopje Kosova, fundja ne duhet të themi që regjistrat Kosova i ka bërë të rinj, por dokumentacioni i vyen për

konfirmim, i vyen për interesa të vendit, i vyen për interesa nacionale. Pra, tregon qartë që Kosova nuk po kërkon qartësi dhe nuk po kërkon angazhim serioz për të nxjerrë atë që çdo shtet, çdo republikë dhe çdo përfaqësues do të kërkojë ta realizuar dhe pa hezitim. Në këtë rast, krejt këto bisedime po i përcjell një hezitim, një paqartësi dhe fundja do të vijmë në nëntor, ku do të ndërprehen bisedimet sepse, mos harroni, Kosova ka nënshkruar protokoll me Qeverinë e Serbisë për probleme teknike, kurrë nuk i ka implementuar. Kosova ka bërë marrëveshje teknike, jo vetëm me një sektor, në tetë sektorë, sepse ka qenë e kushtëzuar ose duheni të bisedoni për çështje teknike ose nuk ka proces të definimit të statusit final.

Është realizuar, nuk është implementuar asnjë pjesë e këtyre marrëveshjeve teknike, sepse është harxhuar kërkesa dhe Serbia natyrisht është sjellë në opstruksion si gjithmonë dhe e ka dështuar për nevoja dhe për agjenda të saja politike. Atëherë qëllimi im kryesor si deputet dhe fjala ime sot ka të bëjë me, të mos frikohemi, ta hapim problemin kryesor që sot e ka Kosova për njerëzit e vet, në lindje të Kosovës, sepse këta janë pjesë e pandashme e zgjidhjes së problemit dhe Konventa Ndërkombëtare për Pakica Nacionale e kërkon përfaqësimin. Nëse ata njerëz, përfaqësues politik thonë që nuk mundet me na përfaqësuar Kosova pos Shqipëria, atëherë obligimi shkon diku tjetër, por unë besoj kërkesa e përditshme e tyre është që këto problem duhet të zgjidhen, mos u merrni me aplikacion, a kanë të drejtë ata për të aplikuar për dokumente, për pasaporta, se problemi kryesor politik i tyre është mbet i pazgjidhur. Ju faleminderit, kryeministër!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj- Bujupi.

4 minuta i keni siguruar, parlamentarët ...

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Duke marrë parasysh që i kemi vetëm 4 minuta, unë do të ndalem vetëm te pika e fundit në të cilën do të diskutoj. Pavarësisht lojës së pingpongut që po e luan kryeministri Thaçi, veprimet e tij në dëm të vendit, nuk do të amnistojnë apo nuk do ta tërheqin vëmendjen e opinionit. Çdo kërkesë për transparencë rreth bisedimeve edhe më herët edhe tani nga shumica shqiptare në këtë Kuvend dhe nga qytetarët e Kosovës, ka rezultuar me një thënie të famshme që Kosova ka vija të kuqe të saj dhe pikërisht këto vija të kuqe të sajë janë shkelur në ditët e para të negociatave nga Qeveria Thaçi. Këtë e pranoi në raportimin që bëri edhe kryenegociatorja para Komisionit të Punëve të Jashtme, e kjo lidhet me temën e energjetikës, ku më lejoni të citoj. Edita Tahiri prej 8.4.2011, citoj: “ Ne kemi ofertuar që të bëjmë regjistrimin e një kompanie subkontraktore e KEK-ut, e cila do t’i kishte kompetencat e kufizuara, pra është fjala për serbët e veriut se si do të sigurohen pagesat që të jenë në gjendje t’i lexojë njehsorët, të krijojë faturat dhe të grumbullojë para si nënkontraktore.

Të nderuar, sipas ligjeve të Kosovës, KEK-u dhe kompanitë publike i trajtojnë të gjithë konsumatorët barabartë, ndërsa Qeveria e Kosovës ofertoj që pagesa e rrymës nëndahet në baza etnike dhe që të pranojmë ndarjen e shërbimeve në veri të vendit për serbët dhe për shqiptarët. Kjo është një nismë e rrezikshme e Qeverisë Thaçi që gjendja në veri i cili tani de fakto është i ndarë apo i izoluar, ta fillojë ta zyrtarizojë, duke u fshehur pas nocionit teknik, ndërsa refuzimi i Serbisë, kryeministër nuk bëhet duke e

ndarë teknikisht Kosovën përmes heqjes dorë nga sovraniteti i territorit të vet, përmes veprimeve të cilat janë menduar dhe dakorduar shumë kohë më parë në shkëmbim të vazhdimit të qëndrimit në pushtet, pavarësisht çmimit të cilin po e paguan vendi. Kemi thënë edhe më herët që pikënisja për këtë dialog ka qenë e gabuar, kështu po vazhdon dhe fundi do të jetë tepër i keq për vendin dhe me pasojat të mëdha. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër,

Ndonëse janë në vazhdim bisedimet të cilat po quhen teknike, megjithatë nj problem mbetet i paprekshëm, së paku nuk ka informacione se është folur për gjendjen e zgjidhjes për automjetin me regjistrim të Serbisë të cilat në Kosovë hyjnë pa paguar asnjë lloj të sigurimit. Problemi i njëjtë është edhe me automjetet nga Mali i Zi, por duke ditur disponimin e këtij shteti fqinj, është reale të pritët se zgjidhja do të lehtë se me Serbinë.

Derisa vazhdon hyrja në territorin e Kosovës e automjeteve pa pasur asnjë lloj të policës së sigurimeve, ato po shkaktojnë dëme të cilat duhet të kompensohen prej Fondit të garancisë së Kosovës, në fakt parat për këtë fond nuk kanë prejardhje tjetër, pos nga pagesat, përkatësisht participimi i kompanive të sigurimit të licencuar në Kosovë.

Për kompensimin e dëmeve të këtilla në secilin vit duhet paguar qindra mijëra euro, më saktësisht që nga viti 2002 deri në fund të vitit të kaluar për 1350 raste, janë paguar mbi një milion e 435 mijë euro. Gjendja sipas viteve duket kështu: Në vitet 2002 – 2004 kanë qenë 181 rast, janë paguar afër 356 mijë euro, 2005-2006, janë 243 raste, janë paguar mbi 232 mijë euro, viti 2007, 162 raste, janë paguar afër 160 mijë euro, viti 2008 janë 202 raste, janë paguar mbi 219 mijë euro, viti 2009, 253 raste, janë paguar 146 mijë euro, kurse në vitin 2010, kjo gjendje është edhe më drastike me qenë se ka ndodhur 309 raste, për të cilat është dashur të kompensohen dëme në vlerë mbi 323 mijë euro.

Duke pasur parasysh këtë situatë është me interes të dimë, deri kur duhet pritur për zgjidhjen e këtij problemi? A është kjo temë e bisedimeve, a ka përgjegjësi rreth kësaj? A ka zgjidhje tjetër Qeveria e Kosovës apo e tëra varet nga vullneti i Serbisë dhe vendimet politike që marrin institucionet ndërkombëtare të pranishme në Kosovë?

Në kuadër të kësaj çështje është mirë të informohemi se çfarë qëndrimi ka Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme, automjetet që qarkullojnë me targat e qyteteve të Kosovës, por të lejuara nga autoritetet e Serbisë. Sa për informim vetëm t'ua përkujtoj se një pjesë e dëmit të kompensuar ka të bëjë edhe me automjetet që kanë targa të këtilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Pa dyshim që tema që po e diskutojmë është një temë shumë e rëndësishme, por një temë që kërkon një qasje shumë racionale dhe një qasje shumë të arsyeshme, sepse fillimi i bisedimeve me Serbinë, është një obligim ndërkombëtar që e obligon Kosovën edhe karshi Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, por edhe karshi miqve tanë, që janë pjesë e Kombeve të Bashkuara që e kanë votuar këtë proces.

U shpjegua edhe më herët procesi është duke shkuar në rrjedhën normale, sepse Kuvendi ka mandatuar fillimin e këtyre bisedimeve dhe Qeveria në bazë të Kushtetutës, ka të drejtë që të propozojë agjenda dhe natyrisht në një fazë të caktuar kur këto bisedime do të finalizohen, Qeveria duhet të vijë në Parlament dhe të marrë mbështetjen e Parlamentit.

Unë do të ndalem në 3 – 4 segmente, që janë shumë të rëndësishme dhe që nuk u prekën. Është e vërtetë që kryeministri shpjegoi vijat e kuqe dhe besoj që gjithë ne që jemi deputetë i dimë ato vija të kuqe, sepse ato janë parime të Kushtetutës dhe askush nuk mund t'i prekë ato parime kushtetuese. Dhe, ne kishim një strategji të përgjithshme të vijave të kuqe dhe për mirëvajtjen e këtyre bisedimeve dhe për ruajtjen e interesit nacional të Kosovës, është e domosdoshme që të kemi edhe strategji sektoriale, të shohim sipas sektorëve të temave që diskutohen, cilat janë interesat e Qeverisë së Kosovës dhe të mundohen që në tryezën e bisedimeve të inponojnë tema që janë në interes të Kosovës ,sepse jo gjithmonë në bisedimet e deritashme kemi pasur tema që janë në të mirën e Kosovës? U përmend edhe në diskutimet paraprake kemi humbur shumë kohë mbas këtyre kopjeve të regjistrave civilë dhe regjistrave kadastralë edhe pse këta regjistra janë krejtësisht të papërdorshëm sepse Qeveria e Kosovës para disa kohëve ka filluar projektin e krijimit të regjistrat elektronik edhe gjendjes civile edhe gjendjes kadastrale, bile edhe zëvendëskryeministra ka punuar në këtë projekt të Ministrisë së Administratës Publike dhe ka filluar projekti i krijimit të regjistrat elektronik, kështu që nuk ja vlen shumë me humbë kohë në këtë çështje.

Unë do t'i përmend dy momente që padyshim duhet t'i kemi parasysh. Momenti i parë është duhet të kemi një qasje proaktive ndaj përfitimeve që do të ketë Kosova nga ky proces, sepse tani po dihet që përfituesi kryesor do të jetë Serbia me fitimin e statusit të kandidatit. Duhet të bisedohet gjatë këtij procesi që të kemi një agjendë të qartë se kur Kosova do të hyjë në raporte kontraktuese me Bashkimin Evropian, në mënyrë që këto bisedime të mos bëhen vetëm për të hapur derën anëtarësimit të Serbisë në Bashkimin Evropian, por trasohet edhe rruga e qartë që Kosova të fillojë në këtë proces.

Çështja e dytë, është çështja e njohjeve të Republikës së Kosovës gjatë periudhës sa zgjasin këto bisedime teknike.

Kohë më parë, Ministria e Punëve të Jashtme ka miratuar një strategji të lobimit, që është një faktor shumë i rëndësishëm. Është shumë me rëndësi që të intensifikohen angazhimet

e Qeverisë, por edhe të faktorëve tjerë që të vazhdohet me lotimin, sepse praktika tregon kur në ndonjë vend hapen procese të bisedimeve apo negocimeve, disa shtete sikur hezitojnë apo presin epilogun për të proceduar me njohje, duhet të intensifikohen tani përpjekjet që fillimi i procesit të dialogut me Serbinë mos të pengojë procesin e njohjes dhe të fillohet sa më shpejt me strategjinë e njohjes.

Gjithashtu, duhet të përgatitemi për një fazë, një fazë ku ndoshta do të mund të imponohen çështjet politike që Kosova të jetë ajo që do të imponojë tema politike, sepse është interes i Kosovës të zgjidhen disa tema politike që ndërlidhen kryesisht me funksionalizimin e plotë të Kushtetutës së Kosovës dhe të legjislacionit të Kosovës dhe që ndërlidhen kryesisht me kërkesat që duhet t'i bëjë Qeveria e Kosovës dhe të ndalen provokimet në veri dhe në pjesët tjera, që të zhbëhen strukturat ilegale, që të mundësohet shtrirja e Kushtetutës së Kosovës dhe e ligjeve të Kosovës aty ku nuk po zbatohen, dhe në mënyrë të veçantë që sukcesi i projektit të decentralizimit mos të matet me krijimin e disa komunave në brendi të Kosovës, por të matet me krijimin e komunës së veriut, që ka qenë edhe shtyllë kryesore e procesit të decentralizimit dhe në këtë drejtim të kërkohet nga Serbia që të ndalë destruksionin.

Dhe, përfundimisht, nuk duhet pasur ambicie që me këto procese do të arrihet e ashtuquajtura marrëveshje historike shqiptaro-serbe, për shkak se konflikti shqiptaro-serb është aq i vjetër dhe aq fundamental sa që nuk mund të rezultojë me një marrëveshje të tillë. Është me rëndësi që Kosova të dijë çka do në këto procese, është me rëndësi që Kosova të ketë një agjendë nacionale se deri ku mund të shkojë në këto bisedime dhe është me rëndësi që vërtet krahas përfundimit të këtij procesi, që nuk e ka një datë të caktuar, Kosova të trasojë rrugën e vet të integritimit evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Skender Hyseni. LDK-ja i ka edhe 6 minuta hapësirë kohore.

SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni një vërejtje të vogël! Kujtoj që duhet të respektohet renditja e paraqitjes për fjalë. E kuptoj nevojën e dhënies alternative të partive të ndryshme, por ka rëndësi sepse çdo deputet që paraqitet për fjalë, e ka parasysh edhe kohën pse po paraqitet në kohën e caktuar.

LDK-ja e njeh instrumentin e bisedave, të dialogut si instrument të pa zëvendësueshëm për përafrimin e qëndrimeve edhe midis shtetesh. Si do që të jetë, LDK-ja këtë dialog aktual që zhvillohet e sheh të parakohshëm, absolutisht të parakohshëm, të panevojshëm dhe nuk ka qenë urgjent.

Më lejoni t'i qasem nga një këndvështrim krejt tjetër fare sot, të cilin fatkeqësisht nuk e dëgjova. Fatkeqësisht, po them, sepse nëse Qeveria e Republikës së Kosovës ka dështuar në hartimin e kërkesave konkrete për Bashkimin Evropian, ky Parlament nuk do të duhej sot të dështonte në artikullimin e qartë të kërkesave të caktuara, të cilat duhet t'i drejtohen Bashkimit Evropian dhe Komisionit Evropian më konkretisht në kohën dhe në procesin e dialogut me Serbinë.

Janë pesë vendeve të Bashkimit Evropian që nuk e njohin Kosovën. Janë ato pesë vende që kanë qëndrim shumë të qartë ndaj statusit të Kosovës. Janë 22 vende të Bashkimit Evropian që e njohin Kosovën dhe ato 22 vende në raporte bilaterale me Kosovën kanë qëndrim shumë të qartë ndaj statusit. Mirëpo, ato 22 vende, shumë nga to, fatkeqësisht, në institucionet e Bashkimit Evropian jo rrallë herë kanë qëndrim neutral ndaj statusit. Dhe kjo duhet të na bëjë ne që Bashkimit Evropian t'i kërkojmë qartë, që qëndrimi ndaj statusit të Kosovës të jetë i qartë, sepse neutraliteti ndaj statusit, në njërën anë, nga shumë vende të cilat e kanë njohur Kosovën, dhe qartësia e skajshme e 5 vendeve, që s'e kanë njohur Kosovën, e të cilat aktivisht punojnë kundër pavarësisë së Kosovës, po ka efekte rrënuese, ta theksoj, efekte rrënuese në raportet kontraktuale të Kosovës me Bashkimin Evropian.

Kjo duhet të thuhet qartë dhe të adresohet si kërkesë e qartë. Kërkesë e cila është adresuar qartë në Nju Jork, në shtator, në takimet që unë kam pasur me përfaqësues kyç të Bashkimit Evropian dhe përfaqësues të partnerëve të Kosovës. A e zbeh partneritetin e Kosovës, partneritetin Kosovë – Kuint, partneritetin Kosovë – SHBA shtrimi i kërkesave të qarta nga ana e Kosovës? Jo. Përkundrazi, e forcojnë këtë partneritet. E bëjnë këtë partneritet më produktiv dhe Kosovën e faktorizojnë.

Kosova nuk guxon, absolutisht, të bëjë veprime të cilat do ta kthejnë situatën në pikën zero, sepse kjo nuk i ndihmon as përafrimit dhe pajtimit me Republikën e Serbisë, si dy vende fqinje. Dialogu duhet të vazhdojë sepse ai ka nisur dhe nuk ndalet, është përtej mundësive të këtij Parlamenti që ta ndalë. Mos të krijojmë iluzione këtu as për vetveten tonë, as për opinionin.

Mirëpo, kjo nuk guxon ta pengojë këtë Kuvend dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës që t'i adresojë një numër kërkesash të qarta drejt Komisionit Evropian. Komisioni Evropian nuk ka delegacion në Kosovë. Ka Zyrën ndërlidhëse. Zyre ndërlidhëse ka pasur që nga pas lufta, ditët e para të pas luftës. Nuk ka delegacion në Kosovë, sepse janë 5 vende që e diktojnë politikën e jashtme të BE-së karshi Kosovës në këtë pikë.

Pas aprovimit të Traktatit të Lisbonës, kjo nuk ka guxuar dhe nuk guxon të vazhdojë të ndodhë. Dhe ne duhet ta bëjmë të qartë këtë. Nëse ne nuk e bëjmë të qartë, nëse ne nuk e themi atje ku duhet, unë ju siguroj se nuk do ta thotë askush në vend të Kosovës.

Ne duhet të shtrojmë pyetjen e qartë: A e njeh Komisioni Evropian ministrin e Jashtëm të Republikës së Kosovës? A e pranon Komisioni Evropian për partner, për bashkëbisedues ministrin e Jashtëm të Republikës së Kosovës? Dhe, duhet të marrim përgjigje të qartë.

Kjo kërkesë absolutisht nuk e vendos Kosovën karshi Bashkimit Evropian. Kjo kërkesë absolutisht nuk e konfronton Kosovën me Bashkimin Evropian. Kjo kërkesë e bën Kosovën partner të Bashkimit Evropian dhe e shton trysninë te vendet që e kanë njohur Kosovën për të bërë trysni mbi pesë vendet që nuk e kanë njohur Kosovën.

Mos të kemi iluzione që ne do ta bindim Spanjën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!

SKENDER HYSENI: A ka mundësi, edhe gjysmë minute të vazhdoj?

KRYESUESI: Gjysmë minute, me rrezik timin, nëse ankohet dikush. Faleminderit! Një minutë, Skenderit!

SKENDER HYSENI: Faleminderit! Mirëpo, është pikërisht ai partneriteti i cili duhet të jetë përmbajtësor dhe substancial, e që duhet të ndërtohet midis Kosovës dhe Bashkimit Evropian, institucioneve të Bashkimit Evropian, që duhet të krijojnë situata të favorshme dhe kontekstin kur edhe pesë vende që nuk e kanë njohur Kosovën, do ta njohin Kosovën. Kosova nuk do të mund asnjëherë të realizojë agjendën shumë të proklamuar evropiane pa ndodhur kjo. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosja” i keni 9 minuta. Nuk e di, jeni të paraqitur këtu disa, po në deshi po ju paraqes me radhë që i keni ose kryetari le të deklarohet. Doni me radhë! Atëherë, deputeti Agim Kuleta e ka fjalën!

AGIM KULETA: Zoti kryesues i Kuvendit!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Sot në Kuvendin e Kosovës e kemi në interpelancë kryeministrin e Republikës së Kosovës. E kemi këtu për të dhënë informacione rreth ecurisë së një procesi që, si i tillë çfarë është, nuk do të duhej të fillonte fare.

Duke qenë kështu, është e qartë se ky kryeministër nuk është këtu për t’u mburrur me atë që ka bërë ai deri më sot, por për të dëshmuar saktësinë e asaj çka kemi thënë ne dje - se këto diskutime janë shumë të pa afta për t’i zgjidhur problemet e vjetra dhe mjaftueshëm të afta për të krijuar të reja, se këto bisedime nuk janë burim zgjidhjesh, por shkaktarë problemesh.

Sikur të ishte ndryshe, sot do të kishim të bënim me një raportim me iniciativën e kryeministrit, e jo interpelancë me iniciativë të opozitës. Udhëheqësi i Qeverisë së Kosovës sot nuk është këtu për të na i përkujtuar të arriturat e dukshme, por për të vënë në dukje kompromiset e fshehta. Atë nuk e ka sjellë këtu suksesi, por fshehja e dështimeve.

Mungesa e transparencës së bisedimeve është pasojë e mungesës së sukseseve në këto bisedime, e mungesa e sukseseve në bisedime ka arritur të bëjë çudinë, ta bëjë këtë Qeveri parimore. Ajo mungesën e transparencës e arsyeton me vendosjen e parimeve të konfidencialitetit me Serbinë. Pra, për këtë Qeveri, sjellje parimore është të vendosë parime me kundërshtarin, në kurriz të qytetarit të vet. Por, nëse rastësisht gabon dhe kërkon me insistim transkripte dhe procesverbale të bisedimeve, shumë lehtë mund të

përfundosh si pjesë e delegacionit në këto bisedime. Dhe, për këtë, duhet falënderuar zemërgjerësia e zonjës Tahiri. Megjithatë, dha zoti që nga ky gabim, pra kërkesa për transparencë, të heqin dorë mbi 2 milionë banorët e Kosovës, sepse ky delegacion vërtet do të bëhej shumë jo funksional.

Lëvizja për Bashkim në këtë situatë kur qytetarët e vendit nga kjo Qeveri janë shndërruar në spektatorë të verbër, idenë e Lëvizjes “Vetëvendosje” për të ftuar kryeministrin në interpelancë e ka konsideruar shumë të nevojshme. Duke përcjellë zhvillimet rreth këtyre bisedimeve, ne nuk po çuditemi a befasohe mi me ato që po dëgjojmë e shohim. Ne vetëm po bindemi për ato që kemi thënë vazhdimisht, se trajtimi i pjesshëm i problemit dhe sipas formateve e kriterëve të caktuara nga të tjerët, nuk mund të sjellë zgjidhje të problemit, as të mirë, as të keqe. Thjeshtë, do ta komplikojë edhe më tepër atë. Ajo që sot do të quhet zgjidhje, nesër do të përbëjë problemin. Sepse, zgjidhjet gjysmake kanë sjellë gjithmonë nevojën për një zgjidhje tjetër, por fatkeqësisht, pas valëve të mëdha të dhunës e urrejtjes, pas betejave të pa fund, qoftë individuale qoftë kolektive.

Prandaj, boshti i të gjitha veprimeve të Qeverisë së Kosovës do të duhej të ishte dhënia fund e shkaktarëve të këtyre betejave. Dhe kjo mund të arrihet vetëm kur problemi të trajtohet seriozisht dhe si i tërë. Ne do të duhej të ishim të privuar nga komoditeti për ta injoruar një problem të madh që ka mbetur pa zgjidhur midis dy shteteve pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, e ky është problemi shqiptaro-serb, me të cilin nënkuptohen çështja e tri komunave të banuara me serbë – Leposaviq, Zubin-Potok dhe Zveçan, dhe tri komunave të banuara me shqiptarë – Preshevë, Bujanoc e Medvegje.

Ikja nga ky problem, nuk paraqet zgjidhje të tij. Është vetëm shtyrje e ballafaqimit me të. Dhe kjo shtyrje, gjithsesi, do të lë prapa pasoja. Do të sjell situatën kur nuk do të ketë çështje të Kosovës Lindore, ndërsa do të ketë vazhdimisht çështje të serbëve në Kosovë dhe Kosovë të mbetur peng e kësaj çështjeje.

Lëvizja për Bashkim, duke vazhduar ta konsiderojë të dëmshëm këtë proces të bisedimeve, rrjedhimisht e konsideron të dëmshëm edhe vazhdimin e tij. Gjithashtu, konsiderojmë se Qeveria e Kosovës duhet të ndër marrë hapa konkretë që janë me kapacitetin e saj në drejtim të zgjidhjes së vërtetë të problemit shqiptaro-serb.

Ruajtja e kësaj gjendjeje është marrje nën mbrojtje të pasigurisë aktuale dhe ndërtimi i një të ardhme të pa sigurt. Mirëpo, kjo zgjidhje nuk mund të arrihet përmes bisedimeve me Serbinë vetëm për çështjet e interesit të saj në territorin e Kosovës. Për këtë, duhet një proces i mirëfilltë negociatash midis dy shteteve, ku do të trajtoheshin në mënyrë të njëjtë tri komunat e banuara me serbë në veri të Kosovës, me tri komunat e banuara me shqiptarë në Kosovën Lindore dhe zgjidhjet që do të arriheshin, do të zbatoheshin reciprokisht. Për këtë nevojitet, gjithashtu, edhe një qeveri e aftë, e qëndrueshme dhe kredibile, mungesën e së cilës vërtet po e përjetojmë shumë rënd.

Unë këtu kam edhe disa kopje të platformës politike të Lëvizjes për Bashkim, të cilat i ka marrë Qeveria me kohë, qysh në kohën e hartimit dhe shpeshherë ka ditur të thotë se nuk ekzistojnë platforma tjera përveç strategjisë së paraqitur nga Qeveria. Unë, atëherë,

publikisht, do të thotë si dëshmitar këtë do t'ua dorëzoj prapë. E di që do të injorohet, por të paktën nuk do të mund të mohohet më tepër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi!

AHMET ISUFI: Po shihet se këto bisedime kanë filluar në mënyrë jo serioze, të pa përgatitura, po vazhdojnë ashtu dhe do të përfundojnë në të njëjtën mënyrë.

Me vetë faktin që devijohet fjalori në Parlamentin e Kosovës kur interpelanca është thirrur për bisedimet Kosovë – Serbi, tregon më së miri për nivelin e përgjegjësisë së kësaj Qeverie, e cila absolutisht nuk e ka për synim që të udhëheqë ashtu si duhet, e që të jetë transparente sa duhet.

Me vetë faktin që më së shumti nga kryeministri përdoret fjala transparencë, është deklarim për mungesë të transparencës. Kur i kërkohen procesverbale, kur i kërkohen shifra, ai përmend fjalën transparencë. Me gjasë nuk e kupton sa duhet këtë fjalë dhe po ashtu kur kërkohet zbatimi i Kushtetutës në gjithë territorin e Kosovës, ai vjen lexon pasuse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Dhe, po ashtu, për ta banalizuar edhe më shumë, në kohën kur thirret në interpelancë për bisedimet, ai hapë çështjen e autostradës dhe e devijon debatin në Parlamentin e Kosovës, duke thënë se është interes kombëtar dhe duke iu treguar deputetëve të Parlamentit të Kosovës se çfarë rëndësie paska autostrada. Dhe, në vend se kjo autostradë të jetë në shërbim të kombit vërtet, që të shkojë në drejtim të Kosovës lindore, në mënyrë që shqiptarët të lidhen përmes kësaj autostrade, ajo devijohet atje ku s' duhet, sepse dikujt i duhet për t'u devijuar atje.

Prandaj konsideroj se këto bisedime nuk kanë kurrfarë vlere...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas renditjes, fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se bisedimet po tregojnë vështirësitë e para, të cilat kanë qenë edhe të prognozuara në debatin që e patëm, kur edhe aprovuam Rezolutën.

Mendoj se kemi lëshuar një shans që gjatë aprovimit të Rezolutës të kemi një tolerancë më të madhe, një kulturë debati më të madh që të arrijmë bile një konsensus bazik për bisedimet me Serbinë, sepse këto janë çështje jetike dhe në atë mënyrë të eliminojmë problemet e pakicës dhe shumicës, për të cilat foli deputeti Hamiti këtu.

Gjithsesi këtë interpelancë unë e konsideroj të dobishme, sepse besoj që debati do të na çojë deri te ato pikat të cilat i kemi të përbashkëta dhe duhet t'i kemi në këtë çështje me interes shumë të madh.

E dyta, e mora fjalën për të mbështetur atë pjesë të Rezolutës që thotë se po bisedojmë si dy shtete të barabarta dhe të pavarura. Mendoj se këtë duhet ta mbështesim të gjithë, por ne do të provojmë se po bisedojmë si dy shtete të barabarta dhe të pavarura për aq sa e zbatojmë parimin e reciprocitetit. Në qoftë se parimi i reciprocitetit është inekzistent në këto biseda, atëherë ajo pjesë e Rezolutës e cila flet se po bisedojmë si dy shtete të pavarura, besoj se dëmtohet lehtë, zbehet shumë dhe ne tregojmë një dozë të inferioritetit i cili nuk ka arsye që të tregohet për arsye se u tha që jemi fitues, u tha që e drejta është në anën tonë, u tha që ne duhet t'i prezantojmë interesat në këto biseda.

Prandaj, sot disa herë u përmend këtu çështja e reciprocitetit dhe mendoj se delegacioni ynë, cili do qoftë ai, duhet ta marrë këtë seriozisht.

Tre, unë mendoj se është mirë që kryeministri sot shprehu gatishmëri që ta prezantojë platformën e Qeverisë. Natyrisht se për këtë s'duhet të vendos Kuvendi, mendoj, se në qoftë se duhet, unë e përkrah që të vendosim, por dihet se gjithmonë kryeministri mund të prezantojë, po edhe Qeveria kur të dojë dhe ne e mirëpresim këtë, por kjo nuk duhet të kuptohet vetëm si shenjë e vullnetit të mirë, por si obligim i Qeverisë që në çdo fazë ta informojë Parlamentin mbi fazën e bisedave, mbi platformën, mbi rezultatet, mbi të gjithë atë që i përcjell këto bisedime. Prandaj, në këtë drejtim unë mendoj se kjo duhet të bëhet sa më shpejt. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Alma Lama e ka fjalën! Katër minuta i keni!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në fillim kam një pyetje. Ne, si deputetë të ri, ne që jemi për herë të parë në Kuvendin e Kosovës, nuk e dimë, kur zhvillohen interpelanca, kryeministri duhet të rrijë prezent apo interpelanca zhvillohet në mungesë?

KRYESUESI: Në Rregullore nuk shkruan se duhet të jetë, prandaj...

ALMA LAMA: Atëherë, po ju jap një shembull. Për shembull, Parlamenti Britanik, të cilin unë e ndjek shumë dhe që është modeli i demokracisë, imagjinoni pak interpelancën e kryeministrit Dejvid Kamerun në mungesë të tij. Është e pa imagjinueshme!

Si do qoftë, është strategji e njohur diplomatike e kohës sonë - mundja e kundërshtarit, por mosposhtërimi i tij. Kjo strategji është ndjekur edhe me Serbinë pas bombardimit të NATO-s, që erdhën si pasojë e dhunës dhe terrorit në Bosnje dhe Kosovë.

Besoj, të gjithë e kujtojmë faktin se Serbia nuk u ndëshkua për akuzën e gjenocidit në Bosnjë, me gjithë masakrën e turpshme dhe të tmerrshme të Srebrenicës. E për sa i përket Kosovës, as që është akuzuar fare për gjenocid. Por, as akuzat për krime lufte nuk e ndëshkuan kasapin e Ballkanit sepse gjykimet zgjatën jashtëzakonisht gjatë. Pra, siç shihet, kujdesi për të mos e poshtëruar Serbinë, për të mos e ndëshkuar për atë që ka bërë, ka qenë aq i madh përgjatë këtyre viteve nga ana e bashkësisë ndërkombëtare.

Tani jemi në një fazë kur ky proces i ndëshkimit të shkaktarit të vuajtjeve më të mëdha në Ballkan, jo vetëm që nuk duket gjëkund në horizont, por më keq. Serbia ka hyrë në procesin e rehabilitimit, sikur asgjë të mos kishte ndodhur. E gjitha kjo po ndodh pa e pranuar fajin për krimet, pa ndier një fije keqardhje për to, pa u distancuar nga dhuna shtetërore që në Kosovë la rreth 15.000 të vdekur, pa menduar të kompensojë dëmet materiale që kapin shifra të qindra milionë eurove.

Serbisë po i ndihmon të rehabilitohet Bashkimi Evropian. Agjenda evropiane që shtrihet para saj, është konfirmimi kryesor për këtë proces. Prosesi i liberalizimit të vizave dhe premisa që në fund të këtij viti të fitojë statusin e vendit kandidat, janë dy tregues të pamohueshëm që dikush po i mbyll sytë për të shkuarën. Por, kush tjetër po i ndihmon Serbisë në këtë proces të rehabilitimit? Vetë Qeveria e Kosovës! Kjo ka shkuar në bisedime pa e përfillur këtë Kuvend dhe në kundërshtim të plotë me interesat e vendit.

Qeveria e Kosovës, në fakt, me politikën amorfe dhe pa ngjyrë të gjithë këtyre viteve ia ka lehtësuar aq shumë punën shtetit serb sa, kam përshtypjen se edhe vetë ata janë befusuar, sepse nuk e kanë pritur që pas negociatave të gjata, të cilat e shtrydhën maksimalisht territorin e Kosovës, ku si rezultat sot shohim një hartë të coptuar dhe një shtet jo funksional dhe pasi e ndrydhën kulturën shpirtërore të këtij vendi me eksterritorialitetin e kishave, të cilat shekuj më parë kanë qenë romano-katolike, e pasi i detyruan t'i ndërrojnë simbolet kombëtare, serbët pra, nuk kanë pritur një gatishmëri të tillë nga Qeveria e Kosovës për të shkuar në negociata të reja. Madje, për çudinë e tyre, këto negociata nisen, ndërsa e mban të pushtuar veriun dhe nuk iu kërkua aspak që të lëviz as këmbën prej aty. E, po kështu, negociatat nisen, ndërsa Serbia minonte procesin e regjistrimit të popullsisë në Kosovë dhe për këtë nuk u kujtua askush që ta kushtëzonte. Së paku, ne nuk kemi dëgjuar gjë.

Serbia pra, e frymëzuar nga kjo gatishmëri, po e keqpërdor maksimalisht kujdesin diplomatik të bashkësisë ndërkombëtare, me qëllimin e rehabilitimit të plotë dhe po e keqpërdor po aq fuqishëm naivitetin dhe servilitetin e institucioneve të Kosovës për t'iu afruar Bashkimit Evropian. Sepse, siç është parë deri tani nga takimet që janë zhvilluar në Bruksel, Serbia nuk ka treguar asnjë fije gatishmërie për të kthyer ato që i ka grabitur me dhunë Kosovës, as për të arritur ndonjë marrëveshje në lidhje me temat e tjera...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, e kreve! Mbaroi! Hajde, edhe një minutë, meqenëse je femër dhe po kërkon... Edhe një minutë!

ALMA LAMA: ... Mirëpo, kjo gjë nuk po e pengon aspak atë që ta sheh veten si shumë të moderuar, bashkëpunuese dhe palë konstruktive. Madje, përfaqësuesi serb në bisedime ka shprehur gatishmërinë të vijë edhe në Prishtinë dhe të arrijë në këtë mënyrë kulmin e konstruktivitetit. Si duket, Qeveria e Kosovës që i kanë dhënë leje për këtë gjë, ka dëshirë që ai t'ia përmend ndarjen e Kosovës edhe në mes të Prishtinës.

Pra, realiteti është se ky konstruktivitet... e kam fjalën që e ka përmendur para disa ditësh në veri, çështjen e ndarjes, gjatë vizitës së tij. Pra, realiteti është se ky konstruktivitet, kur është fjala në terren, nuk ekziston. Ta zëmë, gjatë kohës që po zhvilloheshin bisedimet, situata në veri vetëm sa po radikalizohet edhe më shumë. Për këtë ka fakte që vijnë çdo ditë nga terreni: paraliza e sistemit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, Alma, të lutem!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Atëherë, sipas radhës, fjalën e ka kryeministri Thaçi. Ka 5 minuta që i takojnë dhe 11 që ia ka rezervuar Grupi Parlamentar. Pra, 16 minuta i ka në dispozicion. Zoti Thaçi, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë, ju falënderoj të gjithëve për debatin shumë korrekt dhe konstruktiv, për sugjerimet që i prezantuat, idetë, për vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

Sa u përket marrëdhënieve të fqinjësisë dhe bashkëpunimit të mirë me të gjitha shtetet fqinje, kjo çështje, e ritheksoj edhe një herë, është e përcaktuar shumë qartë edhe në preambulë të Kushtetutës, pra është në përputhshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e Kosovës, me vizionin tonë euro-atlantik dhe më lejoni të lexoj vetëm dy rreshta të preambulës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që thotë: "... të sigurt që shteti i Kosovës do të kontribuojë në stabilitetin e rajonit dhe të mbarë Evropës, duke krijuar marrëdhënie të fqinjësisë dhe bashkëpunimit të mirë me gjitha shtetet fqinje".

Ritheksoj edhe një herë, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka përpunuar platformën e vet që del nga Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe propozimi im për të informuar Parlamentin me këtë platformë ishte shumë e vullnetit të mirë, e përgjegjësisë shtetërore dhe e transparencës maksimale.

E theksoj edhe një herë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur vija të kuqe në këtë proces të dialogut, që do të fokusohet vetëm në çështje praktike. Pra, vijat e kuqe – statusi i Kosovës i cili është i zgjidhur njëherë e përgjithmonë, sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës. Rregullimi i brendshëm është në autoritetin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës dhe planit të presidentit Ahtisari, ndërsa ne në këtë proces jemi me besim të plotë duke u bazuar në unitetin e qëndrueshëm politik dhe shtetëror të Kosovës dhe në unitetin qytetar për ndërtimin e Kosovës demokratike, multietnike, me vizion të qartë për t'u integruar në NATO dhe në Bashkim Evropian.

Çdo herë që do të kërkohet informim apo interpelancë, unë personalisht, kabineti im, do të jemi në Kuvendin e Kosovës. Ndërsa, çdo marrëveshje përfundimtare do ta ratifikojë

Parlamenti i Republikës së Kosovës e unë do të zotohem se do të jem gjithmonë pranë jush për t'ju informuar. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka propozuesi i interpelancës, zoti Kurti!

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës, një herë filluan bisedimet më 8 mars, mandej u bë një Rezolutë pa shumicën e deputetëve shqiptarë dhe vetëm pas kësaj rezolute qenka sajuar platforma të cilën ende s'e kemi parë, edhe pse janë zhvilluar tri raunde të dialogut deri më tani. Por, renditja do të duhej të ishte saktësisht e kundërta e kësaj: platforma, rezoluta, bisedimet. Në fakt, ne e patëm të kundërtën: bisedimet, rezoluta, platforma.

Pra, edhe dikush që ka biseduar me Serbinë, është ai i cili mundohet ta legjitimojë një gjë të këtillë në këtë Kuvend dhe vetëm më pastaj ta ketë një platformë se si të ecet më tutje.

Kjo është brenda kornizave të atyre që besojnë në këto bisedime për dallim prej nesh.

Së dyti, platforma është dashur të na prezantohet më herët. Ka qenë e mundur që nga një ekzemplar të na postohet në kuti të deputetëve dhe ne kemi pritur që kryeministri Thaçi sot të përgjigjet në ato shtatë pyetje të cilat ia bëmë, me ç'rast për asnjërën, ama bash për asnjërën nuk morëm përgjigje.

Kjo Qeveri ka përgjegjësi aktuale politike dhe përgjegjësi historike kombëtare për këto bisedime të padrejta, shumë të dëmshme e të rrezikshme që po i zhvillon. Dhe e vërej që janë tepër të relaksuar për të na përfaqësuar.

Kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe kollajllëku, komoditeti me të cilin këta flasin edhe për gjëra që nuk i kemi pyetur, në vend se të përgjigjen për ato që i kemi pyetur, tregon që nuk janë të shqetësuar e të brengosur siç do të duhej të ishin dhe nuk janë në nivel të detyrës.

Kosova nuk ka pasur nevojë të hyjë në këto bisedime. Duket që politikanët e caktuar të Kosovës kanë pasur nevojë dhe kanë nevojë për këto bisedime. Shkaqet e këtyre bisedimeve definitivisht janë individuale e personale, por pasojat do të jenë kolektive.

Kosova e këtillë është peng i politikanëve që janë peng të politikanëve që kushedi se sa shumë të korruptuar, janë dhe kushedi se nga kush të shantazhuar.

Për fund, po i përsëris edhe një herë shkurtimisht këto 7 pyetje për të cilat nuk morëm përgjigje, e për çfarë u organizua kjo interpelancë dhe kishte kuptim ajo.

Nuk morëm përgjigje recidive a e njeh Qeveria e Republikës së Kosovës Republikën e Serbisë.

Nuk na u tha kurrfarë përgjigje për procesverbalet edhe transkriptet e takimeve të kryeministrit Thaçi me Robert Cooper në vitin e kaluar. Sigurisht se të dy palët kanë pasur këshilltarë, ata kanë mbajtur shënime. Nuk u tha asgjë për këtë gjë. Dhe kësaj nuk

mund ta dimë cilat kanë qenë propozimet e kryeministrit Thaçi për temat e dialogut, çfarë kushtesh ka vënë ky para se të fillojnë bisedimet dhe me çfarë renditje janë përcaktuar këto tema, si rezultat i cilave bisedime paraprake që i kanë paraprirë këtij dialogu.

Mandej, nuk u dha përgjigje pse Qeveria e Kosovës nuk po imponon masë reciprociteti ndaj Serbisë.

Nuk na u dha përgjigje a ekzistojnë transkriptet dhe procesverbalet e bisedimeve në Bruksel, të zonjës Edita Tahiri me palën serbe, në ndërmjetësimin e Robert Cooper. A i ka parë kryeministri Thaçi ato transkripte dhe procesverbale dhe, nëse i ka parë, a do të na i sjell, e kur do të na i sjell.

Mandej, fare nuk u përgjigj për atë se cilat janë pozicionet e zonjës Tahiri me shkrim nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe cilat janë konkluzionet e arritura.

Po ashtu, nuk morëm as përgjigje sa i përket platformës së bisedimeve. Në vend se të humbej koha me atë se si mund të prezantohet kjo platformë, gjysma ka mund të prezantohet.

Dhe, së fundi, nuk u përgjigj kryeministri Thaçi në pyetjen se a i pranon ky kopjet e regjistrave civilë.

Duke marrë parasysh këtë papërgjegjësi alarmante, mendojmë se është shumë e udhës që në bazë të nenit 44 paragrafi 4, pika d) të Rregullores së Kuvendit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë...!

ALBIN KURTI: ... Është e domosdoshme që:

Nën 1. Të ndërpriten bisedimet me Serbinë;

Nën 2. Qeveria të ndërmarrë hapa konkretë për shtrirje të autoritetit të shtetit të Kosovës në gjithë territorin e saj, veçanërisht në veri; dhe

Nën 3. Që Qeveria e Kosovës të informojë rregullisht çdo tre muaj Kuvendin e Kosovës për përpjekjet e saj për të vendosur kontroll në tërë territorin e Kosovës.

Sepse, ne nuk jemi as të mundur. Kësisoj jemi të humbur, sepse as nuk provuam të dështojmë. Prandaj, është e domosdoshme që të ketë përpjekje dhe të ketë raport për ato përpjekje. Faleminderit shumë dhe shpresoj që do ta mbështesni këtë propozimin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani, sipas Rregullores, Grupi Parlamentar i Levizjes “Vetëvendosje” në bazë të nenit 44 pika 4 të Rregullores së Kuvendit ka propozuar për votim në Kuvend edhe tekstin e mocionit me 3 pika.

Kërkohet deklarimi me votim për miratim të mocionit të propozuar nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”. Unë, do t’i nxjerr, meqenëse janë tema të ndryshme, do të nxjerr secilën pikë veç e veç në votim, me qëllim që të votojmë pikat secili një nga një dhe ju lus për votim me elektronikë.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 97 deputetë. Për të votuar, e dinë të gjithë si votohet: “për”, dhe “kundër”.

Atëherë, pika 1. “Të ndërpriten bisedimet me Serbinë”.

Kush është “për” dhe kush është “kundër”, të deklarohe mi. Lus regjinë të bëhet gati dhe votojmë tani.

Faleminderit! Konstatoj se Kuvendi votoi “kundër” mocionit, me 56 vota. abstenuan 5 deputetë. Për t’u ndërprerë bisedimet janë 21 deputetë.

Vazhdojmë me pikën 2 të mocionit, që është: “Qeveria të ndërmarrë hapa konkret për të shtrirë autoritetin e shtetit të Kosovës në të gjithë territorin e saj veçanërisht në veri”.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Ju faleminderit! Për pikën 2 të mocionit kanë votuar 71 deputetë, që do të thotë miratohet pika 2 e mocionit. 17 janë “kundër” dhe 1 abstenim.

Pika 3 e mocionit. “Qeveria e Kosovës të informojë rregullisht çdo tre muaj Kuvendin e Kosovës për përpjekjet e saj për të vendosur kontroll në tërë territorin e Kosovës”.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Konstatoj që pika 3 e mocionit miratohet me 85 vota “për”, 5 vota janë “kundër” dhe 4 abstenime.

Pra, konstatoj që pika 1 e mocionit nuk miratohet. Pika 2 dhe 3 e mocionit miratohet. Faleminderit!

Ne e kemi edhe një pikë tjetër të rendit të ditës. Mendoj se duhet të marrim pauzë tash për drekë deri në ora 14:00, e pastaj do të vazhdojmë me raportin.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Të nderuar deputetë,
Po vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës. Në sallë janë 64 deputetë.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010

Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2010 e kanë shqyrtuar komisioni funksional dhe Komisioni për Buxhet e Financa dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar për miratim.

Tani, sipas radhës së diskutuesve, sipas Rregullores fjalën e ka kryetari i komisionit funksional, Idriz Vehapi, për arsyetimin e Raportit me rekomandime. Zoti Vehapi, e keni fjalën!

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 62 pika 1 dhe neneve 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me datë 19. 04. 2011, shqyrtoi Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë

R E K O M A N D I M

Të miratohet Raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010.

A r s y e t i m:

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur me datën 19. 04 2011, shqyrtoi Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës dhe vlerësoi se i njëjti përmbush obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI. Faleminderit! Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Hadërgjonaj. A është këtu? Nuk është. Dikush në emër të komisionit, nuk është i ngarkuar me këtë çështje. Atëherë, vazhdojmë me kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Xhevahire Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje, kolegë të nderuar!

Po fillojmë me lajmin e mirë, me përgëzime për të vazhduar me vërejtjet dhe sugjerimet. Sot kuptuam se Radiotelevizioni i Kosovës nënshkroi marrëveshje me Unionin Evropian të Transmetuesve Publikë dhe ky është një lajm i mirë për radiotelevizionin, por edhe për gjithë teleshikuesit e tij.

RTK, si medium publik, mision të tij e ka të informojë, të edukojë dhe të argëtojë. Janë këto tri shtylla që e karakterizojnë rolin e mediumit publik.

Raporti vjetor i RTK-së për vitin 2010 tregon që ky transmetues publik ka arritur të shtojë cilësinë e programit të prodhuar, por jo akoma në masën e dëshiruar apo rritje të cilësisë së programit konform shpenzimeve vjetore të pagave të të punësuarve.

Raporti i RTK-së për vitin 2010 është një raport përshkrues, por edhe i mungon vizioni për ndryshim të gjendjes në disa nga emisionet që mendoj tashmë u ka kaluar koha në formë dhe skenografinë e emetimit.

Përparimet e dukshme janë vërejtur në programin informativ, sado që ende mungojnë lajmet dhe kronikat nga komunat tjera, përveç kryeqytetit. Mendoj që duhet të ketë vend për një emision javor me zhvillimet kryesore nga komunat e Kosovës.

Programi i mëngjesit, në raport ceket se këtë vit do të ndryshojë rrënjësisht në formë dhe përmbajtje, si edhe ishte në ndryshim.

Kronikat e shkurtra nga vetëm dy-tre minuta nga komunat dhe nga vetëm dy-tre komunat me të cilat mendohet të mbulohet me korrespondenca, mendoj që pak janë bërë monotone dhe përshkruese. Këtu do të kisha një propozim që RTK mundësisht të lidhet nga komunat tjera me lidhje direkte. Mendoj se do të ishte më atraktive për shikuesit.

Emisioni - Debat, vërtet ka krijuar identitetin e tij, por që ai emision apo të tilla emisione duhet pasur së paku dy herë në javë, duke angazhuar gazetarë hulumtues të temave nga aktualiteti.

Emisioni - Gruaja sot, Pro-et-kontra, Bujku, Diaspora, Zëri ynë, Medika, edhe në raport vlerësohet të kenë performancë të mirë, por nuk përmendet prapë vizioni se si do të reformohen ato për t'u bërë ballë konkurrencës mediale. Këto emisione të tilla më shumë mendoj që u gjasojnë relikteve të një të kaluare dhe duhet patjetër të pësojnë ndryshime rrënjësore.

Emisioni - Jeta në Kosovë, vlerësohet në raport me shikueshmërinë, porse mendoj që dëshira për t'u marrë me të gjitha çështjet që e preokupojnë shoqërinë, e ka zvogëluar nivelin e profesionalizmit, por edhe të dëmtimit të tërë skenës. Autorët e këtij emisioni duhet të fokusohen vetëm në një lëmi për trajtime më të specializuara.

Në rekapitullimin e të arriturave, ngecjeve në sektorin informativ, ceken çalimet, po ashtu nuk përmenden masat e ndërmarra nga menaxhmenti në evitimin e tyre.

Defektet tjera duhet të riparohen patjetër në emisionet dhe programet arsimore, duke u dhënë përparësi emisioneve origjinale të prodhuara.

Në emisionet për fëmijë duhet patjetër të ketë më shumë atraktivitet, që do të joshte posaçërisht fëmijët e moshës nga 1 deri 6 vjeç.

Në programet e kulturës ka përmirësime të dukshme nga e kaluara, por vazhdohet me praktikën e mos zbulimit të aktiviteteve kulturore në qendrat jashtë Prishtinës.

Dhe shqyrtimi i mundësive që në bashkëpunim me Teatrin e Kosovës disa nga premierat e shfaqjeve teatrale të emitojnë tek shikuesi, pasi jo të gjithë e kanë mundësinë për të përcjellë shfaqjet e tilla.

Për derisa programi argëtues muzikor mund të konsiderohet se i plotëson standardet e një transmetuesi publik, vërehen ngecje në emisionet e argëtimit.

Mendoj se gjatë emisioneve të mbrëmjes do të kishte mundësi të kishte skeçe humorit, dy-pesë minutash në mes programeve, me të cilat do të atakoheshin dukuritë negative në shoqëri.

Emisioni - Oksigjen, është një shembull i një emisioni të mirë të realizuar dhe me porosi, derisa emisioni - Pa rrotulla, duhet të ketë vendin në një emision që i dedikohet më shumë emisionit serioz se sa argëtues.

Redaksia e sportit, ka mbetur prapa televizioneve private me emisionet e prodhuara dhe këtu duhet ndërmarrë diçka për të ndryshuar gjendjen.

Raportit, pra përgjithësisht vizionit të RTK-së duhet të mos i mungojë paraqitja e bashkëpunimit me televizionet tjera, posaçërisht nga Republika e Shqipërisë, megjithëse ky televizion nuk do të bënte gabime po të transmetonte disa nga emisionet, veçanërisht kulturore.

Radio-Kosova ka dëgjueshmëri të mirë nga qytetarët dhe mbulon me sukses, që lirisht mund të konsiderohet e arritur si nga cilësia e programeve, ashtu edhe nga dëgjueshmëria.

Emisionet informative të saj janë mirë të realizuara, veçanërisht kronikat e kulturës, sportit, por edhe formës së mirë të bashkëpunimit me Radion e Tiranës.

Radiotelevizioni i Kosovës, si televizion publik ka arritur përparime, marrë përgjithësisht vitin e kaluar, por këtë vit pritet nga menaxherët e saj të startojnë me reforma programore për t'ia shtuar cilësinë e modernitetit, megjithëse është kompetencë e Kuvendit që të ndihmojë zhvillimin e mediimit publik, në mënyrë që shoqëria kosovare ta ketë vërtet një ditar informimi, edukimi e argëtimi që nuk është pronë private e askujt, por e gjithë qytetarëve.

Kam edhe një sugjerim. Mund të ketë pra edhe vlerësime të cilat i tejkalojnë mundësitë profesionale të gjyqimit, mirëpo këtu më shumë është faji i Bordit të RTK-së, i cili nga themelimi ynë si komision akoma nuk ka arritur të kontaktojë apo nuk ka shprehur dëshirën që të ketë një kontakt me ne dhe të na tregojë nëse ka një vizion ose ka një strategji për zhvillimin e RTK-së.

Po ashtu, si anëtare e Komisionit, krejt këto vërejtje të cilat i kemi, të gjitha janë të mira në zhvillimin e një mediumi vërtet publik dhe unë ftoj kolegët e mi që ta mbështesim në këtë fazë Radiotelevizionin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sadri Ferati!

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë,

Edhe ne në Grupin Parlamentar të LDK-së, pas shqyrtimit dhe analizës së vetë raportit, janë tri çështje, të cilat ne i konsiderojmë me interes për t'i diskutuar. E para, është implementimi i plotë i punës së RTK-së në një autonomi, ashtu siç e përshkruan Ligji dhe vetë themeluesi, pra ne si Parlament i Republikës së Kosovës dhe nga vetë raporti të gjitha sfidat të cilat ekzistojnë në raport, kryesisht ndërlidhen me vetë autonominë e RTK-së që të mund të realizojë misionin e saj si një medium me interes publik për një informim të plotë dhe objektiv.

Çështja e dytë, që është me interes që të diskutohet, është pikërisht mungesa e Ligjit për RTK-në dhe mungesa e Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, janë pengesa kryesore që determinon disa mungesa të rezultateve brenda raportit, por edhe krijimi i një perspektive të veprimeve në të ardhmen.

Ne kemi informacione se Ligji për RTK-në është pranë Zyrës së kryeministrit dhe shpresojmë se ai shumë shpejt do të procedohet dhe ne do ta kemi këtu që të mund ta krijojmë bazën ligjore dhe të mund të krijojmë parakushtet për zhvillimin e mëtejme të RTK-së.

Dhe çështja e tretë, është vazhdimi i ndërtimit dhe i rritjes së kapaciteteve të RTK-së, në rend të parë me modernizimin dhe hyrjen në platformën digjitale sikur edhe televizionet tjera, prandaj ne si Grup Parlamentar, duke u bazuar në punën paraprake që kanë ndodhur nëpër komisione, e shprehim gatishmërinë tonë të një bashkëpunimi të plotë në të ardhmen që të tejkalohen të gjitha këto pengesa, që të procedohet me Ligjin për RTK-në, por edhe me Ligjin për media, që të përcaktohet se cila do të jetë shpërndarja e frekuencave në platformën digjitale, do të bashkëpunojmë dhe shpresojmë se në të ardhmen shumë shpejt ne do kemi veprime tona konkrete që do ta qartësojmë punën e mëtejme të RTK-së, gjithmonë në interes të ngritjes së një mediumi publik, siç është RTK-ja, në një medium të fuqishëm dhe konkurrues, gjithmonë në interes të publikut këtu në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Alma Lama e ka fjalën!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Pjesë e mandatit të transmetuesve publikë është të mbulojnë çështjet që i interesojnë publikut. Përpara se të hyj në një analizë të raportit financiar, duhet thënë se media publike, pra RTK, sot është e kërcënuar nga dy faktorë të rëndësishëm. E para, influenza

e pushtetit dhe, e dyta – pasiguria e financimit, ose financiare. Që të dy këta faktorë janë të ndërlidhur dhe influencojnë njëri-tjetrin.

T’i marrim me radhë. Influenca e pushtetit, në rast se i referohemi raportit vjetor të RTK-së, duhet një gjë themelore. Televizioni publik nuk ka mund ta gjejë veten në një agjendë të fortë në fushën e informimit të publikut, ku pjesa më e madhe e të hyrave do t’i dedikoheshin pikërisht zhvillimit të këtij sektori, pasi informimi i drejtë dhe i pa anshëm është qëllimi kryesor i një medias publike.

Nëse flasim në nivelin profesional, lajmet në televizionin publik nuk sjellin ndonjë risi. Në përgjithësi dominohen nga paraqitjet e ministrave, kryeministrit apo zyrtarëve të lartë, ndërsa qytetarët janë shumë më pak të zëshëm për sa u përket problemeve të tyre.

Vlerësimet e bëra në raport nga Bordi i RTK-së, që e shohin me pozitivitet fushën e informimit, mbeten shumë subjektive pasi nuk caktohen me sondazhe të cilat do të evidentonin qartë nivelin e paanshmërisë dhe besueshmërisë, ndarjen e hapësirës televizive në mes zyrtarëve dhe publikut, nivelin e protagonizmit të politikanëve, hapësirës që i jepet gruas në edicionet e lajmeve dhe si paraqitet ajo, pra në çfarë cilësie. Pra, një vlerësim i tillë mbetet subjektiv dhe jo profesional dhe është një nga të metat kryesore të raportit.

Po kështu, krahas edicioneve informative, në bazë të Raportit shihet se dokumentarët të cilët janë gjini televizive shumë e vlefshme, vazhdojnë të mbeten në margjina.

Nëse flasim konkretisht, dokumentarit si një zhanër shtjelljes duhet t’i rezervohet një hapësirë gjithnjë e më e madhe në median publike për shkak të tre karakteristikave themelore të tij. Është i arritshëm, në kuptimin e qasjes; pjesëmarrës dhe shumë përfshirës. E, po kështu, thellimi dhe analiza në debate është më se i nevojshëm. Publiku ka nevojë të shohë një çështje më gjerë se sa vetëm një vështrim bipolar. Ai ka nevojë që t’i jepet një hapësirë më e madhe në të cilën do të shohë konfliktet me të gjitha dritë hijet, të shohë qëndrimet dhe opinionet e kundërta dhe të përfshihet në një debat shoqëror.

Televizionet e fuqishme të botës, qofshin ato publike apo private, sot po forcojnë gjithnjë e më shumë rolin e tyre në një pikë tjetër tepër të rëndësishme, të funksionimit të një shteti demokratik, që është llogaridhënia publike. Llogaridhënia publike nënkupton detyrimin që kanë autoritetet për të shpjeguar publikisht, në mënyrë të plotë dhe të drejtë, para dhe pas fakteve se si ata e ushtrojnë përgjegjësinë e tyre e cila ndikon tek publiku në aspekte të rëndësishme. Mirëpo, ajo që e shohim ne në televizionin publik, në përgjithësi, është ndjekja e agjendës së zyrtarëve në kuptimin e plotë të fjalës, gjë që më pas reflektohet në besueshmëri.

Nga ana tjetër, RTK vazhdon të investojë shumë para në fushat të cilat në vendet e zhvilluara janë objekt i televizioneve private. Investimi në sport dhe në argëtim, konkretisht në serialet televizive, përveç se është devijim nga misioni kryesor i medias publike, pra që është informimi dhe edukimi, vazhdojnë të mbeten aktivitetet më të dyshimta të cilat nuk kanë gjetur shpjegim të detajuar në raport.

Të hyrat nga marketingu gjithashtu vazhdojnë të jenë të dyshimta. Ta zëmë, për serialin - Familja moderne, janë investuar si vlerë në neto rreth 544 mijë euro, Kafeneja jonë - mbi 1 milionë euro, programi Oxiqjen - 433 mijë euro dhe bashkë me të tjera, siç thuhet në raport dhe materiali arkiv, që nuk kuptohet se çfarë janë, totali shkon në 2.600.000 euro. E kam fjalën për faqen 76 të Raportit.

Gjithashtu, disa zëra buxhetor kanë rritje shumë të madhe të shpenzimeve, krahasuar me vitin 2009 dhe nuk kanë shpjegime për këto. Për shembull, të drejtat e sportit, mëditjet e bordit, kontrata me IBU e tjerë. Madje, edhe vetë Bordi i RTK-së, i cili bën mbikëqyrjen e punës së televizionit publik, në vitin 2010 ia ka dyfishuar vetes të ardhurat dhe shpenzimet pa ndonjë shpjegim.

Problemi tjetër që vazhdon të mbetet themelor për këtë televizion, është financimi. Mungesa e zgjidhjes për mënyrën e financimit e ka bërë edhe më të varur dhe të anshëm dhe mendoj se Kuvendi duhet të punojë sa më parë mbi Ligjin për financimin e medias publike.

Ne, si Grup Parlamentar, jemi plotësisht të përkushtuar për të punuar në këtë ligj, në mënyrë që transmetuesit publik t'i sigurohet pavarësia editoriale e jo të kthehet në një megafon të partisë në pushtet.

Si përfundim, ne nuk do ta miratojmë këtë raport për shkak se nuk prezanton një pasqyrë të saktë dhe të detajuar të aktiviteteve financiare në lidhje me buxhetin që i ka ndarë Kuvendi, por s'duhet ta harrojmë asnjë moment që ai buxhet është i taksapaguesve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë do të jem shumë i shkurtër për shkak se edhe deputetët Haxhiu dhe Kadaj-Bujupi do të flasin më në detaje për aspektet e këtij raporti dhe për qëndrimin më detaj të Aleancës.

Unë vetëm do t'ju them se ky Bord i Radiotelevizionit të Kosovës ka dështuar ta nxjerrë Radiotelevizionin, e sidomos Programin informativ të Radiotelevizionit nga kthetrat e Qeverisë. Ne ende mendojmë se Radiotelevizioni i Kosovës, në veçanti po themi, pjesa informative, redaksia e lajmeve, prej emisioneve informative kanë mbetur zëdhënës të Qeverisë së Kosovës dhe me këtë po ndikojnë në dëmtimin e lirisë së fjalës, po ndikojnë në demokracinë në Kosovë dhe po bëjnë që edhe njerëzit, po edhe politika të jenë më të frustruar, të jenë më të anshëm dhe të jenë në pozicione të cilat në një shoqëri demokratike nuk do të duhej të ishin.

Ne mendojmë se në Radiotelevizionin e Kosovës sot programet më të shikuara janë ato të lajmeve dhe emisionet e blera. Do të thotë, ato që blihen ose që merren prej kontraktorëve të cilët i prodhojnë dhe që janë të përmendura në Raportin e Radiotelevizionit të Kosovës, më duhet të them, ndoshta, përpos Metropolit, të Radios

Blu-sky, emisionet tjera janë të blera, ose të huazuara, ose janë emisione informative. Do të thotë, Radiotelevizioni i Kosovës mund të shndërrohet në një zëdhënës informativ të qeverisë dhe në një ndërmarrje e cila përmes tenderit blenë emisione, qofshin ato emisione argëtuese ose edhe seriale televizive.

Mund të them se ne nuk do ta miratojmë këtë raport, për këtë shkak, për shkak se mendojmë që Radiotelevizioni i Kosovës nuk duhet të jetë radiotelevizion argëtues, por qëllimin e parë e ka, siç u përmend edhe nga parafolësit - informativ dhe edukativ dhe meqenëse mendojmë se seriozisht ka dështuar në këto dy pjesët e para, ky raport nuk bën të aprovohet sot në Kuvendin e Kosovës.

Disa herë më përpara Grupi Parlamentar i Aleancës, në vazhdimësi, duke shpresuar se do të ketë ndryshime në politikat redaktuese, sidomos të emisioneve të lajmeve në Radiotelevizionin e Kosovës, e kemi votuar, po them edhe një herë, e kemi votuar në vazhdimësi cilindo raport, duke shpresuar se ka për të pasur ndryshime.

Mendojmë se ka ardhur koha që t'u tregojmë se nuk kemi më shpresë, se në këto relacione Qeveri – Radiotelevizion i Kosovës, në relacionet kur Qeveria e bën politikën redaktuese të lajmeve, ne nuk duhet ta votojmë këtë raport. Duke mos e votuar, besojmë se i bëjmë nder edhe Kosovës, mirëpo edhe shumë e shumë punëtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës, të cilët në vazhdimësi ankohen se janë nën presion, se nuk mund të vendosin vetë, se politikanët nga Qeveria shkojnë edhe hyjnë në emisione të lajmeve pa e lajmëruar kurrkënd ose edhe në emisione tjera, në intervista tjera.

Mendojmë se kjo nuk është Kosova që ne e domi, ky nuk është Radiotelevizioni publik i vetëm, që ne e duam dhe i thërrasim edhe deputetët tjerë të Kuvendit të Kosovës që këtë raport mos ta votojnë, në mënyrë që prej sot të fillojmë dhe ta rregullojmë Radiotelevizionin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit Kosova e Re, Gëzim Kelmendi!

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Unë pa e zgjatur më shumë, vetëm desha që në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re të njoftojmë se ne do e miratojmë Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Miletqi e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Poštovani predsjedavajući,
Koleginice i kolege poslanici,

Poslanički klub Samostalne Liberalne stranke razmotrio je pažljivo izveštaje RTK i očigledno je da se menadžment RTK izveštio u pisanju izveštaja i na to im treba odati priznanje.

Izveštaj je sadržajan, pregledan, grafički uređen, sa puno podataka. Međutim, danas bih govorio i o onome čega nema u izveštaju, a trebalo bi da bude.

U ekspozu predsebnika Borda RTK, na samom početku se navodi da javni servis nije imao glavnog urednika i rukovodioce zajedničkih službi i finansija. Za ove dve zadnje pozicije, dakle rukovodioce zajedničkih službi i finansija, mogu da razumem da ih nije bilo, jer radi se o tehničkim poslovima, pa je te poslove verovatno obavljao neko drugi. Ali da Televizija nema glavnog urednika, potpuno je neverovatna stvar!

Moramo da znamo ko je personalno odgovoran za programe. To je kao da danas održavamo sednicu Skupštine bez predsedavajućeg. Nedostaje, dakle u Izveštaju, koji su razlozi što se iz dva pokušaja nije izabrao glavni urednik RTK i kako je program funkcionisao bez prvog čoveka programa.

U ekspozu Generalnog direktora RTK insistira se na stabilnijem finansiranju RTK, što pominje i predsebnik Borda, i slažem se s tim, samo što je neophodno da se ispune određeni preduslovi, kao što je izglasavanje Zakona o RTK, u kojem bi finansiranje ove kuće bilo precizirano, odnosno gde bi jasno stajala prava i obaveze koje RTK ima kao javni servis.

U sprovođenju svoje misije, RTK je između ostalih navela sledeća načela i vrednosti: slobodu govora, nezavisnost, objektivnost, toleranciju i tako dalje.

Da li je u svojoj misiji RTK uspela i koliko, ne vidi se iz izveštaja, a lično mislim da je ostalo još mnogo toga da se uradi kako bi se proklamovani ciljevi postigli i u tome ih podržavam i današnje kritike su isključivo dobronamerne i u pravcu ispunjavanja misije, napisane na strani 8. ovog izveštaja.

Rad Informativne redakcije, kako piše u izveštaju, glavni je stub programa. Izveštaj navodi da je taj program doživeo evoluciju. Zadržao bih se na delu informativnog programa na srpskom jeziku, koji kao prvo dostignuće navodi napredak da radnici Redakcije vesti na srpskom jeziku sada učestvuju na jutarnjim sastancima Odeljenja vesti. Veliki napredak, nema šta!

Zatim se navodi da je povećana saradnja sa Redakcijom vesti na albanskom jeziku. Protiv toga, apsolutno, nemam ništa. Naprotiv, podržavam takav vid saradnje, uz komentar da ovom delu programa upravo nedostaje sopstvena proizvodnja vesti i da ta saradnja – Redakcija na srpskom i albanskom jeziku, bude dvosmerna.

Dopisnici iz Beograda, Podgorice i Mitrovice, navodi se dalje u izveštaju, imaju problem vizuelnog pokrivanja događaja u ovim regionima, što obesmišljava njihovu ulogu.

Dopisnik televizije bez kamere, odnosno slike, nema efekta jer se vesti i fono-izveštaji mogu skidati sa agencija. Ne mislim pri tom da treba raskinuti ugovore sa ovim dopisnicima, već im treba omogućiti bolje uslove za rad i da taj rad ima smisla.

U delu izveštaja koji govori o nedeljnom programu na srpskom jeziku stoji puno uopštenih formulacija o namerama, nastojanjima, težnjama, naporima i slično. Ne vidimo iz ovog izveštaja šta je urađeno i koliko je postignuto u unapređenju ovog dela programa.

Ciklus realizovanih emisija na srpskom jeziku koje su se ticale predizborne kampanje za parlamentarne izbore zaslužuju pohvale i napor koji su učinili ljudi koji su realizovali ovaj program zavređuju da budu pohvalni.

O programu na jezicima drugih zajednica verujem da će govoriti kolege koje predstavljaju te zajednice u ovom Parlamentu.

Što se radijskog programa na srpskom jeziku tiče, termin od 14 do 16 časova se nametnuo kao program koji je rezervisan za slušaoce na ovom jeziku i on beleži napredak. Jedino što bi moglo da se zameri je brzina informacije, obzirom da je radio najbrži medij. Međutim, za to opravdanje ima, jer se ipak radi o programu koji se emituje samo u određenom terminu, tako da se ne može obezbediti aktuelnost i ekskluzivnost, što slušaoci održe uz određenu frekvenciju. To bi se moglo postići kroz program Blu-sky radija, ali taj program, ako sam dobro razumeo iz izveštaja, ima drugu ciljnu grupu, slušaoca, što je u principu u redu.

Web-stranica RTK, piše u Izveštaju, je u 2010. zadržala reputaciju jedne od najposećenijih i najpoverljivijih. Nema razloga da u to ne verujemo.

Ako otvorite stranicu: www.rtklive.com/sr, dakle na srpskom jeziku, videćete prvu vest da SNV traži bezuslovni povratak Srba u KPS iz 14. maja 2008. godine. Pre tri godine! Veoma aktuelno! Ovo u izveštaju ne piše, ali je nedopustivo i govori o zanemarajućem odnosu prema ovoj web-strani. Znači, ne samo da ne postoje novinari koji bi uređivali ovu stranicu, već nema ni prevodioca koji bi makar preveo vesti sa albanskog, a koje su aktuelne, ako se već ne tiču onih za koje je ta web-strana namenjena.

Javni servis ne bi smeo ovako da se ponaša i sa ovog mesta pozivam menadžment RTK da uradi nešto povodom aktiviranja stranice RTK online na srpskom jeziku. Slično je i sa stranama na engleskom, bosanskom i romskom.

Ostatak govora koji govori o tehničkim stvarima uglavnom je dobar, pregledan sa puno relevantnih podataka.

Na kraju, želeo bih da kažem još nešto što nije u vezi sa izveštajem, ali jeste u vezi sa radom RTK.

Naime, 23. marta ove godine, emitovana je emisija na RTK pod nazivom Slobodno srpski, i to ne prva, već četvrta, što pokazuje da je format emisije i način vođenja bio prihvatljiv za uređivačku politiku RTK. U 18 minutu emisija je prekinuta zbog, kako se navodi u obrazloženju RTK, preovladavanja govora mržnje, a zamenica direktora RTK je istakla da je tokom emisije stiglo mnogo poruka osude od raznih građana i da je tada odlučeno da emisija bude prekinuta.

Ovaj slučaj ukazuje na akutni problem slobode medija na Kosovu. Da li program RTK uređuje uređivački kolegijum ili publika nezadovoljna onim što vidi i čuje? Da li je urednik pregledao emisiju pre nego što je puštena u eteru? Ako jeste, i primetio je da preovladava govor mržnje, zašto je dopustio da se u opšte emituje. Ako nije, zašto nije? Ako jeste, i procenio je da nema govora mržnje i pustio je emisiju, nije trebalo ni da je prekida zbog poziva nezadovoljne publike.

Ovakav neprofesionalan pristup programu javni servis sebi ne sme da dozvoli i pozivam menadžment RTK da preispita odluku, da emisiju Slobodno srpski trajno ukloni iz programa.

Pored svih ovih primedbi koje su, kako sam već naglasio, dobronamerne, Poslanički klub Samostalne liberalne stranke će glasati za ovaj izveštaj, jer smatramo da ovim ljudima treba dati šansu, da propuste poprave i da ispune misiju koju su sami proklamovali u tački 4. ovog izveštaja – da budu nezavisni, objektivni, korektni, tačni, transparentni, tolerantni. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, nuk ka të paraqitur. Vazhdojmë me diskutimet e deputetëve, sipas paraqitjes. Deputeti Fadil Demaku e ka fjalën!

FADIL DEMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2010 prezanton më tepër të arriturat e më pak ngecjet. RTK nga viti në vit ka shënuar ngritje cilësore, por me diskrepancë jo të vogël në mes të sektorëve të caktuar, ku në disa programe kemi rezultate të dukshme, e në disa stagnim të vazhduar.

Pavarësisht konkurrencës në sektorin medial vendor, RTK pa diskutim e mban primatin në vend me misionin e qartë që t’i ofrojë auditorit informim objektiv dhe program cilësor e në këtë drejtim duhet vazhdimisht të ngrihet performanca.

Duke pasur parasysh se shumë deputetë me siguri do të flasin për çështje të ndryshme, sa i përket Radiotelevizionit të Kosovës unë dëshiroj të theksoj një çështje nga transmetimet në fushën e sportit.

Vite me radhë Radiotelevizioni i Kosovës kishte siguruar transmetimet nga kampionati anglez i futbollit, i njohur si më i shikuari dhe më atraktivi në botë. Këto transmetime nuk vazhduan për edicionin 2010/2011, çka mendoj se kishte shkaktuar shumë pakënaqësi te shikuesit e këtyre evenimenteve sportive.

Me këtë, pikërisht në këtë kohë, si për kohëzgjatje, Televizioni digjital IPKO arrin t’i sigurojë këto transmetime, mirëpo duke ofruar para shikuesit paketa, të veçanta të cilat bëheshin vetëm me pagesë. Këtu u bë një lloj seleksionimi, ndoshta i rastësishëm, ku banorët e zonave urbane kishin mundësi që përmes Televizionit digjital IPKO të blejnë

pakon sportive e të shpenzojnë para, ndërsa banorët nga zonat rurale mbetën pa asnjë mundësi.

Krahas çështjeve tjera që mund të jenë më prioritet, mendoj se RTK duhet të vazhdojë transmetimet televizive të këtij kampionati. Kjo është dëshirë dhe kërkesë e shumë qytetarëve. Janë shumë arsye që dihen për këtë, afirmimi sa më i madh i sportit, me këtë rast i futbollit, që kontribuon për të krijuar breza të shëndetshëm dhe duke mbyllur sa më shumë rrugën dukurive negative dhe që orientimi i shtresës më vitale të shoqërisë sonë të jetë i orientuar nga sporti e çështje të cilat janë shumë pozitive. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu!

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se e kemi para vetes një material që nuk na jep shumë mundësi për të reflektuar. Në veçanti do t'i përkushtohem pjesës financiare materiale të operimit të këtij institucioni.

Ky institucion, të ju përkujtoj se nga buxheti i konsoliduar i Kosovës këtë vit ka marrë mbi 10 milionë. Pra, është një shfrytëzues buxhetor mjaft serioz dhe një raportim i tillë, ku nuk kemi një auditim, i cili do të kishte shfletuar këto pasqyra financiare dhe do të na prezantonte në saktësi për rregullsinë e përdorimit të këtyre mjeteve si në kategorinë e mallrave dhe të shërbimeve, në paga dhe në investime kapitale.

Ky medium që shumë vite nuk ka pasur një auditim dhe kam përgjithësisht një kërkesë: raportimet do të duhet, nëse Zyra e auditorit gjeneral nuk ka kapacitet për auditim të të gjitha subjekteve buxhetore, së paku Komisioni për Mbikëqyrje duhet të dërgohet si komision që të japë një vlerësim të vetin për rregullsinë apo pa rregullsinë e mënyrës së përdorimit të këtyre mjeteve.

Për mua është e habitshme kjo, kur parasysh kam se Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike i vijnë shfrytëzues buxhetorë shumë minorë në aspektin buxhetor, e kam gjithherë fjalën, ta zëmë Akademia e Shkencave, e tjera, e tjera që nuk çojnë shumë peshë, ndërsa në anën tjetër vihet një raport i tillë që vite me radhë, po them, nuk ka pasur auditim, për mua ky material është i dyshimtë dhe ka nevojë që të hulumtohen ato pasqyra financiare, sepse në mënyrën si janë prezantuar është shumë vështirë të japësh një vlerësim, prandaj unë s'po dua të spekuloj, por po kërkoj që asnjë raport vjetor nuk do të duhej të vijë në Kuvend për shqyrtim pa një vlerësim paraprak, sepse çdo vlerësim që e merr në mënyrën e tillë, realisht nuk do të ketë vlerësimin e saktë. Mandej, vijnë edhe ndeshje, nëse ndodh siç e patëm rastin me Komisionin për Buxhet dhe Media. Komisioni për Buxhet e jep vlerësimin pozitiv, ndërsa auditori gjen shumë shkelje dhe ne e prezantojmë, do të thotë dy komisione vijnë në kundërshtim, që s'do të duhet të jetë. Komisioni për Buxhet është ai i cili merret me ndarjet buxhetore, me vendimet për ato procese buxhetore. Komisioni për Mbikëqyrje është që do të kontrollojë rregullsinë se si janë përdorur ato mjete. Dhe unë mendoj se në këtë mënyrë, deputetëve do t'u qartësojmë

dhe do t'u ofrojmë një tablo krejt të qartë, në bazë të së cilës ata do të gjykojnë. Këto ishin vërejtjet e mia përgjithësisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pavarësia e auditorialit në media është një ndër faktorët e rëndësishëm drejt një shoqërie të lirë e demokratike. Kosova më shumë se kurrë ka nevojë për fjalën e lirë në media, sepse një gjë e tillë është në funksion të përparimit dhe transparencës, për cilin do të duhej të angazhoheshin të gjithë.

Raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës, të cilin e kemi përpara, ka shënuar një performancë, mirëpo mbetet shumëçka për të dëshiruar. Mirëpo, ne konsiderojmë se punonjësit e RTK-së edhe më shumë duhet të angazhohen për integritet e pavarësisë editoriale, sepse ky është një faktor i rëndësishëm drejt zhvillimit të mediave në Kosovë.

Në raport para se gjithash janë paraqitur edhe anë pozitive, mirëpo të metat që janë, janë të shumta që e përcjellin Televizionin publik, ku pranohet se disa sektorë, përkatësisht në disa profileve të emisioneve punët nuk janë edhe aq mirë, pra në nivelin e dëshiruar. Është e domosdoshme që këto dobësi të cilat edhe ne i kemi evituar, të eliminohen sa më shpejt që është e mundur.

Kur jemi te pavarësia editoriale, sot po thuaj se të gjitha mediat në Kosovë, e së këndejmi edhe Televizioni publik – RTK, në mungesë të zgjidhjes së problemit të financimit, varet nga Qeveria, nga kompanitë e ndryshme të cilat zakonisht zbatojnë politikat e veta dhe si të tilla nuk mund të ushtrojnë veprimtaritë e tyre në mënyrë të pavarur, në mënyrë që ne të gjithë do ta dëshironim.

Ne si Aleancë, konsiderojmë se duhet të veprojmë urgjentisht në këtë drejtim. Si mund të jetë një institucion i pavarur, nëse është i varur financiarisht. Këtë pyetje e hasim gjithnjë e më shumë, jo vetëm në nivele tona, por edhe nga subjektet ndërkombëtare. Prandaj, siguri i kushteve ligjore për pavarësi financiare për RTK-në është parakusht i rëndësishëm i pavarësisë editoriale.

Në Raportin vjetor të RTK-së për vitin 2010, janë precizuar përpjekjet e Bordit të Radiotelevizionit për gjetjen e alternativave për sigurimin e financimit të qëndrueshëm. Kjo gatishmëri e Bordit dhe menaxhmentit të RTK-së dhe nxjerrja e Ligjit për RTK-në do të çonte në funksion të zgjidhjes së këtij problemi, të cilin e dëshirojmë të gjithë. Respektimi i Ligjit për transmetimin publik, për blerjen e veprave të produksionit të jashtëm, konsiderojmë se është një hap, mirëpo këtu duhet të ketë kujdes menaxhmenti i RTK-së, sepse edhe ne si komision këtë raport e shqyrtojmë dhe duhet që në raportet tjera, para se gjithash prej se jemi themelues si komision, ne do të jemi shumë më kritikë.

Konsiderojmë se kohëve të fundit ka përmirësim të ndjeshëm në disa shtylla kryesore, siç është Programi informativ dhe Debat në studio, por gjithnjë duke u bazuar në raportin

vjetor ne mendojmë se është e domosdoshme krijimi i më shumë hapësire për programet kulturore, arsimore, sportive dhe programit për fëmijë. Kjo do të avanconte edhe më shumë misionin e RTK-së si medium publik.

Në këtë kuadër është i nevojshëm pasurimi i fizionomisë së emisioneve të këtij transmetuesi publik, në funksion të ngritjes së cilësisë për krijimin e hapësirës më të madhe kur është fjala për programet edukativo-arsimore. Mirëpo, shqetësim kryesor i yni, por edhe i qytetarëve të vendit, mbetet mos mbulimi i ngjarjeve, qofshin ato ditore, por edhe i problemeve të të gjitha fushave nëpër komunat e tjera në Kosovë. Plotësimi i programit informativ si shtylla kryesore e mediumit me ngjarje dhe emisionet e tjera mendoj se do ta plotësonte dukshëm këtë zbrazësi dhe gjithë përfshirje të komunave tjera, në mënyrë që të krijohet një balancë në nivel vendor, për faktin se qytetarët e Kosovës përballen me halle dhe probleme jashtëzakonisht të mëdha.

Kjo zbrazësi, ky mosmbulim gjithëpërfshirës, transmetuesin publik por edhe mediumet tjera është duke e përcjellë në vazhdimësi. Qytetarët e Kosovës e vërejnë këtë më së miri dhe e thonë vazhdimisht.

Prandaj, mendojmë se për t'u mbushur këto zbrazësi dhe para se gjithash misionin e tij si alternativë, do të ishte e nevojshme që ky transmetues të ketë edhe një kanal tjetër televiziv.

Sigurimi i objektivave programore të RTK-së është një element tjetër i cili kërkon zbatim praktik dhe me përpikëri. Mendoj se rritja e performancës pothuaj se në të gjithë sektorët e programit të RTK-së duhet të jetë një ndër objektivat kryesorë të këtij mediumi. Faleminderit!

KRYESYUESI: Faleminderit! Deputeti Naser Osmani e ka fjalën!

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Konsideroj që në këtë raport ka mundësi mjaft çka të flitet, sidomos pas komenteve hyrëse që i ka bërë edhe drejtori i Bordit të RTK-së dhe drejtori menaxhues që i ngrehën shqetësimet e mëdha lidhur me mënyrën e financimit të RTK-së për këto dy vitet e fundit dhe kjo duhet të jetë e kuptueshme pasi që financimi ka rëndësi jetike për statusin e transmetuesit publik dhe për ruajtjen e pavarësisë editoriale, që është obligim themelor i RTK-së.

Ndoshta përgjegjësia këtu duhet të ndahet sa te menaxhmenti i RTK-së, aq edhe te deputetët, sidomos te komisioni funksional që ka të bëjë me RTK-në.

vazhdimisht në ... e mungesës së ligjit, i cili garanton financimin e përhershëm. Mirëpo, edhe në ligj thuhet qartë se Kuvendi i Kosovës duhet të sigurojë një kornizë financiare të përshtatshme, të sigurt dhe transparente që mund të përfshijë edhe mbështetje nga buxheti i Kosovës. Mirëpo, në ligj shkruhet saktë se me mjetet e buxhetit çka duhet të financohet në RTK. Ajo ka të bëjë me programin për minoritete, ka të bëjë me programin për diasporën, ka të bëjë me disa shpenzime që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të transmetuesit dhe për disa projekte të veçanta me karakter kulturor dhe

shkencor. Mirëpo, në asnjë mënyrë në ligj nuk thuhet që me mjete të buxhetit mund të bëhen pagat dhe mallrat e shërbimet, që në këtë rast i kemi për vitin 2010 dhe 2011.

Nëse na kujtohet qartë, në vitin e kaluar, kur Qeveria ka vendosur për ta ndihmuar RTK-në, me dy kiste nga 5 milionë, respektivisht 10 milionë, ka qenë një kusht i Kuvendit, respektivisht i Komisionit për Buxhet e Financa që pas kistit të parë RTK-ja t'i raportojë Kuvendit për shpenzime, në kuptimin e asaj që mund ta marrë, ta shfrytëzojë kistin e dytë dhe kjo asnjëherë nuk ka ndodhur dhe ky Kuvend nuk ka marrë raport lidhur me ato shpenzime.

Nga ana tjetër, nëse shikohet se a janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë e grumbullimit të mjeteve për nevojat e RTK-së, pa i përfshirë mjetet buxhetore, që mund të them në këtë rast kemi bërë një gjë të vetme çka kemi mundur, që mjetet e dedikuara për RTK-në nga Qeveria të shkojnë drejtpërsëdrejti, i kemi ndarë që të shkojnë nëpërmjet Kuvendit, në kuptimin e asaj që të kontrollohet shpenzimi i tyre. Nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë e grumbullimit të mjeteve për arsye se janë disa të hyra që mund të bëhen nga kontratat me palët e treta, nga shërbimet komerciale, qysh është transmetimi, bile pse jo edhe Kuvendi të paguaj për transmetimin e vetë në këtë moment që i bën RTK-ja. Shërbimet tjera, do me thënë, të programeve, botimet e prodhimeve muzikore, videove, audiove e tjera, reklama e publikime, do me thënë, disa mundësi të mëdha për grumbullimin dhe ajo çka është më interesant, që me ligj është e garantuar të mblidhet, të arketohet parapagimi të cilin Kuvendi e cakton. Kuvendi e ka caktuar 3.5, që mbas një muaji Bordi i RTK-së ta ketë të drejtën për ta ndryshuar, ndërsa Bordi i RTK-së ka të drejtë ta gjejë një agjent i cili do ta bëjë grumbullimin e këtyre mjeteve ose të formave të tjera. RTK-ja apo Bordi i RTK-së ka bërë një gjë, ka lidh një marrëveshje me KEK-un, të cilën më vonë Gjykata Kushtetuese e ka rrëzuar, mirëpo asnjëherë më nuk ka provuar që të gjejë ndonjë organizatë tjetër që do ta luante rolin e agjentit për grumbullimin e parapagimit ose të paktën të caktonte agjentët e vet në formën e inkasantëve për të grumbulluar parapagimin që është i përcaktuar me ligj. Me fjalë të tjera, njerëzit që punojnë në RTK janë mësuar të marrin para të gatshme, njëherë nëpërmjet KEK-ut, tani nëpërmjet buxhetit. Forma e menaxhimit në KEK duhet të ndryshojë njëherë e përgjithmonë dhe duhet të gjenden forma stabile të financimit të RTK-së. Mirëpo, atë që thashë në fillim, fajësia nuk është vetëm te RTK-ja, është edhe te deputetët të cilët nuk kemi arritur asnjëherë ta finalizojmë ndryshimin e Ligjit për RTK-në, ku janë paraqitur disa variante të reja të financimit të RTK-së.

Konsideroj që ky raport, përveç kësaj pjese jo financiare, jo buxhetore, ka mjaft çka të thuhet, sidomos me disa prezantime të individëve që gjërat personale i bëjnë publike nëpërmjet televizionit publik, që është një gjë shumë e shëmtuar dhe e mjerueshme. Konsideroj që ky raport ka nevojë së pari të bëhet një raportim standard, sidomos i pjesës financiare, por edhe pjesës tjetër dhe mandej të marrë një pëlqim në Kuvend, që konsideroj në këtë moment është e pamundur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Osmani! Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Na është sjellë një raport i transmetuesit apo mbi punën e transmetuesit publik në Kosovë, ku dy ditë më parë jemi radhitur pas Argjentinës në sferën e lirisë së mediave.

Përkundër kësaj, Qeveria Thaçi nuk shpreh ndonjë gatishmëri që të ofrojë ndonjë përmirësim në këtë fushë, por vazhdon ngurrimin e sponzorizimit të ligjit të ri për RTK-në, i cili do të parashihet financimin e pavarur dhe jo nga buxheti i Kosovës. Arsyeja pse mungon ky vullnet politik, është tendenca për të vazhduar kontrollin qeverisës mbi transmetuesin publik.

Qeveria e cila të vetmen formë për të vazhduar ushtrimin e pushtetit të vet e bën përmes propagandës, e cila madje nuk i besohet një zëdhënësi, është kjo një praktikë e cila ndodh në të gjitha vendet demokratike, ku për punën e qeverisë informon një zëdhënës, në Kosovë ndodhë që në vazhdimësi të kemi një zëvendëskryeministër, e kësaj radhe, për fat të keq, ky është një ministër i drejtësisë.

Tash, pavarësisht qëllimeve të mira që mund t'i kenë një numër i profesionistëve në RTK, ndërhyrja e vazhdueshme e Qeverisë në politikën redaktuese vazhdon ta prapakthejë këtë medium, e në fakt vazhdon ta prapakthejë edhe Kosovën. Cenimi i lirisë së medias në RTK vazhdon të zbatohet përmes tri pikave apo tri shtyllave: presionit financiar të Qeverisë, i cili mban peng RTK-në përmes financimit të buxhetit të Kosovës; zvarritja e legjislacionit më të avancuar, i cili do të mundësonte zhvillimin e RTK-së përmes financimit të pavarur; ndërhyrje direkte fizike ndaj gazetarëve të caktuar të cilët nuk pranojnë të zbatojnë politikën dhe agjendat qeveritare, dhe tendenca e Qeverisë Thaçi për të ngulfatur dhe kontrolluar gjithçka që quhet liri e fjalës dhe që është e drejtë fundamentale e ndonjërit, edhe e gazetarëve po edhe e qytetarëve të tjerë të republikës së Kosovës. Dhe sa larg shkon kjo tendencë për të ngulfatur gjithçka, është parë edhe sot, në mëngjes në seancë, kur persona të pa autorizuar me veshje dhe pamje kërcënuese gjatë gjithë mëngjesit kanë zaptuar hyrjen e sallës dhe askush nuk ka dhënë shpjegim se kush janë dhe çka bëjnë ata aty. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I kemi vërejtur me vonesë dhe edhe unë i kam vërejtur me vonesë, meqenëse po pyet. Ata nuk kanë pas njohuri, janë të ri në gardë dhe kanë dalë jashtë, iu kemi bërë vërejtjen vetë, kështu që mos u bëni merak fort për atë punë. Fjalën e ka Blerta Deliu.

BLERTA DELIU: I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar qytetarë,

Radiotelevizioni i Kosovës, organ i themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe njëkohësisht duke qenë mediumi i vetëm publik në vend, detyrimisht kërkon një trajtim meritore nga ne deputetët e Kuvendit, pasi që është i vetmi medium i rregulluar me ligj të veçantë, duke ushtruar kështu një ndikim të jashtëzakonshëm, jo vetëm në informim, por edhe në krijimin e opinionit publik.

Në këtë mënyrë, Kuvendi i Kosovës ka obligim ligjor që të kujdeset për këtë institucion të rëndësishëm publik, të përcjellë zhvillimet e vazhdueshme në këtë medium në të gjitha aspektet dhe të garantojë një zhvillim të qëndrueshëm në koherencë me trendet e kohës, si në aspektin organizativ dhe profesional, ashtu edhe në atë financiar.

Ndërkaq, sa i përket Raportit vjetor të RTK-së, konsideroj se Radiotelevizioni i Kosovës ka shënuar vazhdimisht ngritje cilësore në performancën e vet, duke forcuar kështu pavarësinë editoriale që është indikator i rëndësishëm drejt zhvillimit të një shoqërie demokratike. Në këtë drejtim konsideroj se RTK-ja nuk është vetëm formalisht e pavarur, por është tërësisht e pavarur, kurse gazetarët e këtij mediumi konsideroj se janë plotësisht të lirë që të kryejnë punën e tyre.

Është për tu përsëritur edhe marrëveshja e nënshkruar dje ndërmjet Radiotelevizionit të Kosovës dhe EBU, e cila rikonfirmon se RTK-ja ka shënuar progres edhe në aspekti programor. EBU është organizatë e rëndësishme e Bashkimit Evropian dhe bashkëpunimi me RTK-në do t'i ndihmojë Televizionit të Kosovës që të avancohet edhe më tej në aspektin profesional.

Megjithatë, krahas progresit të shënuar, mediumin e vetëm publik në vend vazhdojnë ta karakterizojnë ngecje në gamën e gjerë të strukturës programore. Pavarësisht elementeve inkurajuese që janë evidente në punën e këtij mediumi, e sidomos në programin informativ dhe argëtues, Televizioni i Kosovës ende nuk ofron për qytetarin programe të mirëfillta edukativo-arsimore, kulturore e historike, mjedisore, si dhe dokumentare e programe më cilësore për komunitetet.

Kur flasim për komunitete, konsideroj se është më se i nevojshëm funksionalizimi i kanalit të dytë të Radiotelevizionit të Kosovës, i cili do të krijonte hapësirë të re dhe shumë më përfshirëse. RTK-ja ka një Bord të themeluar nga Kuvendi i Kosovës, i cili i përgjigjet drejtpërdrejt Kuvendit. Nga ky Bord duhet të kërkohet që të hartojë strategji zhvillimore të mediumit publik dhe në këtë rrafsh edhe të japin rekomandime lidhur me mënyrën e financimit. Po ashtu, Bordi i RTK-së duhet të kërkojë nga menaxhmenti që urgjentisht të ndërmarrin masa për të ngritur cilësinë në programin edukativo-arsimor dhe kulturor.

Ndërkohë, në Projektligjin e ri të Radiotelevizionit të Kosovës mendoj se duhet të jetë rregulluar edhe çështja e transmetimit të programit të RTK-së në rrjete transmetuese që janë IPK-o, Kujtesa dhe Digjitalb. Kjo nga se RTK-ja e këtyre rrjeteve programin e vet ua jap falas, ndërkaq parapaguesit të cilët nuk kanë mundësi që të kenë lidhje me këto rrjete transmetuese, konsideroj se me rastin e shkyçjes, programi i RTK-së të mos u ndërpritet por ata ta kenë atë falas.

Të nderuar deputetë, një ligj i ri do të jepte përgjigjen e shumëkërkuar në këtë medium të rëndësishëm në përcaktimin e formës adekuate të financimit të qëndrueshëm, duke marrë për bazë praktikën e dëshmuara evropiane kur bëhet fjalë për financimin e medimeve publike.

Të nderuar deputetë,
Mendoj që Radiotelevizioni i Kosovës, si medium publik i themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe që është në shërbim të publikut, duhet të ndihmohet edhe në aspektin e zhvillimit teknologjik, sidomos tani në kohën e digjitalizimit dhe kjo duhet edhe të rregullohet me ligj.

Përfundimisht, konsideroj se është më se e vështirë të mendohet se një institucion mund të jetë i pavarur, nëse atij i mungon pavarësia financiare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Berat Buzhalla e ka fjalën!

BERAT BUZHALLA: I nderuar kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,
U fol këtu për pavarësinë editoriale apo mungesën e pavarësisë editoriale të Radiotelevizionit të Kosovës. Me përgjegjësi të plotë them se partitë më të mëdha politike këtu në Kuvendin e Kosovës, përpara se të kujdesen për pavarësinë editoriale, janë kujdesur t'i kenë gazetarët e vet brenda Radiotelevizionit të Kosovës.

Secili prej jush e dini, i keni njerëzit tuaj aty brenda televizionit, që i thirrni në dreka, në darka dhe bëni muhabet me ta. I keni të ndara edhe emisionet brenda Televizionit të Kosovës. Mirëpo, problemi nuk është këtu. Problemi është te ngulfatja apo një dëshirë bizare për ta ngulfatur Televizionin e Kosovës në kohën kur është ndërprerë financimi prej tri eurove i Televizionit të Kosovës, është Komisioni i Pavarur i Mediave, ia ka marrë të drejtën Radiotelevizionit të Kosovës që të ketë edhe reklama brenda Radiotelevizionit të Kosovës dhe në këtë drejtim ai televizion ka rënë viktimë e dy mediave tjera nacionale private, të cilat e kanë shumicën e anëtarëve brenda KPM-së dhe në këtë mënyrë po dëshirojnë që ta ngufasin dhe ta mbysin këtë televizion publik. Televizioni publik profesionalisht qëndron ashtu si qëndron, mirëpo me një përpjekje, me një angazhim të gjithë neve dhe me aprovimin e një ligji që do t'ia siguronte një financim të pavarur, pra jashtë kthetrave të Qeverisë dhe jashtë kthetrave të Kuvendit, mirëpo që të jetë një financim i qëndrueshëm, me një formë alternative, çfarë e kanë edhe televizionet tjera publike nëpër botë. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Në sallë janë 66 deputetë, tash u bënë 77 deputetë. Është koha për votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Konstatohet se Kuvendi me 43 vota “për”, 38 “kundër”, 1 “abstenim”, miratoi Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2010.

Mirupafshim nesër, në seancën e re! Faleminderit!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit